



Adhurimi im

INFORMACIONE THEMELORE PËR ISLAMIN



KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE E TURQISË



KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË

Aadhurimi im

Editor:

Prof. dr. Mehmet Emin Özafşar- Prof. dr. Recai Doğan

Drejtor publikimi:

Dr. Fatih Kurt

Koordinimi:

Lokman Arslan

Projekti:

Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë - Kryesia e Zyrës së Arsimit Fetar

Autorët e kapitujve:

Dr. Yaşar Yiğit – Dr. Ekrem Keleş

Përktheu:

Florida Kulla

Redaktor gjuhësor:

Fatjon Cuka

Faqosja:

Erzen Pashaj

Përgatiti për botim:

Uğur Altuntop

Botimet e Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë: 1493

Libra të serisë profesionale: 168

Vendim i Komisionit të Vlerësimit të Veprave: 06.06.2018/36

2019.06.Y.0003.1493

ISBN 978-975-19-6985-9

Certifikimi: 12930

Botimi i dytë, Ankara 2019

Botimi:

Başak Mat. Tanı. Hiz. İth. İhr. Tic. Ltd. Şti.

+90 312 397 16 17

© KRYESIA E ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË

Kontakt:

Kontakt me Drejtorinë e Përgjithshme të Botimeve

Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü

Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı

Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı No: 147/A

06800 Çankaya - ANKARA / TÜRKİYE

Tel.: +90 312 295 72 81 • Fax: +90 312 284 72 88

E-posta: yabancidiller@diyanet.gov.tr

KAPITULLI 1 ADHURIMI

1. Përkufizimi i adhurimit 7
2. Qëllimi dhe rëndësia e adhurimit 7
3. Llojet e adhurimit 8
4. Dispozita mbi sjelljet e personave që janë përgjegjës fetarisht (mukel-lef) 11
5. Çfarë përfiton njeriu nga adhurimet? .. 13

KAPITULLI 2 PASTËRTIA

1. Roli i pastërtisë në jetesën individuale dhe shoqërore 25
2. Rëndësia që Islami i kushton pastërtisë 25
3. Pastërtia dhe llojet e saj 26
4. Marrëdhënia pastërti-adhurim 35
5. Pastërtia si përgatitje e adhurimit 35
6. Mes`hi 41
7. Disa situata të posaçme për femrat 42
8. Pastërtia e personave me çrregullime të justifikuara 43

KAPITULLI 3 NAMAZI

1. Namazi dhe rëndësia e tij 51
2. Llojet e namazit 52
3. Kohët e namazit 53
4. Farzet e namazit 54
5. Vaxhibet e namazit 55
6. Situatat që prishin namazin 55
7. Dispozita të tjera në lidhje me namazin 56
8. Falja e namazit 57
9. Sexhdeja e sehvit dhe e tilavetit 63
10. Namazi në situata të posaçme 64
11. Bashkimi i namazeve 66
12. Xhamia dhe namazi me xhemaat 66
13. Roli shoqëror i xhamive 67
14. Etika e xhamisë 68
15. Namazi me xhemaat 69
16. Çfarë përfiton njeriu nga adhurimi i namazit? 70

KAPITULLI 4 AGJËRIMI

1. Agjërimi dhe rëndësia e tij 77
2. Termat themelore në lidhje me agjërimin 77
3. Llojet e agjërit 80
4. Muaji i Ramazanit dhe agjërimi si farz ... 81
5. Nijeti dhe koha e agjërit 82
6. Situatat në të cilat mosmbajtja e agjërit është e lejuar 82
7. Situatat që prishin agjërimin 83
8. Shlyerja e agjërit dhe situatat që nevojiten për të 84
9. Kazaja e agjërit dhe situatat që nevojiten për të 84

10. Situatat që nuk e prishin agjërimin 85
11. Situatat që janë mekruh për agjëruuesin 85
12. Çfarë përfiton njeriu nga adhurimi i agjërit? 86

KAPITULLI 5 ZEKATI DHE SADAKAJA

1. Ndjenja e ndihmesës dhe e solidaritetit të njeriu 93
2. Rëndësia që Islami i kushton ndihmesës dhe solidaritetit 93
3. Sadakaja 94
4. Zekati si adhurim i ndihmesës dhe solidaritetit 97
5. Konceptet themelore për zekatin 98
6. Personat që duhet të japin zekat 99
7. Personat që duhet t'u jepet zekat 100
8. Mallrat nga të cilat duhet të jepet zekat 101
9. Çfarë përfiton njeriu nga adhurimi i zekatit? 103
10. Çfarë përfiton shoqëria nga adhurimi i zekatit? 104
11. Ndarja e gëzimeve 104
12. Ndarja e hidhërimeve 107
13. Institucionet e ndihmesës dhe solidaritetit në traditën turko-islame 112

KAPITULLI 6 HAXHI DHE KURBANI

1. Haxhi dhe rëndësia e tij 121
2. Koncepte që lidhen me haxhin 122
3. Vendet që lidhen me haxhin 123
4. Llojet e adhurimit të haxhit 125
5. Kryerja e adhurimit të haxhit 126
6. Umreja 127
7. Çfarë përfitojnë shoqëria dhe individët nga adhurimi i haxhit? 128
8. Kurbani 129

KAPITULLI 7 DUAJA DHE PENDIMI

1. Koncepti i duasë dhe brendia e tij 141
2. Përkufizimi i duasë dhe rëndësia e saj 142
3. Duaja si mjet komunikimi 143
4. Çfarë përfiton njeriu nga duaja? 145
5. Shembuj duash nga Kur'ani dhe nga Hz. Pejgamberi 146
6. Koncepti i pendimit dhe brendia e tij 148
7. Vendi i pendimit në jetën e njeriut 150
8. Shembuj pendimesh nga Kur'ani Famëllartë 151

- Çelësi i përgjigjeve 157
Bibliografi 158

Parathënie



Allahu, zotëruesi i mëshirës dhe i dhembshurisë, e ka krijuar njeriun në formën më të bukur, e ka pajisur atë me aftësi të larta, e ka përcaktuar si krijesa, ndaj së cilës drejtohet thirrja hyjnore, e ka nderuar dhe i ka ngarkuar përgjegjësi atij. Në jetën e kësaj bote nuk e ka lënë vetëm atë, e ka nxjerrë nga errësira e mosbesimit dhe, për të bërë të mundur që ai të arrijë në një moral të bukur e të shndritshëm, ka dërguar peygamberë dhe libra si ndihmë e mirësi hyjnore.

Feja, fillesat e së cilës nisin bashkë me njeriun e parë, është një nevojë ekzistenciale për njeriun. Feja është një tërësi këshillash kundrejt gjithë jetës. Ajo na mëson tërësinë e fesë dhe kuptimin përfundimtar, bën të mundur vendosjen e ekuilibrit mes botës dhe ahiretit, mendjes dhe shpirtit, fitimin e harmonisë dhe të paqes së brendshme, sjell dashuri dhe drejtësi, i shndërron detyrat tona individuale dhe shoqërore në një përgjegjësi në cilësinë e adhurimit.

Njeriu, i cili mundohet të kuptojë veten, gjithësinë dhe Krijuesin e tij, që e do Atë dhe është i lidhur me Të, duke ecur në rrugën e përfaqësuesve të mëshirës dhe të librave hyjnorë, të cilët i ka dërguar Krijuesi, e ka orientuar atë në kuptimin e robërimit dhe të vërtetës.

Në këtë pikëpamje, plotësimi i nevojës së njeriut me informacion të drejtë për fenë, është i rëndësishëm.

Meqë feja ka si synim parësor njeriun, është e rëndësishme që të bëhet një përtëritje e vetes në mënyrë të përhershme nëpërmjet informacioneve fetare, me qëllim që jeta të shndrijë, të freskohet mesazhi i Islamit në mendje dhe në zemra, të formohet një lidhje dinamike mes dijes dhe jetës. Në këtë kuadër, Kryesia e Çështjeve Fetare ka përcaktuar si objektiv ndriçimin e popullit tonë me informacion fetar, mbajtjen larg besëtytnive, realizimin e kësaj nevoje me informacione të sakta fetare mbi çështje të besimit, adhurimit, sijaerit dhe moralit, duke marrë parasysh edhe të dhënat bashkëkohore e shkencore. Për këtë arsye, ajo ka planifikuar një kolanë të titulluar "Informacione themelore për Islam". Vepra që keni në dorë, me titull "Adhurimi im", është e katërta e kësaj kolane dhe është përgatitur sipas programit mësimor Informacione Themelore Fetare, mësim i cili jepet në kurset fetare të varura nga Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë.

Në vepër jemi fokusuar mbi çështjen e moralit, si një ndër çështjet themelore të fesë islame. Në vijim janë trajtuar çështjet e përkufizimit të moralit, të vlerave morale, rëndësia që Islami i kushton moralit, veçoritë e njeriut model që parashikon morali islam, qasja e Islamit ndaj të drejtave themelore, si dhe modelet e sjelljeve nga disa personalitete shembullore që kanë jetuar gjatë procesit të formimit dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore.

Dëshira jonë më e madhe është që ky punim të jetë i dobishëm për lexuesit.

Vullneti nga ne, suksesi nga Allahu.

ឧទ្ទិសដល់
ឧទ្ទិសដល់



KAPITULLI


1





Adhurimi im

1. Përkufizimi i adhurimit
2. Qëllimi dhe rëndësia e adhurimit
3. Llojet e adhurimit
4. Dispozita mbi sjelljet e personave që janë përgjegjës fetarisht (mukel-lef)
5. Çfarë përfiton njeriu nga adhurimet?



RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull:

- Tregohet natyra, llojet, mënyra e kryerjes dhe qëllimi i adhurimeve. Në këtë kontekst jepen shpjegime të përmbledhura në lidhje me namazin, agjërimin, zekatin dhe haxhin, si dhe të dhëna mbi veprat e mira dhe sadakanë.
- Në vijim trajtohen dispozitat që kanë të bëjnë me personat e konsideruar përgjegjës fetarisht (mukel-lef) dhe sjelljet e tyre. Në këtë kuadër shpjegohen edhe disa terma themelore në lidhje me jetesën fetare, të cilët kanë një rol të rëndësishëm në kuptimin e çështjeve fetare.
- Së fundi trajtohet çështja e përfitimeve të njerëzve nga kryerja e adhurimeve.

SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Pasi të keni përfunduar këtë kapitull:

1. Do të mund të zotëroni informacione të shkurtër mbi kuptimin e adhurimeve, natyrën, llojet dhe qëllimin e tyre.
2. Do të mund të kuptoni brendinë e koncepteve 'vepër e mirë' dhe 'sadaka'.
3. Do të mësoni konceptet themelore, të tilla si: farz, vaxhib, sunnet, mubah, mekruh dhe haram, të cilat në literaturën fetare emërtohen si 'veprat e personit përgjegjës fetarisht'.
4. Do të mund të zotëroni një mendim në lidhje me përfitimet që ka njeriu nga adhurimet.

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

1. Mundohuni të përfitoni të dhëna mbi jetën adhurimore të Pejgamberit dhe sahabeve.
2. Studioni ajetet e Kur'anit në lidhje me veprat e mira.
3. Shihni hadithet që kanë të bëjnë me sadakanë.
4. Mundohuni të kujtoni adhurimet dhe veprat, të cilat në jetesën tonë fetare i kryejmë në dispozitën e farzit, vaxhibit dhe sunnetit.
5. Merrni të dhëna paraprake nga veprat e ilmihalit mbi çështjen e akteve, të cilat personat në pozitën mukel-lef janë përgjegjës t'i kryejnë.
6. Mos u mjaftoni vetëm me punimin që keni në dorë për të mësuar. Studioni edhe veprat që mund të siguronin nga literatura në fund të këtij libri.

1**Përkufizimi i adhurimit**

Nga pikëpamja etimologjike, fjala “adhurim” ka kuptimin e shprehjes së robërimit, të nënshtrimit dhe të bindjes, ndërsa si koncept fetar mund të përkufizohet në dy kontekste: në një kontekst më të zgjeruar, adhurimi nënkupton qëndrimet dhe sjelljet që kryhen me një nijet të mirë dhe në këmbim të të cilave përfitohen sevape, me qëllim lartësimin e Allahut, shprehjes së dashurisë, të respektit dhe të vartësisë ndaj Tij. Brenda këtij përkufizimi përfshihen edhe adhurimet që kryhen në një kontekst më të kufizuar dhe në vartësi të kushteve, por edhe veprimet e kryera nga personi që shpreson në pëlqimin e Allahut. Në kuptimin e ngushtë dhe të gjerë adhurimi përkufizohet në trajtën: ‘Vepra specifike, që synojnë afrimitetin me Allahun në lidhje me nijetin e shprehur paraprakisht’, siç është falja e namazit dhe mbajtja e agjërimit.

Sa i përket shprehjes së robërimit, adhurimi është niveli më i lartë i bindjes, vartësisë dhe respektit ndaj Allahut.

**A e dini se...**

Parimet që kanë të bëjnë me thelbin e adhurimeve janë përcaktuar nga vetë Allahu i Lartmadhëruar, ndërsa fakti se si dhe në ç’mënyrë do të kryhen është treguar në mënyrë të hollësishme dhe praktikisht nga Pejgamberi (s.a.s.). Njerëzit nuk mund ta përcaktojnë nga mendja e tyre një mënyrë adhurimi, por as nuk mund të shpikin një adhurim të ri.

**7****2****Qëllimi dhe rëndësia e adhurimit**

Ndërsa shohim gjithësinë kuptojmë se ajo është krijuar sipas një rregulli që të fal admirim. Pasi kundrohen bukuritë dhe harmonia e gjithësisë është e pamundur të mos ndihet një admirim i thellë ndaj Krijuesit të tyre, gjë që aludohet edhe në ajetin e mëposhtëm: “Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...” (*Fatir, 35/28*). Tek ata individë, te të cilët pastërtia krijimore nuk është prishur, me kalimin e kohës, ky admirim shndërrohet në dashuri, përtej së cilës nuk mund të mendohet ndonjë dashuri tjetër.

Njeriu që orientohet nga Allahu dhe e do Atë, si rezultat i kësaj dashurie shpreh edhe adhurim. Mbi të gjitha, është vetë njeriu që e ka të nevojshme këtë. Në themel të nevojës së adhurimit të njeriut ndaj Allahut gjendet pikërisht kjo dashuri.

Ai që e do Allahun me përkushtim, qëndron larg sjelljeve që bien ndesh me pëlqimin e Tij. Për këtë arsye, në çdo sjellje që kryen dhe për çdo veprim gjen mënyra për të qëndruar larg të këqijave. Në çdo kohë dhe në çdo vend sillet bukur dhe e di se Allahu i do

ata që sillen bukur. Gjithmonë vepron me durim dhe është i ndërgjegjshëm se Allahu i Lartmadhërua i do durimtarët. Shpreh gjithmonë nënshtrim ndaj Zotit të tij, të cilin e do shumë, mbështetet tek Ai dhe i beson Atij, pasi e di se Allahu i do ata që nënshtrohen. Në çdo punë dhe lëvizje të tij sillet në mënyrë të ekuilibruar dhe të matur. Kurrë nuk i shpërdoron në mënyrë të shfrenuar dhe pa kriter mirësitë që i ka dhuruar Allahu, sepse Allahu nuk i do ata që shpërdorojnë pa kriter. Në këtë mënyrë, ai mundohet ta jetojë Islamin si tërësi dhe në mënyrën që e tregon Allahu dhe i Dërguari i Tij. Duke vepruar me ndjeshmërinë e një besimtarit të bindur, ai bëhet një rob, të cilin Allahu e njeh si mik.

Allahu i Lartmadhëruar, në Kur'anin Famëlartë bën të ditur se njerëzit dhe xhindet janë krijuar për të shprehur robërim ndaj Tij. Muslimani që plotëson adhurimet dhe vepron me vetëdijen e robërimit jeton me një harmoni të madhe në zemër, përjeton lumturinë e lidhjes së zemrës me Allahun. Sa më shumë i vazhdon adhurimet, aq më shumë largohet nga të këqijat.



Le të mendojmë

- Adhurim është mënyra e shprehjes së lidhjes ndaj Allahut.
- Adhurimi është nënshtrim ndaj vullnetit të Tij.
- Adhurimi është nënshtrim ndaj Tij dhe vetëdije se çdo gjë është në dorën e Tij.
- Adhurimi ose ibadeti është një simbol që tregon pranimin e sovranitetit të pakufishëm të Tij.



Të diskutojmë së bashku

Flisni me shokët tuaj në lidhje me qëllimin dhe rëndësinë e adhurimit!



Llojet e adhurimit

Adhurimin mund ta klasifikojmë në tri kategori: adhurim në formën fizike, adhurim në trajtën financiare dhe adhurim në formën fizike e financiare njëkohësisht. Duke iu referuar ndarjes së mësipërme, namazi dhe agjërimi i përkasin adhurimit fizik, zekati dhe kurbanit i përkasin adhurimit financiar, ndërsa haxhi është një adhurim si fizik, ashtu edhe financiar.

Nëse merren parasysh të gjitha sjelljet e kryera me qëllim fitimin e pëlqimit të Allahut dhe shumëzohen me zero të gjitha veprat e kryera më parë, adhurimi nuk trajtohet me kuptimin e tij si koncept, por në kuptimin e gjerë. Nga kjo pikëpamje, adhurimet mund t'i klasifikojmë në dy kategori: në adhurime, mënyra dhe kushtet e të cilave janë përcaktuar fetarisht dhe në adhurime, mënyra dhe kushtet e të cilave nuk janë përcaktuar fetarisht.

Adhurime me mënyrë dhe kushte të caktuara fetarisht

Namazi

Namazi zë vendin kryesor ndër të gjitha adhurimet, mënyra dhe kushtet e të cilave janë të caktuar fetarisht. Namazi është shtylla e fesë. Falja e pesë kohëve namaz në kohë të caktuara të ditës është detyrë e çdo muslimani që gjendet në pozitën e personit përgjegjës fetarisht, qoftë femër, qoftë mashkull. Përveç kësaj, ka edhe namaze që emërohen si 'nafile', të cilat falen për të përfituar sevape në mënyrë vullnetare, për t'u afruar me Allahun dhe për t'u pastruar. Të dhëna më të hollësishme në lidhje me namazin janë dhënë në kapitullin përkatës.

Agjërimi

Agjërimi është njëri ndër kushtet e Islamit. Agjërimi përkufizohet si më poshtë: "Qëndrimi larg ushqimit dhe kryerjes së marrëdhënieve seksuale nga koha e imsakut deri në kohën e iftarit, me nijet adhurimi." Agjërimi i Islamit është njëri ndër kushtet e Islamit. Po ashtu, ka edhe agjërimë që mbahen jashtë muajit të Ramazanit, me idenë e fitimit të sevapeve. Të dhëna më të hollësishme mbi këtë çështje do të gjeni në pjesën kur trajtohet agjërimi.

Zekati

Zekati është njëri ndër kushtet e Islamit. Ai është një adhurim financiar. Në kapitullin që i është kushtuar zekatit do të gjeni të dhëna të detajuara në lidhje me këtë adhurim financiar, për të cilin, muslimanët e pasur fetarisht kanë përgjegjësinë të paguajnë në masë të ndryshme, në përputhje me llojin dhe sasinë e kursimeve financiare të tyre (në përgjithësi një në dyzet).

Haxhi

Haxhi është njëri prej pesë kushteve të Islamit, i cili përkufizohet në formën e "kryerjes së Arafatit në një kohë të caktuar dhe në përputhje me metodën e duhur, pasi personi të ketë hyrë në ihram, me vizitën e Qabesë duke bërë tavaf dhe kryerjen e disa detyrave të tjera fetare. Haxhi është një adhurim si financiar, ashtu edhe fizik. Personi që plotëson këtë adhurim quhet haxhi. Të dhëna të tjera në lidhje me haxhin do të jepen në kapitullin përkatës.

Adhurimet që lidhen me mënyrën dhe kushtet fetare

Qëndrimet dhe sjelljet që nuk janë të lidhura me mënyrën dhe kushtet fetare, të cilat kur plotësohen në përputhje me pëlqimin e Allahut i përfitojnë sevap personit që i kryen, janë adhurime në kuptimin e gjerë. Për të qenë njeri i mirë dhe si rrjedhojë edhe një musliman i mirë e i hairit, çdo lloj qëndrimi dhe sjelljeje e bukur që kryen personi, përfshihet te këto adhurime. Për këtë mund të jepen si shembull mjaft sjellje të bukura, të tilla si: të jesh buzagaz ndaj njerëzve apo të kontribuosh ndaj personave apo shërbimeve shoqërore. Të tilla veprime mund të përmbledhen me shprehjet 'sadaka' dhe 'vepër e mirë', pra sjellje e mirë, e dobishme dhe e bukur.





Të studiojmë – Të mësojmë

Vlerësojeni adhurimin në kuptimin e gjerë duke e ilustruar me shembuj.

Vepra e mirë

Megjithëse koncepti i veprës së mirë i përfshin që të dyja llojet e adhurimit, ai na kujton kryesisht sjelljet e mira, të dobishme dhe të bukura.



“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, me siguri do t’i radhisim në mesin e të mirëve” (*Ankebut, 29/9*).



Të studiojmë – Të mësojmë

Cili person quhet vepërmirë? Jepni shpjegimet tuaja.

‘Kur fjala ‘salih’ përdoret për të cilësuar sjelljet dhe veprimet e njeriut, kjo fjalë ka kuptimin ‘e mirë, e volitshme, e dobishme dhe e bukur’. Në përgjithësi ajo përdoret krahas veprimit që e cilëson, në formën ‘Ameli Salih’: vepër e mirë. Sipas kësaj, vepër e mirë do të thotë vepër e volitshme, e bukur dhe e dobishme. Çdo punë, të cilën Allahu kërkon të bëhet, që është e hairit, e dobishme dhe pozitive, përfshihet te veprat e mira dhe të bukura.

Vepra e mirë bën të mundur që personi të jetë në paqe me Krijuesin e tij dhe me të gjitha krijesat.



Le të kujtojmë

Vepra e mirë është çdo lloj fjale, vepre dhe sjelljeje që kryhet në përputhje me Kur’anin dhe Sunnetin, të cilat shprehen po ashtu me singeritet dhe njet të mirë, si domosdoshmëri e besimit.

Veprat e mira bëhen shkak për forcimin dhe rrënjosjen e besimit të njeriut. Ato e mbrojnë besimin, e afirmojnë personin dhe bëjnë të mundur që të bëhet një njeri më i mirë dhe i dobishëm.



“Atij që bën vepra të mira dhe është besimtar nuk do t’i mohohet përpjekja. Ne ia shënojmë edhe këtë atij” (*Enbija, 21/94*).

“Për kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën dhe durimin” (*Asr, 103/1-3*).

“Pa dyshim, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ata janë edhe krijesat më të mira” (*Bejjine, 98/7*).

4

Dispozita në lidhje me sjelljet e personit fetarisht përgjegjës

Personi që është fetarisht përgjegjës (mukel-lef)

Mukel-lefijet, pra përgjegjësia fetare, nënkupton urdhrat dhe ndalesat fetare që i drejtohen individit. Për këtë nevojitet që personi të ketë shëndet të plotë mendor (akill) dhe të jetë i pjekur në aspektin e gjykimit (ergin). Ai që bart këto cilësi quhet mukel-lef (përgjegjës).

Terma që lidhen me përgjegjësitë fetare

Dispozitat ndaj personave fetarisht përgjegjës janë: farz, vaxhib, sunnet, mustehab, mubah, haram, mekruh dhe mufsid.

Farz

Përgjegjësia fetare, e cila kërkohet të kryhet në formë të prerë dhe nëpërmjet një argumenti të prerë quhet farz. Kështu, përgjegjësitë fetare që Allahu dhe i Dërguari i Tij kërkojnë që të kryhen në mënyrë të prerë dhe kushtëzuese nga personi fetarisht përgjegjës, përfshihen në kategorinë e farzit, të tilla si: falja e namazit, mbajtja e agjërimit dhe dhënia e zekatit.

Ajeti në trajtën: "Falenë namazin, jepenë zekatin!" (Bakara, 2/43) është një argument që thekson pikërisht farzin. Po ashtu, ajetet Kur'anore që urdhërojnë drejtësinë, mirësinë, ndihmesën dhe solidaritetin ndërfishnor, mirësinë ndaj prindërve, moscenimin e pasurisë së jetimit (Bakara, 2/183; Nahl, 1/90; Isra, 17/23, 34), janë shembuj për argumentet që theksojnë urdhëresat në kategorinë farz.

**Të diskutojmë së bashku**

Ç'do të thotë argument? Diskutoni në klasë

**Të studiojmë – Të mësojmë**

Cili është kuptimi i farzi ajn dhe farzi kifaje? Studioni!

**Të diskutojmë!**

Çfarë përgjegjësish i sjell individit braktisja e farzeve? Diskutoni!

Vaxhib

Edhe vaxhibi, ashtu si farzi, është një përgjegjësi fetare, kryerja e të cilit kërkohet në mënyrë të prerë dhe kushtëzuese. Në pikëpamje të argumentit, dispozita vaxhib nuk është aq e fuqishme sa farzi, duke qenë se argumenti i tij nuk është i prerë sa farzi. Namazi i vitrit dhe namazi i Bajramit janë shembuj për vaxhibin.





Të diskutojmë së bashku

Ç'kuptoni me argument në formë jo të prerë? Diskutoni në klasë!

Sunnet

Në kategorinë e sunnetit përfshihen ato vepra, të cilat kërkohen të kryhen pa qenë në pozitën e farzit dhe vaxhibit, vepra që janë kryer nga Pejgamberi dhe kryerja e të cilave është kërkuar nga ai.

Sunneti ndahet në dy kategori: sunneti muekkede dhe sunneti gajri muekkede.

Sunneti muekkede quhen adhurimet, sjelljet dhe veprat, të cilat Pejgamberi ynë i dashur i ka kryer vazhdimisht dhe të cilat nuk i ka braktisur thajse kurrë. Të tilla janë sunnetet e namazit të sabahut, të drekës dhe të akshamit. Te sunnetet që nuk janë muekked përfshihen veprat në pozitën e plotësuesit të detyrave fetare dhe sunnete që Hz. Pejgamberi ka vazhduar t'i kryejë, por që i ka braktisur ato herë pas here, për të treguar se nuk janë kushtëzuese. Sunnetet gajri muekked Pejgamberi ynë i ka kryer herë pas here me qëllimin e adhurimit. Në këtë kategori përfshihen sunnetet e para të namazit të jaciesë dhe të ikindisë.



Le të kujtojmë

Sjelljet që Pejgamberi i ka kryer në pozitën e njeriut, të tilla si etika e të ngrënit, të pirit, të veshurit dhe të fjeturit, pra, pa pasur qëllim adhurimi, janë sjellje të ardhura në formën e zakonit dhe quhen sunnet dhevaid ose sunnete zakoni që bëhen në shtesë të sunneteve të përcaktuar.

Mustehab

Mustehab është një term, i cili ka kuptimin e diçkaje dhe një veprimi që dëshirohet, që është e këndshme, e hijshme dhe e parapëlqyer. Në literaturën e jurisprudencës fetare ky koncept nënkupton disa adhurime dhe sjellje, të cilat Pejgamberi ynë herë i ka kryer e herë i ka braktisur, siç është, për shembull, namazi i paradites.

Mubah

Në konceptin 'mubah' përfshihen ato vepra, kryerja apo moskryerja e të cilave është e lejuar fetarisht. Ky koncept ka kuptimin: 'vepër e shprehur dhe e kryer qartazi, që konsiderohet si e lejuar fetarisht'. Për shembull, të shtrihesh të flesh dhe të pushosh, me qëllim që të punosh e të korrësh fitim të lejuar, të hash apo të pish me qëllim që të përgatitesh për adhurim, janë pikërisht vepra që përfshihen në këtë kategori. Nëse braktisja e disa veprimeve të lejuara bëhet shkak për dëmtimin e shëndetit të personit ose për vonimin e kryerjes së përgjegjësisë, në këtë situatë, krahas braktisjes së veprimit të lejuar, personi hyn në gjynah. Për shembull, të mos hash dhe të mos pish deri në atë masë sa të rrezikosh shëndetin, është një veprim që përfshihet pikërisht në këtë kategori.

Kriteret, për të cilat nuk ka asnjë ndalesë ose kufizim fetar përfshihen te veprat e lejueshme fetarisht.

Haram

Ajo vepër, kryerja e së cilës sipas fesë sonë është ndaluar me një argument të prerë dhe në një formë kushtëzuese, quhet haram. Të vrasësh një qenie njerëzore pa pasur të drejtë, të gënjesh, të cenosh të drejtën e dikujt tjetër, të shpifësh ndaj femrave të ndershme, të kryesh marrëdhënie seksuale jashtëmartesore, të vjedhësh, të konsumosh pije alkoolike, të luash bixhoz, të hash mish derri dhe të kundërshtosh prindërit janë vepra haram, pra të ndaluara.



Le të kujtojmë

- Personi që kryen vepra haram meriton të dënohet dhe të qortohet, ndërsa personi që shmanget nga harami fiton sevape.
- Personi që mohon haramin del nga feja, ndërsa të konsiderosh si të lejuar diçka që dihet në formë të prerë fetarisht se është haram, dëmton besimin e personit.

Mekruh

Mekruh është një term, i cili vjen në kuptimin e veprave të papëlqyera, të konsideruara të këqija dhe të pakëndshme. Në jurisprudencën fetare ky term jepet me kuptimin e një veprimi, i cili kërkohet fetarisht në formë të prerë dhe jokushtëzuese që të mos kryhet. Veprimet mekruh ndahen në dy kategori: tahrimen mekruh është veprimi mekruh pranë haramit. Ndërsa tenzihen mekruh është veprimi mekruh pranë hallallit.



Të studiojmë–Të mësojmë

Studioni dhe mësoni shembuj nga veprimet mekruh të kategorisë tahrimen dhe tenzihen.

Mufsid

Fjala mufsid ka të njëjtën rrënjë fjale me fjalët fesad, fasid dhe ifsad. Fesad do të thotë çrregullim, fasid e prishur, ndërsa ifsad do të thotë prishje. Kur themi mufsid në fushën e adhurimeve synojmë një veprim që prish një adhurim të nisur dhe që e bën të pavlefshëm atë. Nga kjo pikëpamje, mangësitë dhe sjelljet që bëhen shkak për prishjen e një adhurimi të nisur në përputhje me mënyrën e duhur dhe që e bëjnë të pavlefshëm atë emërtohen si mufsid. Për shembull, çdo gjë që del nga ndonjë pjesë e trupit dhe që prish abdestin, apo të ngrënët dhe të pirët me vetëdije ndërkohë që personi është me agjërim, bëhen shkak që ky veprim të cilësohet si mufsid.



Çfarë përfiton njeriu nga adhurimet?



Në mjaft veprime, të cilat feja jonë e lartë, Islami, urdhëron t'i kryejmë apo jo, gjenden shumë uredi e dobi. Edhe në veprat që ka përcaktuar si haram dhe që i ka ndaluar, pa dyshim ka disa dëme për ne. Feja jonë nuk ndalon vepra që janë të dobishme për njeriun, po ashtu as nuk urdhëron vepra që janë të dëmshme për të.

Dobitë e kësaj bote dhe të botës së përtejme të çdonjërit prej adhurimeve mund të mësohen dhe studiohen në literaturën fetare. Si shtesë e përfitimeve në ahiret, për shkak të respektimit të urdhërësave dhe ndalesave, mund të mendojmë edhe mbi përfitimet e tyre në botë. Por, nuk duhet të harrojmë se qëllimi kryesor i adhurimeve është të afirmojë njerëzit shpirtërisht, të pengojë orientimet ndaj së keqes dhe t'i lartësojë ata moralisht.



Nëse mund ta themi në mënyrë të përmbledhur, adhurimet, si mjet për përmendjen e Allahut, vendosin në zemrat tona dashurinë dhe respektin ndaj Allahut. Ato na largojnë nga çdo lloj e keqeje dhe na përçojnë në bukuri morale. E mbrojnë shpirtin tonë nga ndikimi lëndues i shqetësimeve dhe mërzive të ndryshme. Sepse zemrat arrijnë në paqe vetëm duke përmendur Allahun.



“Janë ata që besojnë, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!” (Ra’d, 13/28).

Adhurimet e afrojnë njeriun me Allahun

Respektimi i kritereve dhe masave që ka vendosur Allahu për njerëzit e forcon marrëdhënien e tij me Të. Robi që mundohet të realizojë kriteret e Tij, me këtë qëndrim forcon lidhjen ndërmjet tij dhe Allahut. Adhurimet janë ndër demonstrimet konkrete të kësaj lidhjeje. Për shembull, një musliman që fal pesë kohë namaz në ditë, me çdonjërin prej namazeve forcon edhe më shumë lidhjen e tij me Allahun. Një person që qëndron në praninë e Allahut tregon se e kujton Allahun, se nuk e ka harruar atë. Një njeri, i cili një pjesë të pasurisë ua jep si zekat të varfërve, e forcon edhe më shumë lidhjen me Të, duke plotësuar urdhrin e Allahut në këtë pikë. E njëjta situatë vlen edhe për agjërimin dhe adhurimet e tjera.

Kryerja e adhurimeve njësoj sikur Allahu po të vëzhgon, tregon forcën e kontaktit të robit me Krijuesin e tij. Sigurisht, Allahu i Lartmadhëruar nuk e lë pa shpërblim afrimitetin dhe sinjeritetin e një robi ndaj tij; nuk lë pa vlerësuar përpjekjen e atij që mundohet të forcojë lidhjen me të dhe të krijojë kontakt me të. Ndaj atij që dëshiron të forcojë lidhjen me të, Allahu krijon më shumë mundësi që të mirat materiale e shpirtërore të veprojnë në dobi të tij.

Adhurimi është njëkohësisht edhe falënderim. Falënderimi është njëra ndër rrugët më të rëndësishme të forcimit të marrëdhënies mes Allahut të Lartmadhëruar dhe personit, ndërsa adhurimi është shprehja e falënderimit dhe mirënjohjes ndaj mirësive që i janë dhënë personit. Nga kjo pikëpamje falënderimi është njëra ndër mënyrat e komunikimit mes njeriut dhe Allahut.



Le të kujtojmë

Qëllimi i krijimit tonë është të njohim Allahun dhe ta adhurojmë Atë. Pasi kryejmë detyrat e adhurimit, jo vetëm plotësojmë borxhin e falënderimit që kemi ndaj Allahut, por edhe fitojmë dashurinë e Tij.

Adhurimet na falin qetësi të brendshme

Ndër nevojat më kryesore shpirtërore të njeriut vjen besimi dhe adhurimi. Sepse shpirti i njeriut gjen prehje vetëm duke përmendur Allahun. Kjo e vërtetë në Kur’anin Famëlartë shprehet kështu: “Dijeni se zemrat qetësohen vërtet me përmendjen e Allahut!” (Ra’d, 13/28).

Nga ana tjetër, përballja herë pas here me probleme të ndryshme është një realitet i jetës së njeriut dhe adhurimi, sidomos në situata të tilla, është një strehë e rëndësishme shpirtërore për njeriun. Një besimtar që adhuron Allahun, në situata të tilla nuk e humb forcën dhe maturinë. Ai e di se kjo është një sprovë që vjen nga Allahu dhe tregohet i durueshëm. Kështu, në situata të rënda, të cilat duket se nuk mund t'i përballojmë dhe për të cilat nuk ka mbetur shpresë shpëtimi, adhurimi vjen në trajtën e strehës më të rëndësishme për njeriun. Në këtë mënyrë, njeriu që mund t'i drejtohet Allahut të Lartmadhëruar, mund të tejkalojë problemet me të cilat haset në sajë të adhurimeve.

Zhvillon ndjenjën e besueshmërisë

Individi e njeh më mirë veten në sajë të adhurimit dhe arrin në prehje duke ndier besueshmëri ndaj vetes. Kjo sepse ai është në dijeni që Allahu i Lartmadhëruar e sheh atë, se i di nevojat dhe problemet e tij dhe se e vlerëson atë.



“Lexo (o Muhammed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kur’anit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar; vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni” (Ankebut, 29/45).

Adhurimi i krijon mundësinë njeriut që të njohë veten dhe pozitën e tij në këtë botë, por nga ana tjetër ndikon edhe me kontribute të rëndësishme në zhvillimin e aftësive njerëzore. Ai përkufizon ndjenjat dhe prirjet e tepërta. Njeriu, i cili me adhurime pastron botën e brendshme dhe të jashtme nga disa papastërti që i krijojnë shqetësim, arrin kështu në afirmim dhe pjekuri njerëzore. Ky afirmim bën që njeriu të ndiejë vetëbesim në vetvete, pasi i përfiton atij cilësi të bukura njerëzore dhe ndihmon në zhvillimin e tyre. Kështu njeriu fiton aftësinë e dominimit të nefsit. Njeriu që dominon mbi nefsën e tij, nuk lëkundet kundrejt prirjeve të tepërta dhe të dëmshme, por e ndien veten të besueshëm.

Ndër elementet kryesore, të cilat bëjnë të mundur që personi ta ndiejë veten të besueshëm dhe që i falin shqetësim, janë dyshimi, hezitimi dhe kontradiktat. Njeriu që kryen adhurimin e njeh veten dhe pozitën e tij në botë, por njeh edhe Allahun. Çdo gjë në mendjen e tij është vendosur ashtu siç duhet. Prandaj edhe nuk përjeton kompleksitetin e hezitimeve, të dyshimeve dhe të kontradiktave. Ja, pra, njëri prej funksioneve më të rëndësishme të adhurimit është ky kontribut që bën të mundur ekuilibrimin e botës së brendshme të individit. Në sajë të këtij kontributi personi shpëton nga kompleksiteti i dyshimeve.

Njerëzit që realizojnë adhurimet në kuptimin e plotë të fjalës dhe që arrijnë në vetëdijen e domosdoshmërisë së adhurimit falin besim edhe ndaj rrethit të tyre shoqëror, duke u bërë njerëz të besueshëm dhe duke bërë që të gjithë t’u besojnë atyre. Kështu, njerëzit që kryejnë adhurimet jetojnë me besimin që u fal atyre të qenit të sigurt nga vetvetja. Si rrjedhojë, në një shoqëri ku është zhvilluar vetëdija e adhurimit, dominon ndjenja e paqes dhe e besueshmërisë.





Të diskutojmë!

Jepni shembuj nga jeta e përditshme mbi marrëdhënien ndërmjet adhurimit dhe vetëbesimit të individit!

Adhurimet na shmangin nga të këqijat

Njëra prej dobive më të rëndësishme të adhurimeve është se e shmangin njeriun nga të këqijat. Adhurimi dhe e keqja nuk përputhen kurrë me njëra-tjetrën. Nga kjo pikëpamje, njeriu që kryen në mënyrë të vetëdijshme adhurimin, nuk afrohet lehtë me të keqen. Kjo sepse, ndërsa nga njëra anë kryen adhurim, nga ana tjetër, të përzihesh me të keqen tregon mungesë sinqeriteti në marrëdhënien me Allahun. Mirëpo thelbi i adhurimit është sinqeriteti. Adhurimet e kryera pa sinqeritet janë thjesht disa lëvizje formale.

Në Kur'anin Famëlartë bëhet e ditur qartësisht se namazi e shmang njeriun nga të këqijat (Ankebut, 29/45), ndërsa agjërimi e përçon individin në devotshmëri. Devotshmëria ka kuptimin e përgjegjësisë islame. Një njeri që zotëron devotshmëri pa dyshim që qëndron larg të këqijave. Kuptimi i ajetit në lidhje me agjërimin është si më poshtë: "O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu siç u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat" (Bakara, 2/183).

Në një hadith fisnik spikat fakti se Rasulullahu (s.a.s.) këshillon që të qëndrojmë larg të këqijave për të përfituar dobi nga agjërimi. Të rinjve që nuk ishin martuar dhe të cilët për këtë arsye po e zvarrisnin martesën përherë e më shumë, Hz. Pejgamberi i këshilloi që të mbanin agjërim. Kjo këshillë e tij është një argument që tregon edhe se sa na ndihmon agjërimi për të shpëtuar nga ndikimet negative të të këqijave. Në një hadith tjetër agjërimi cilësohet si mburojë (Buhari, Saum, 9; Muslim, Sijam, 163).

Shkurtimisht, njerëzit që e njohin Allahun, që i besojnë Atij dhe që i kryejnë adhurimet në mënyrë të sinqertë si domosdoshmëri e besimit, ngaqë e ndiejnë veten përgjegjës sa i përket vartësisë ndaj parimeve të moralit që thekson feja jonë, u përshtaten adhurimeve dhe mundohen të qëndrojnë sa më larg nga të këqijat. Gjendja e njerëzve është e tillë që, edhe nëse ndonjëherë përzihen me të këqijat, ndiejnë shqetësim në ndërgjegjen e tyre dhe menjëherë shprehin pendim dhe kërkesë për falje. Nëse kanë cenuar ndonjë të drejtë mundohen ta paguajnë këtë, sepse frikësohen nga përballja me Allahun për këto të drejta. Ja, pra, kur merret parasysh ky mentalitet dhe konceptim kuptohet më mirë funksioni i adhurimeve në mbajtjen e njerëzve larg të këqijave.

Adhurimet nxisin solidaritetin shoqëror

Sigurisht, të gjitha adhurimet luajnë një rol shumë të rëndësishëm në solidaritetin shoqëror dhe nuk mund të mendohet se muslimanët, të cilët qëndrojnë krah për krah me njerëz që kanë halle a probleme të ndryshme, të jenë indiferentë ndaj problemeve të vëllezërve të tyre. Po ashtu, muslimanët që përjetojnë gjendjen e njerëzve të uritur, duke mbajtur agjërim, pa dyshim do të vetëdijesohen mbi njerëzit që ndodhen në këtë situatë dhe do t'i ndihmojnë ata. Në të njëjtën mënyrë, edhe në haxh, mes njerëzve që

gjenden në të njëjtin mjedis dhe në të njëjtat kushte, do të lindë konceptimi i solidaritetit social. Pa dyshim, sa i përket këtij kriteri, adhurime financiare si zekati dhe sadakaja e fitrit kanë një vend të veçantë.



Të diskutojmë së bashku

Diskutoni me shokët tuaj mbi mënyrën se si zekati dhe sadakaja e fitrit nxitin solidaritetin shoqëror.

Ndihmesa dhe solidariteti shoqëror, i cili realizohet me anë të adhurimeve, është një shprehje e mbajtjes mbi çdo gjë të dashurisë së Allahut. Ai që do Allahun, do edhe çdo gjë që lidhet me Të, do të gjitha krijesat dhe angazhohet me ta.



“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëllojnë atij që mbjell një kokërr, nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijsëm” (Bakara, 2/261)

Adhurimet kontribuojnë në afrimitetin mes njerëzve

Mes njerëzve mund të ketë afrimitete në trajta nga më të ndryshmet. Por, nga ana tjetër, të mundësosh mes njerëzve dhe në një mënyrë tjetër, një afrimitet aq përfshirës dhe të sqartë sa afrimiteti dhe solidariteti që sjellin adhurimet, kjo është diçka shumë e vështirë. Për individët e një shoqërie, të cilët bashkohen pesë herë në ditë falë kohëve të namazit, që në trajtë më përfshirëse takohen falë namazit të xhumasë dhe po ashtu, në një formë edhe më përfshirëse në namazet e Bajramit dy herë në vit, namazi është një formë shumë e bukur afrimiteti. Në këtë afrimitet, njerëz të shtresave të larta shoqërore dhe njerëzit e zakonshëm gjenden në të njëjtin nivel.

Haxhi është një adhurim, të njëjtat rituale të të cilit të gjithë muslimanët thuajse i kryejnë në të njëjtat kushte, pavarësisht pozitës së cilës i përkasin. Kështu përjetohet një shembull i pashoq afrimiteti mes miliona njerëzish. Të jemi dëshmitarë të një tabloje të tillë në një praktikë tjetër përveç haxhit është shumë e vështirë.

Nga ana tjetër, njëri prej adhurimeve që mundëson afrimitetin më të lartë mes individëve të shoqërisë është zekati. Në këtë adhurim financiar, i pasuri u jep një pjesë të pasurisë të varfërve dhe nevojtarëve në mënyrë vullnetare dhe me vetëdijen e një adhurimit, pa prituri si këmbim asnjë shpërblim material. Kjo situatë bën të mundur afrimitetin e dy shtresave të shoqërisë, mes të cilave mund të ketë më shumë armiqësi (të pasurve dhe të varfërve) dhe parandalon që në fillim armiqësitë e mundshme që mund të lindin mes këtyre dy shtresave. Kjo sepse kur të pasurit të nxjerrin zekatet dhe t’ua japin të varfërve, nuk mbetet asnjë ndjenjë armiqësie ndaj tyre.

Adhurimet na mësojnë durimin dhe altruizmin

Te të gjitha adhurimet gjendet pak a shumë edhe edukimi i durimit. Plotësimi i namazit në kohë të caktuara dhe në një disiplinë të caktuar pa dyshim që kërkon durim. Po ashtu, për plotësimin e haxhit duhet të përballemi njëkohësisht edhe me disa vështirësi dhe

probleme, ku së pari vijnë vështirësitë që burojnë nga udhëtimi. Si shtesë e kësaj gjenden edhe vështirësi a probleme që burojnë nga lëvizja bashkërisht e miliona njerëzve njëkohësisht dhe në të njëjtat mjedise. Të gjitha këto, pa dyshim që kanë nevojë për durim. Njeriu që gjendet në mes të gjitha këtyre vështirësive përjeton dhe mëson në mënyrë aktive durimin dhe përkujdesjen për të tjerët.

Ndërmjet të gjitha adhurimeve, agjërimi është në mënyrë të veçantë një edukim durimi. Në saje të agjërit, kundrejt të gjitha thirrjeve të dëshirave trupore, njeriu mëson të marrë nën kontroll dëshirën për të ngrënë, për të pirë dhe për të kryer marrëdhënie seksuale. Është e pamundur të arrijmë me sukses këtë edukim pa pasur durim.

Zekati është një adhurim që na mëson altruizmin dhe që përfiton vetëdijen e ndarjes së asaj që kemi me të tjerët. Namazi i falur me xhemaat bën të mundur që personi të informohet mbi gjendjen e njerëzve të tjerë dhe në kuadër të vetëdijes së vëllazërimit e shtyn njeriun të mendojë për të tjerët dhe të angazhohet me problemet e tyre.

Adhurimet kontribuojnë në zhvillimin e moralit të bukur

Adhurimi bëhet shkak që individit të pajiset me ndjenja dhe mendime të bukura, duke e pastruar atë nga ndjenjat dhe mendimet e këqija. Ajo që ndikon më së shumti qëndrimet dhe sjelljet e personit, në formë pozitive ose negative, është nijeti. Në përgjithësi, ata që kanë nijet të mirë shprehin sjellje në drejtimin pozitiv, ndërsa ata që kanë nijet të keq shprehin sjellje në drejtimin negativ. Nga kjo pikëpamje, nijeti është një ndër gurët e themelit në aspektin e pjekurisë morale. Parë nga ky këndvështrim, adhurimet ofrojnë kontribut shumë të madh në zhvillimin e moralit të bukur, sepse thelbësore për adhurimet mbetet përshtatshmëria dhe sinqeriteti. Adhurimet dhe sjelljet që kryhen pa sinqeritet nuk kanë asnjë vlerë pranë Allahut. Pejgamberi ynë ka urdhëruar kështu: “Feja është sinqeritet.” Prandaj, personi që kryen adhurim duhet të ketë gjithmonë nijet të mirë. Sepse të qenit e nijetit i pasaktë nuk përputhet me thelbin e adhurimit.

Megenëse përshtatshmëria dhe sinqeriteti janë ndër gurët themelorë më të rëndësishëm të moralit të bukur, mes adhurimit dhe moralit të bukur gjendet një lidhje e detyrueshme.



Të diskutojmë!

Diskutoni mbi marrëdhënien që gjendet mes adhurimeve dhe moralit të bukur!

Adhurimet zhvillojnë vetëdijen e përgjegjësisë

Adhurimet janë ndër “frutat” që na dhuron besimi gjatë zbatimit të tyre. Adhurimet, si njëri ndër funksionet më të rëndësishme në krijimin e vetëdijes së përgjegjësisë së

besimtarit ndaj Allahut, ndihmojnë që ai të veprojë gjithmonë me këtë vetëdije. Me këtë vetëdije besimtari është i ndërgjegjshëm se mirë apo keq, një ditë do të gjykohet për bëmat e tij dhe sipas kësaj mundohet të veprojë. Për shembull, një person që drejtohet drejt Allahut në namaz pesë herë në ditë, nuk e nxjerr nga mendja Allahun. Po ashtu, mundohet të veprojë sipas kritereve që ka vendosur Ai, me vetëdijen se një ditë do të jetë në praninë e Tij dhe se atje do gjykohet për çdo gjë që ka kryer në botë. Po ashtu, adhurimet mundësojnë që personi të jetë i matur dhe i drejtë në çdo punë që kryen. Nëse e ilustrim me shembuj, mund të themi se adhurimet japin një kontribut të rëndësishëm në respektimin e disa përgjegjësive kryesore, të tilla si moskryerja e padrejtësisë nga personi ndërkohë që është i vetëdijshëm mbi përgjegjësinë e fitimit nga e lejuara, qëndrimi larg dredhive sa u përket detyrave që personi merr përsipër me vetëdijen e amanetit, shpëtimi nga egoizmi, përhapja e mirësive, si dhe minimizimi i të këqijave.

Nga ana tjetër, adhurimet kanë edhe cilësinë e disiplinimit të jetës së njeriut. Adhurimet, të cilat njeriu është përgjegjës që t'i plotësojë në kohë të caktuara, e shpëtojnë individin nga mungesa e një objektivi, nga sjellja pa pasur qëllim dhe nga mungesa e përgjegjësisë. Në çdo punë të tij bëhet shkak që të ndiejë në zemër praninë e Krijuesit. Edhe qëndrimet dhe sjelljet e personit që arrin të ketë një përgjegjësi të tillë, brenda shoqërisë, bëhen të matura dhe të rregullta. Një person i tillë shmanget nga padrejtësitë dhe dëmtimi i të tjerëve. Duke shpresuar shpërblimin nga Allahu mundohet t'i ndihmojë të gjithë me aq sa mundet.



Përmbledhja e kapitullit



Adhurimet nënkuptojnë qëndrimet dhe sjelljet e kryera me qëllim që të lartësohet Allahu, të tregohet dashuria, respekti dhe vartësia ndaj Tij; nënkuptojnë qëndrimet dhe sjelljet, në kryerjen e të cilëve gjenden sevape.

Adhurimi është shprehje e vartësisë ndaj Allahut. Ai nënkupton nënshtrimin ndaj vullnetit të Tij. Adhurim do të thotë t'i dorëzohesh Atij dhe të dish se çdo gjë është në duart e Tij. Është simboli që tregon pranimin e sovranitetit të pakufi të Tij në çdo fushë.

Adhurimet që kanë të bëjnë me formën dhe me kushtin ndahen në tri kategori: në adhurime fizike, adhurime financiare dhe në adhurime fizike e financiare njëkohësisht. Namazi dhe agjërimi bëjnë pjesë tek adhurimet fizike; zekati dhe kurbanu bëjnë pjesë tek adhurimet financiare, ndërsa haxhi është edhe adhurim fizik, edhe financiar. Sasinë e tyre dhe mënyrën se si do të kryhen e kanë theksuar Kur'ani dhe Sunneti dhe janë kritere të pandryshueshme. Në këtë kuptim, kompetenca e përcaktimit të dispozitës së adhurimit i përket vetëm Allahut.

Punë të hairit, të dobishme dhe të mira, të tilla si sadakaja, veprat e mira dhe ndihmesa, po ashtu edhe veprimet e harxhimit e kryera për mirësi, janë pranuar nga disa dijetarë si adhurim në kuptimin e gjerë.

Muslimanët që arrijnë në moshën e adoleshencës dhe që janë të shëndetshëm mendërisht, pranohen si fetarisht përgjegjës. Veprat që do të kryejë personi përgjegjës janë tetë: farz, vaxhib, sunnet, mustehab, mubah, mekruh, haram dhe mufsid.



Farz është vepra që kërkohet të kryhet në formë të prerë në fe, njësoj si pesë kohët namaz dhe agjërimi. Çdo person përgjegjës është i ngarkuar me detyrën e plotësimit të farzit. Personi që ka kryer farzin, ashtu siç ka plotësuar detyrën, ka fituar në të njëjtën kohë edhe sevape. Ndërsa ai që nuk e plotëson bëhet gjynahqar dhe dënohet. Ai që mohon farzin del nga feja.

Edhe vaxhibi, njësoj si farzi, është vepër, kryerja e së cilës kërkohet në formë të prerë nga feja. Ndërkaq, në aspektin e argumentit, vaxhibi nuk është aq i fuqishëm sa farzi.

Sunnet janë veprat që kërkohen të kryhen pa qenë në dispozitën e sunnetit, të farzit apo të vaxhibit, si dhe që janë kryer nga Pejgamberi ynë dhe që kërkohen të kryhen edhe nga ne.

Mustehab janë adhurimet që Pejgamberi herë i ka kryer e herë i ka braktisur, janë disa kritere, sjellje dhe punë që lidhen me adhurimet.

Mubah janë veprimet, kryerja apo moskryerja e të cilave është lënë në dëshirën e vetë personit. Të tilla janë ngrënia e ushqimit apo të fjeturit.

Haram janë gjërat që fetarisht kërkohet në formë të prerë të mos kryhen. Të tilla janë vrasja e dikujt apo vjedhja. Personi që kryen haram hyn në gjynah, ndërsa ai që e braktis haramin fiton sevap. Të konsiderosh si të lejuar diçka që dihet prerazi se është haram, është një veprim që e nxjerr personin nga feja.

Veprimet mekruh ndahen në dy kategori: tahrimen mekruh është vepra, kryerja e së cilës kërkohet në formë të prerë. Mirëpo për faktin se argumenti i kësaj është i dyshimtë, nuk është në nivelin e haramit. Tenzihen mekruh është vepra, moskryerja e së cilës është më mirë se kryerja e saj. Megjithatë kryerja e saj nuk shihet si diçka e këndshme, edhe në rast se kryhet nuk ka si shpërblim dënimin.

Mufsid është vepra që prish një adhurim të nisur. Për shembull, të flasësh gjatë faljes së namazit, të hash dhe të pish kur je me agjërim etj..

Te veprat, të cilat feja jonë e lartë, Islami, urdhëron që t'i kryejmë, ka mjaft urtësi dhe dobi, disa prej të cilave i dimë e disa jo. Edhe në veprat e përcaktuara haram dhe që i ka ndaluar, pa dyshim që ka mjaft dëme. Feja jonë ka përcaktuar si parim që të mos ndalojë veprat e dobishme për njerëzit, dhe të mos urdhërojë veprat që mund të jenë të dëmshme.

Adhurimet kanë mjaft dobi. Ato forcojnë lidhjen e njeriut me Allahun dhe e largojnë njeriun nga të këqijat. Adhurimet i falin individit qetësi të brendshme dhe japin kontribute të rëndësishme në ndihmesën dhe solidaritetin social. Ato zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë të njeriut dhe bëjnë që ky i fundit të zotërojë një moral shembullor.



Le t'i hedhim një sy kapitullit



1. Ç'është adhurimi? Përkufizojeni atë.
2. Përse adhurojmë?
3. A përfshihet në kuadër të veprave të mira shpikja e diçkaje në dobi të njerëzimit?
4. Në ç'kuptim vjen termi farzi kifaje? Cilat janë ato vepra që përfshihen te lloji i farzit kifaje dhe që duhet t'i realizojmë në jetë? Jepni shembuj.
5. Si duhet të adhurojmë për të përfituar nga fitimet e adhurimeve?



Pyetje vlerësuese



1. Cila prej fjalive të mëposhtme nënkupton adhurimin si koncept?

- A) Mund t'i kryejmë ashtu siç dëshirojmë, e rëndësishme është nijeti.
- B) Nuk mund t'i bëjmë ashtu siç duam. Kanë disa kushte të caktuara të kryerjes dhe ne jemi të detyruar t'i kryejmë sipas tyre.
- C) Dijetarët e Islamit mund t'i ndryshojnë adhurimet sipas kushteve të kohës, ose mund të theksojnë forma të reja adhurimi.
- D) E rëndësishme është që zemra të jetë e pastër. Nuk ndryshon gjë edhe nëse nuk kryhen adhurimet.

2. Cila nga alternativat e mëposhtme është përkufizim i veprës së mirë?

- A) Një adhurim i lidhur me formë dhe me kusht.
- B) Vepra e mirë nuk ka lidhje me adhurimin.
- C) Janë veprat e mira, të bukura dhe të dobishme. Kur plotësohen ato, personi që i kryen përfiton sevap.
- D) Çdo lloj besimi, fjale, veprë dhe sjellje që nuk është e përshtatshme me pëlqimin e Allahut.

3. Cila prej alternativave të mëposhtme nuk përfshihet në kuadër të veprave të personit përgjegjës?

- A) Farz B) Mekruh C) Mubah D) Fikh

4. Cila nga alternativat e mëposhtme është e gabuar sa u përket përfitimeve të njeriut nga adhurimet?

- A) Forcojnë marrëdhënien e njeriut me Allahun.
- B) E shtyjnë njeriun drejt egoizmit dhe dembelizmit.
- C) E shmangin njeriun nga të këqijat.
- D) Kontribuojnë në zhvillimin e moralit të bukur.

5. Cila është dispozita e zotërimit të dijeve fetare, aq sa një musliman të mund të kryejë adhurimet?

- A) Është mubah. Nëse dëshiron zotëron dije, nëse jo, nuk zotëron. Kjo është diçka që i takon vetë individit.
- B) Është në dispozitën farzi ajn. Nëse nuk zotëron dije mbi këtë çështje do të jetë përgjegjës fetarisht.
- C) Është në dispozitën farzi kifaje. Nëse një pjesë njerëzish në shoqëri zotërojnë dije mbi këtë çështje, përgjegjësia hiqet nga të tjerët.
- D) Është mendub. Do të ishte mirë nëse do të zotëronte dije, por nëse jo, kjo nuk ndryshon gjë.

adhurimi im



KAPITULLI

2





Pastërtia

1. Roli i pastërtisë në jetesën individuale dhe shoqërore
2. Rëndësia që Islami i kushton pastërtisë
3. Pastërtia dhe llojet e saj
4. Marrëdhënia pastërti-adhurim
5. Pastërtia si përgatitje e adhurimit
6. Mes'hi
7. Disa situata të posaçme për femrat
8. Pastërtia e personave me çrregullime të justifikuara

RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull:

- Do të përqendrohemi mbi rëndësinë që ka pastërtia për individin dhe shoqërinë.
- Feja islame i kushton shumë rëndësi pastërtisë dhe e konsideron atë si diçka të pazëvendësueshme për lumturinë e njeriut. Për këtë arsye, rëndësia që Islami i kushton pastërtisë paraqitet në formë të përmbledhur.
- Duke u trajtuar llojet e pastërtisë dhe marrëdhënia pastërti-adhurim, analizohen parapërgatitjet për adhurim, të tilla si abdesti, gusli dhe tejmumi, të cilat i realizojmë në jetën tonë adhurimore.
- Pas kësaj, për shkak të lidhjes me çështjen që po trajtohet, shpjegohen kriteret specifike të femrave që ndodhen në situata të posaçme, si dhe rrethanat e personave me anomali të justifikuara.

SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Pasi të keni përfunduar këtë kapitull:

1. Do të mësoni mbi konceptin e pastërtisë dhe llojet e pastërtisë.
2. Do të keni informacione mbi rëndësinë e pastërtisë në aspekt të jetesës individuale dhe shoqërore.
3. Do të mësoni rëndësinë që feja islame i kushton pastërtisë.
4. Do të keni njohuritë e duhura mbi kuptimin e pastërtisë materiale, konvencionale dhe shpirtërore.
5. Do të keni informacione mbi adhurimet dhe veprimet, të cilat jemi të detyruar t'i plotësojmë në jetesën tonë fetare.
6. Do të mësoni se cilat janë veprimet e posaçme në adhurime, si në rastin kur kemi të bëjmë me situata të veçanta, siç janë menstruacionet, lehonja apo situatat me anomali të justifikuara.
7. Do të jeni të informuar mbi lehtësimet që njihen në adhurim ndaj personave që gjenden në këto rrethana të posaçme në aspekt të jetës adhurimore.

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

1. Vëzhgoni se si merret abdesti dhe tejmumi.
2. Mundohuni të mësoni parimet e fesë islame në lidhje me pastërtinë e trupit, të mjedisit ku jetojmë, si dhe mendoni nëse ka kontradikta ndërmjet qëndrimeve dhe sjelljeve të muslimanëve në ditët e sotme. Nëse ka kontradikta, ç'mund të bëjmë për t'i eliminuar ato?
3. Mundohuni të studioni marrëdhënien mes pastërtisë së zemrës, pra pastërtisë shpirtërore dhe adhurimit, si dhe ndikimet e adhurimeve mbi pastërtinë shpirtërore.
4. Përpiquni të përvetësoni studimet e kryera mbi dobitë e pastërtisë së bërë për adhurimet në aspekt të shëndetit.

1

Roli i pastërtisë në jetën individuale dhe shoqërore



“Pa dyshim Allahu është i bukur. Do të mirën, të bukurën dhe të hijshmen. Është i pastër, do pastërtinë. Është mirëbërës, do mirëbërësin; është bujar, do bujarin. Prandaj mbajeni mjedisin të pastër...” (*Tirmidhi, Edeb, 41*).

Feja islame ka synuar lumturinë e njeriut në botë dhe në ahiret. Për këtë arsye jep këshilla themelore në lidhje me tërësinë e jetës së njeriut.

Është e qartë rëndësia që ka pastërtia për një jetë të paqte, të shëndetshme dhe të pastër. Pastërtia është e domosdoshme si në aspektin personal, ashtu edhe në atë natyral dhe të rrethit shoqëror.

Nga ana tjetër, pastërtia është një element i pazëvendësueshëm për një jetë të shëndetshme. Dihet se shumë sëmundje burojnë nga fakti që nuk respektohen rregullat e pastërtisë. Dihet po ashtu se shumë sëmundje burojnë nga mosrespektimi i rregullave të pastërtisë, se mikrobet krijohen dhe shumohen në mjedise jo të pastra.

Mosrespektimi i rregullave të pastërtisë së trupit apo të mjedisit bëhet shkak për shqetësime të ndryshme dhe për mungesë paqeje. Në të njëjtën mënyrë, edhe mosrespektimi i bukurive morale që mund të cilësohen si pastërti shoqërore, bëhet shkak për probleme dhe vështirësi në pikëpamjen individuale e shoqërore. Si rrjedhojë, për një jetë të ndershme, të respektuar dhe të rregullt, njerëzit duhet të jenë materialisht dhe shpirtërisht të pastër.

2

Rëndësia që i jep Islami pastërtisë



“Pastërtia është gjysma e besimit.” (*Muslim, Taharet, 1. Përveç kësaj shihni edhe: Tirmidhi, Deauat, 86*).

Njëra prej shprehjeve ku paraqitet më bukur rëndësia që feja islame i kushton pastërtisë është hadithi në vijim: “Pastërtia është gjysma e besimit.” Në Kur’anin Famëlartë, në hadithet e Hz. Pejgamberit dhe në jetesën e tij shembullore ka një këmbëngulje të theksuar mbi rëndësinë dhe domosdoshmërinë e pastërtisë. Në këtë pikë, shumica e kriterëve të pastërtisë që janë theksuar, gjenden në kuadër të parimeve universale të pastërtisë. Që nga fillimi i njerëzimit, të gjithë pejgamberët kanë bërë paralajmërime shumë të rëndësishme në lidhje me respektimin e rregullave të pastërtisë. Më së fundmi, Kur’ani Famëlartë dhe Sunneti i kanë përcaktuar në formën më të bukur dhe më të

përsosur parimet universale të pastërtisë.

Feja islame kërkon që njerëzit të jenë të pastër në çdo aspekt. Si domosdoshmëri e kësaj urdhërohet që muslimani të ketë të pastër trupin, veshjen, vendin ku banon, ushqim që han dhe pi, si dhe vendin ku bën adhurim. Kur shihet nga ky aspekt, respektimi i rregullave të pastërtisë nga muslimanët është në të njëjtën kohë një detyrë që buron nga besimi.

Pastërtia materiale dhe shpirtërore që kërkohet tek adhurimet janë treguesit konkretë të rëndësisë që feja jonë e lartë, Islami, i kushton pastërtisë. Kjo sepse njeriu duhet të dalë përpara Allahut në një gjendje të pastër, si një shprehje e respektit ndaj Tij. Përveç kësaj, dalja e njeriut në formë krejt të pastër, si materialisht ashtu edhe shpirtërisht, është e rëndësishme edhe në aspektin e angazhimit të personit më së shumti me adhurim.

Nga kjo pikëpamje, sidomos gjatë faljes së namazit, është përcaktuar si kusht që personi të mos qëndrojë në praninë shpirtërore të Allahut pa qenë i pastër.



Të diskutojmë së bashku

Ç'dallim ka mes pastërtisë së përditshme dhe pastërtisë që bëhet për adhurim? Diskutoni.

26

3

Pastërtia dhe llojet e saj

Pastërtia ndahet në tri kategori: pastërtia materiale, pastërtia shpirtërore, si dhe pastërtia konvencionale, që përfshin si pastërtinë materiale, ashtu edhe atë shpirtërore.

Pastërtia e trupit, pastërtia e ushqimeve dhe pastërtia e mjedisit përfshihen në pastërtinë materiale.

Abdesti dhe gusli përfshihen te pastërtia konvencionale, ku hyjnë edhe pastërtia materiale dhe ajo shpirtërore.

Në një tjetër këndvështrim, të pastrohemi nga veçoritë e këqija, që mund t'i quajmë ndotje shpirtërore dhe të pajisemi me veçori të bukura morale, është një pastërti shpirtërore.

Pastrimi nga njëri prej shkaqeve të pastërtisë materiale dhe nga papastërtitë që cilësohen si 'Nexhaset' realizohet me pastrimin e trupit, të veshjes, si dhe të vendit ku falim namaz nga gjërat që konsiderohen si të pista. Ky quhet 'pastrim nga papastërtitë'.

Ndërsa pastrimi konvencional që kërkohet për adhurimet ka të bëjë me eliminimin e gjendjes së mungesës së abdestit ose të gjendjes së xhunubit. Kjo quhet 'Pastërti ndaj hadethit (papastërtisë konvencionale)'.



Hadethi përfshin mungesën e abdestit dhe të xhunubit. Edhe situatat e posaçme të femrave, siç janë menstruacionet dhe lehonja, nga disa pikëpamje, duhen vlerësuar pikërisht në këtë kuadër.

Pastrimi nga hadethi jep kontribut në shumë pikëpamje ndaj pastrimit material. Për shembull, gusli dhe abdesti janë secili një pastrim material.

Ndërsa pastrim shpirtëror do të thotë të pastrohemi nga të këqijat morale dhe gjynahet.

Pastrimi material

Pastrimi material përfshin pastrimin nga papastërtitë e dukshme, të cilat bëhen pengesë për kryerjen e adhurimeve fetare, por përfshin edhe pastërtinë trupore e mjedisore, me qëllim

që njeriu të ketë një jetë të shëndetshme dhe të jetë i respektuar.

'Pastrimi nga nexhaseti', i cili nënkupton pastrimin e trupit, të veshjes dhe të vendit ku falim namaz, ndikon që njeriu të vetëdijesohet mbi pastërtinë personale, por edhe atë të mjedisit.

Le të shohim shkurtimisht pjesët më të rëndësishme të pastrimit material.

Pastërtia e trupit

Pastërtia e trupit është një pastërti e detyrueshme dhe e domosdoshme, të cilën njeriu e ka të nevojshme për gjatë gjithë jetës, me qëllim që të ketë një jetë të shëndetshme. Të lahemi rregullisht, të pastrojmë pjesët e trupit të cilat kanë nevojë për një pastrim specifik, të qethim mjekrën, të presim thonjtë, të gjitha këto janë ndër nevojat njerëzore, të cilat edhe feja jonë kërkon që ne t'i plotësojmë. Praktikën e pastrimit në formën e marrjes së guslit dhe abdestit, të cilat janë përcaktuar si kusht për disa adhurime, duke nisur kryesisht nga namazi, ndihmojnë që pastërtia trupore të jetë një zakon natyral dhe i rregullt i njeriut.



"O besimtarë! Kur doni të falni namaz, lani fytyrën dhe duart deri në bërryla, kurse kokën fshijeni me dorë të lagur; lani edhe këmbët deri në një. Nëse jeni të papastër (si pasojë e marrëdhënieve bashkëshortore apo e derdhjes së farës), pastrohuni (duke u larë krejtësisht)!" (*Maide*, 5/6).

Pastërtia personale është ndër kriteret kryesore që thekson më shumë Islami në kuadër të pastërtisë trupore. Ajo duhet të kryhet rregullisht bashkë me pastërtinë e gojës

dhe të dhëmbëve, me prerjen e thonjve, mirëmbajtjen e flokëve dhe të mjekrës, pastërtinë e disa pjesëve të caktuara të trupit dhe guslin (larja trupore e plotë). Ashtu si në çdo kriter, edhe këtu Hz. Pejgamberi është bërë shembull për ne. Ai ishte mjaft i pastër, i rregullt dhe i kujdesshëm. I priste thonjtë në kohë dhe e mirëmbante gjithmonë mjekrën e tij. Flokët i mbante të pastra dhe të krehura. Përpara njerëzve dilte i pastër, si në anën e jashtme, ashtu edhe në atë të brendshme. Ashtu siç mirëmbante flokët e tij, edhe nga shokët e tij kërkonte që të ishin të rregullt dhe të mirëmbanin veten (*Mu'uatta, Sha'r, 6; Shih Ebu Dau'ud, Taraxh-xhul, 3; Nesai, Zinet, 60*).

Në një hadith të tij urdhëron kështu: "Kushdo që ka flokë, t'i mirëmbajë ato" (*Ebu Davud, Terexh-xhul, 3*).

Hz. Pejgamberi i kushtonte më shumë rëndësi pastërtisë në ditët e veçanta, kur do të dilte në publik dhe do të ishte pjesë e shoqërisë, për shembull në ditët e xhumasë dhe të Bajramit. Në ditë të tilla lahej, vishte veshjet e bukura dhe parfumohej me aroma të mira (*Shih Ibnu'l-Kajjim, Dhadu'l-Mead, 1/364 etj.*).

Ai e tërheq vëmendjen sidomos në çështjen e pastërtisë së gojës dhe dhëmbëve, duke urdhëruar: "Po ta dija se nuk do ta mundoja ummetin tim, do të urdhëroja që të përdorin misvak" (*Buhari, Xhum'a, 8; Muslim, Taharet, 42-48*). "Misvaku është një mjet për pastrimin e gojës, por edhe një rrugë për fitimin e pëlqimit të Allahut" (*Nesai, Taharet, 5*).

Pastërtia që bëhet me qëllim të adhurimit, përputhet në masë të madhe me pastërtinë trupore dhe jep kontribute të mëdha në këtë pikë.

Nuk duhet të harrojmë se udha që të çon drejt pastërtisë së zemrës, gjë të cilën duam ta përfitojmë me anë të adhurimeve, kalon nga pastërtia trupore.



Të diskutojmë së bashku

Flisni në klasë mbi arsyet përse Pejgamberi ynë i kushton shumë rëndësi pastërtisë së gojës/dhëmbëve!

Pastërtia e rrobave

Pastërtia e rrobave është po aq e rëndësishme sa pastërtia e trupit. Kjo sepse sado i pastër të jetë trupi, në rast se nuk kemi veshjet e pastra, kjo pastërti nuk ka vlerë. Njëri prej urdhrave të Allahut të Lartmadhëruar ndaj Pejgamberit (s.a.s.) ka qenë në trajtën: "Pastroji rrobat e tua!" (*Mudeth-thir, 74/4*). Në Kur'anin Famëlartë urdhërohet kështu:



"O bijtë e Ademit, Ne ju dërguam rroba që të mbulonin vendet e turpshme, por edhe për zbukurim; megjithatë, petku i devotshmërisë është më i miri. Këto janë disa shenja të Allahut, që ju të merrni këshillë" (*A'raf, 7/26*).

Edhe pastërtia e rrobave është një domosdoshmëri e besimit dhe e mirësjelljes së njeriut, e jetesës në mënyrë të përbashkët me njerëzit e tjerë. Sepse njeriu gjendet gjithmonë në komunikim, fillimisht me anëtarët e familjes së tij, pastaj edhe me kolegët e punës dhe me shoqërinë brenda së cilës jeton. Ai nuk duhet të paraqitet në pozitat e dikujt që shqetëson njerëzit që ka përreth dhe të mos bëhet shkak që ata ta urrejnë atë. Nëse jemi të djersitur apo kemi veshur çorape që kundërmojnë, kjo bëhet shkak që të tjerët përreth nesh të ndihen të shqetësuar. Veshja mund të jetë e vjetër, por nuk duhet të jetë e papastër. Fjalët që thuhën në këtë pikë në trajtën: “Një veshje e rregullt është një referencë”, apo “Njerëzit priten me veshjet dhe përcillen me aftësitë dhe dijen e tyre” tregojnë rëndësinë që i jepet veshjes në shoqëri. Për këtë arsye Pejgamberi ynë ka theksuar një shembull konkret shumë të bukur me jetesën e tij. Qëndrimin e Rasulullahut në lidhje me veshjen dhe mirëmbajtjen mund ta përmbledhim në trajtën: “I pastër, i rregullt, elegant, i thjeshtë, respektues i veshjes dhe mirëmbahej aq sa mund t’ia përballonin mundësitë”.

Duke pasur parasysh këtë shembull konkret të Hz. Pejgamberit, edhe ne duhet të tregojmë kujdes ndaj pastërtisë së veshjes. Heqja e papastërtive që kërkohet kur realizohen adhurimet, është një kusht që kontribuon edhe në shndërrimin e çështjes së pastërtisë në një zakon.

Në Kur’anin Famëlartë gjenden urdhra dhe këshilla ndaj pastërtisë së veshjes. Kuptimi i dy prej ajeteve në këtë çështje është si më poshtë:



Le të komentojmë

“O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë.

Thuaj: “Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?” Thuaj: “Ato janë për besimtarë (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në botën tjetër do të jenë vetëm për besimtarët. Kështu ua shpjegojmë shpalljet njerëzve që dinë” (A’raf, 7/31-32).

Komentoni ajetet e mësipërme!

Pastërtia e vendit

Kur flasim për pastërtinë e vendit, së pari na vjen në mendje pastërtia e mjedisit ku jetojmë. Pa dyshim që në ajetet dhe hadithet që urdhërojnë dhe këshillojnë pastërtinë, përfshihet edhe mbajtja pastër e vendit ku jetojmë.

Urdhrat dhe këshillat e Hz. Pejgamberit në lidhje me pastërtinë e vendit ku jetojmë apo në lidhje me mosmbajtjen e gjërave që mund të ndotin shtëpinë a të përhapin aroma të këqija në shtëpi, bartin kritere të rëndësishme. Përveç kësaj, edhe urdhrat a këshillat që lidhen me mbajtjen pastër të mesxhideve aludojnë mbi ndjeshmërinë që duhet të tregohet në pastërtinë e vendit, sepse mesxhidet janë vendet e përbashkëta të besimtarëve.

Si përfundim mund të themi se mbajtja pastër e mjediseve publike, të tilla si vendbanimet apo ambientet e punës, janë domosdoshmëri e ndjeshmërisë islame.





“Ne i urdhëruam Ibrahimin dhe Ismailin: ‘Pastrojeni Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që e vizitojnë, që rrinë aty për adhurim dhe që falen duke u përku-
lur e përulur” (Bakara, 2/125).

“... Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që
pastrohen” (Bakara, 2/222).

Pastërtia e mjedisit



Kujdesi që duhet të tregoj-
më në mbajtjen pastër të tru-
pit, të veshjeve, ushqimeve
a vendbanimeve, duhet të
tregohet edhe në pastërtinë
e mjedisit. Kjo sepse shpër-
filljet që mund të bëhen në
çështjen e pastërtisë së mje-
disit cenojnë drejtpërdrejt
të drejtat e individëve, por
edhe të drejtën e gjallesave
të tjera. Kjo çështje është një
fushë, në të cilën gjenden
në mënyrë të ndërsjellë të
drejtat dhe detyrat e secilit
prej nesh. Për shembull, ata
që ndotin mjediset publi-
ke duke hedhur mbeturina,
ndotin jo vetëm mjedisin ku
jetojnë, por bëjnë padrejtë-
si edhe ndaj atyre që jetojnë
në vendet që kanë ndotur,
ose ndaj njerëzve dhe gjalle-
save që përfitojnë prej këtyre
vendeve. Për këtë arsye, duke
filluar që nga vendi ku banoj-

më, mbajtja pastër e hapësirave të tjera publike, siç janë rrugicat, rrugët, parqet etj., aq
sa është njerëzore, është edhe detyrë fetare. Si pjesëtarë të një feje që i kushton shumë
rëndësi pastërtisë, është e domosdoshme që muslimanët të tregohen më të ndjeshëm
në këtë çështje dhe të paraqesin sjellje shembullore.

Në hadithet e Hz. Pejgamberit gjenden mjaft urdhra dhe këshilla ndaj mbrojtjes së mje-
disit. Fakti që në hadithet fisnike qortohen rreptësisht ata që ndotin rrugët ku kalojnë
njerëzit apo vendet ku pushojnë njerëzit, siç është hija e pemës, tregon mbi përgjegjë-
sinë e madhe që kanë marrë përsipër personat që janë bërë shkak për ndotje të tilla
(Muslim, Taharet, 68).

Dy prej haditheve në këtë çështje janë si më poshtë:



“Besimi ndahet në më shumë se shtatëdhjetë pjesë. Pjesa më e lartë është fjala ‘la ilahe il-lallah’, më e ulëta është të heqësh nga rruga gjërat që shkaktojnë shqetësim. Edhe turpi është një pjesë e besimit” (*Buhari, Iman, 3*).

“M’u treguan mua të gjitha punët e ummetit tim, të mira dhe të këqija. Ndër veprat e mira pashë edhe se u hoqën nga rruga mbeturinat që shkaktonin shqetësim. Ndërsa ndër punët e këqija pashë se njerëzit pështynin para të gjithëve” (*Muslim, Mesaxhid, 57*).



Të diskutojmë së bashku

Gjeni ajetet dhe hadithet që flasin për pastërtinë e mjedisit dhe diskutoni mbi to!

Pastërtia shpirtërore

Pastërtia materiale nënkupton pastrimin nga papastërtitë që mund të shihen me sy dhe që mund të perceptohen fizikisht. Feja islame i kushton shumë rëndësi pastërtisë materiale, por rëndësinë më të madhe ia kushton pastërtisë shpirtërore. Feja urdhëron qëndrimin larg të këqijave që mund të cilësohen si ndotje shpirtërore, urdhëron me çdo mënyrë pastrimin prej këtyre papastërtive.

Në pikëpamje të krijimit njeriu është i pastër shpirtërisht. Kur fëmija vjen në botë nuk lind me asnjë lloj papastërtie shpirtërore. Ai vjen në botë krejt i pastër. Mirëpo në vijim ndotet me gjynahe dhe të këqija. Nga kjo pikëpamje, ndër synimet parësore të fesë sonë janë të mbajë larg njeriun nga ndotjet shpirtërore dhe të ruajë naivitetin, pastërtinë dhe thjeshtësinë që ka pasur në krijim. Ndaj atyre që janë zhytur në gjynahe dhe janë ndotur nuk është mbyllur porta e shpëtimit dhe e mëshirës, por janë parashtruar mundësi për shpëtimin nga ndotjet ku dikush mund të ketë rënë, po ashtu dhe për pastrimin shpirtëror.

Feja islame, me qëllim që personi të mund të pastrohet shpirtërisht, e ka lënë të hapur portën e ‘Pendimit’, e cila nënkupton braktisjen në formë të prerë të të këqijave dhe moskthimit më pas në botën e tyre të brendshme. Për këtë arsye nevojitet kthimi i të drejtave ndaj të zotëve të tyre, dhënia e fjalës në formë të prerë kundrejt moskthimit më tek e keqja, kërkimi i faljes nga Allahu i Lartmadhëruar për shkak të gjynaheve të kryera duke ndier pendesë.

Pastërtia shpirtërore vjen në kuptimin e zbukurimit me moral të bukur duke braktisur veçoritë e shëmtuara dhe të këqija. Ky pastrim, si term fetar, në përgjithësi emërohet në trajtën ‘tezkije’. Personat që realizojnë tezkijen, e thënë ndryshe pastrimin shpirtëror, përfitojnë edhe parime të moralit të bukur, të tilla si përsheptshmëria, sinqeriteti, drejtësia, vërtetësia dhe besueshmëria...





Le të diskutojmë

Ç'marrëdhënie gjendet ndërmjet pendimit dhe pastrimit shpirtëror?
Diskutoni!

Në vijim le të mësojmë disa kritere të pazëvendësueshme të pastërtisë shpirtërore:

Pastërtia e zemrës

Pastërtia e zemrës përbën thelbin e fesë. Ashtu siç bëhet e ditur me një përngjasim në një hadith fisnik, të këqijat dhe gjynahet e kryera errësojnë hapësirën shpirtërore të zemrës, duke u shndërruar në trajtën e njollave të errëta. Sa më shumë të kryhen të këqija dhe gjynahe, aq më shumë shtohet papastërtia në zemër, deri sa të mos mbetet asnjë hapësirë e pastër. Në këtë situatë, në hapësirën shpirtërore të zemrës zhduket gjallëria dhe dinamizmi, të cilat janë burim për pastërtinë shpirtërore të personit.

Burimi i cilësive të bukura, të tilla si sinqeriteti dhe drejtësia, vërtetësia dhe besueshmëria, po ashtu edhe të qenit të nijetit i pastër, vijnë nga pastërtia e zemrës. Si rrjedhojë, Pejgamberi ynë i dashur, duke aluduar zemrën dhe duke urdhëruar në trajtën 'Devotshmëria është këtu' (Muslim, Bir, 32), tërheq vëmendjen në faktin se pastërtia e zemrës është burimi i shmangies nga të këqijat dhe i pajisjes me virtyte morale.

32



"Allahu i Lartmadhëruar nuk sheh trupat dhe format tuaja, por sheh zemrat"
(Muslim, Bir, 33. *Përveç kësaj shihni edhe Ibni Maxhe, Zuhd, 9).*

Feja është sinqeritet, përzemërsi. Njëra prej veçorive, të cilën feja islame e ndalon rreptësisht, është dyfytërsia, si e kundërta e sinqeritetit dhe përzemërsisë. Për këtë shkak, përçarja, e cila bie ndesh me përzemërsinë, pranohet si njëra prej veçorive të këqija në fenë islame.

Muslimani është i njëjtë, si jashtë ashtu edhe brenda, si në thelb ashtu edhe në anën sipërfaqësore. Ai është gjithmonë i sinqertë në besimin, fjalën, qëndrimet dhe sjelljet e tij. Të qenët i pastër nijeti i një muslimani është ndër veçoritë që tregon përshpirtshmërinë dhe sinqeritetin.

H.z. Pejgamberi (s.a.s.) urdhëron: "Feja është sinqeritet." Kur e pyetën: "Ndaj kujt?", u përgjigj duke thënë: "Ndaj Allahut, Librit, të Dërguarit, prijësve të muslimanëve dhe të gjithë muslimanëve" (Muslim, Iman, 95 (Hadithi nr. 55).

Për këtë arsye, përshpirtshmëria është një kriter themelor vlerësimi pranë Allahut, e cila në bazë ka përzemërsinë, adhurimet dhe sjelljet e bukura.

Ndërsa sjellje kontradiktore të sinqeritetit, siç janë mashtrimi dhe dyfytërsia, konsiderohen si cilësi që nuk përputhen me moralin islam. E thënë me një shprehje më përmbledhëse, përshpirtshmëria dhe sinqeriteti formojnë thelbin e muslimanizmit. Si rrjedhojë, Pejgamberi ynë e thekson rëndësinë e nijetit dhe të sinqeritetit në vepra si në vijim: "Veprat e kryera vlerësohen sipas nijetit të shprehur. Çdokush merr shpërblymin e punës së bërë sipas nijetit të shprehur..." (Buhari, Bed'u'l-uahj, 1, Iman, 41; Muslim, Imaret, 155).



Le të diskutojmë

“Thuaju: ‘Edhe nëse e fshihni atë që keni në zemrat tuaja, edhe nëse e tregoni haptazi, Allahu e di atë. Ai di çfarë gjendet në qiej dhe çfarë gjendet në Tokë. Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë’” (*Al-u Imran, 3/29*).

“Allahu urdhëron kështu: ‘Adhurimi që më pëlqen më shumë te rob im është të qenët i sinqertë ndaj meje’” (*Ahmed b. Hanbel, V/254*).

Komentoni ajetin dhe hadithin e mësipërm në aspekt të të qenit i sinqertë.

Të qenët i besueshëm



“Ndaj atij që nuk respekton amanetin, besimi nuk ka dobi, po ashtu nuk ka dobi feja ndaj atij që nuk mban fjalën” (*Ahmed b. Hanbel, Musned, III, 135, 154, 210, 251*).

Termi ‘mumin’ ka kuptimin e ‘një personi që beson në ekzistencën dhe njëjësinë e Allahut të Lartmadhëruar’. Po ashtu, kuptimi i këtij termi është edhe: ‘Person që u fal besim të tjerëve dhe është i besueshëm’. Bazuar në këto dy përkufizime, besimtari është njeri që mban fjalën, i drejtë dhe i besueshëm dhe të cilit i besohet. Në Kur’anin Famëllartë shprehen shpesh veçoritë themelore të besimtarëve. Në ajetet e para të sures Mu’minun, kur radhiten veçoritë e besimtarëve që do të arrijnë në shpëtim, urdhërohet:



“... Këta janë ata besimtarë që u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marra” (*Mu’minun, 23/8; Përveç kësaj shihni edhe Mearixh, 22-35*).



Të studiojmë – Të mësojmë

Studioni arsyen përse Hz. Pejgamberit i është dhënë epiteti “Emin”!



Të diskutojmë së bashku

“Muslimani është personi, nga dora dhe gjuha e të cili nuk dëmtohet askush...” (*Tirmidhi, Iman, 12; Nesai, Iman, 8*).

Diskutoni mbi idenë kryesore të hadithit të mësipërm.

Veçoria më e rëndësishme për besueshmërinë është drejtësia. Për këtë arsye, gënjesht-
ra, si e kundërta e drejtësisë, është konsideruar ndër gjynahet e mëdha të Islamit. Duke
u nisur nga kjo besueshmëria (të jesh i besueshëm) është një veçori e pazëvendësueshme
për muslimanin. Kjo veçori është edhe si një demonstrim i nivelit të besimit. Sa më
shumë të pakësohet besueshmëria e personit, po aq vyshket edhe pjekuria e besimit.

Mbajtja e fjalës



“... Dhe përmbushni zotimet. Me të vërtetë, për zotimet do të jeni përgjegjës” (*Isra, 17/34*).

Kur’ani Famëlartë dhe Sunneti e konsiderojnë mbajtjen e fjalëve të dhëna si një ndër cilësitë më të rëndësishme.

Në librin tonë të lartë, Kur’anin, mosmbajtja e fjalës së dhënë është njëra prej sjelljeve të shëmtuara pranë Allahut, madje ndër më parësoret e tyre.

Mbajtja e fjalës së dhënë është një urdhër i Allahut. Kjo për shkak se fjala e muslimanit është si garanci.



“O besimtarë, përse e thoni atë që nuk e bëni? Është shumë e urryer për Allahun të thoni atë që nuk e bëni!” (*Saff, 61/2-3*).

34

Njeriu që beson nuk heq dorë nga fjala e dhënë. Ai e di se të shmanget nga mbajtja e fjalës është shenjë e dyfytërisë.



“Janë katër cilësi, të cilat kur gjenden te dikush, ai person është munafik (dyfytëresh) i pastër. Te kushdo që gjendet njëri prej tipareve të mëposhtme, tregon se tek ai ka një trajtë të dyfytërisë, për sa kohë nuk e braktis atë: tradhton amanetin që i besohet, gënjen kur flet, nuk mban fjalën e dhënë, e tejkalon cakun kur shpreh armiqësi” (*Buhari, Iman, 24, Mezalim, 17, Xhizje, 17; Muslim, Iman, 106*).

Kur’ani Famëlartë, mbajtjen e fjalës e konsideron si njërën prej veçorive të besimtarëve, të cilët do të fitojnë prehjen dhe lumturinë.

Nëse flasim në mënyrë të përmbledhur, t’i qëndrosh besnik fjalës së dhënë dhe marrëveshjeve të bëra, të jesh i drejtë në thelb dhe në fjalë, janë ndër veçoritë më të rëndësishme të muslimanit. Mes fjalës dhe veprës së muslimanit nuk duhet të ketë kontradiktë.



“... Këta janë ata besimtarë që u përmbahen amaneteve dhe detyrimeve të marra” (*Mu’minun, 23/8*).

4

Marrëdhënia pastërti-adhurim



Të adhurosh, në një kuptim do të thotë të ndodhesh në prani të Allahut. Ndërsa personi që do të ndodhet para Allahut duhet të jetë i pastër, si jashtë ashtu edhe brenda, gjë që nevojitet pastërtinë e personit në çdo aspekt.

Në kuptim të përgjithshëm, krahas pastërtisë, për disa adhurime, kryesisht për namazin, pastërtia me qëllim adhurimi pranohet si kusht paraprak i pastërtisë. Për të realizuar pjesën më të madhe të adhurimeve duhet të plotësojmë disa kushte të caktuara të pastërtisë. Nga kjo mund të arrijmë në përfundimin se feja islame i sheh pastërtinë materiale dhe atë shpirtërore si të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Adhurimet, të cilat plotësohen duke respektuar disa rregulla pastërtie, kanë si qëllim që të pastrojnë shpirtërisht personin.

5

Pastërtia si parapërgatitje e adhurimit



Duke filluar kryesisht nga namazi, para se të nisim një pjesë të adhurimeve duhet të kryejmë disa veprime që lidhen me pastërtinë. Siç u trajtua edhe më lart këto veprime kanë të bëjnë me pastrimin e papastërtive, që nënkupton pastrimin e personit, të trupit, të veshjeve, pastrimin e vendit ku do të falet namaz nga papastërtitë materiale, si dhe pastrimin nga papastërtitë konvencionale. Më sipër theksuam se pastërtia që buron nga gjendja hadeth realizohet me anë të abdestit dhe guslit.

Abdesti

Abdest do të thotë të lash fytyrën, duart bashkë me bërrylat, të bësh mes'h kokën, të lash këmbët bashkë me thembrat.

Për kryerjen e disa adhurimeve, të tilla si të falësh namaz dhe të bësh tavaf, marrja e abdestit është farz. Abesti, krahas mjaft dobive shpirtërore, ndikon pozitivisht edhe në aspekt të shëndetit të njeriut.

Një njeri mund të marrë abdest me qëllim fitimin e sevapit. Kështu, me këtë sjellje të tij mund të fitojë sevap. Abdesti kontribuon në paqen dhe qetësinë e brendshme të njeriut.



Virtytshmëria e abdestit

Megjithëse abdesti nuk është një adhurim më vete, por një mjet për adhurime të tjera, sevapi i tij është i shumtë.

Pejgamberi ynë përpiquej sa mundej që të gjendej me abdest. Prandaj edhe këshillohet që muslimanët të jenë me abdest me aq sa munden dhe të shtrihen duke qenë me abdest. Kjo situatë bën të mundur që muslimani të mos shkëputet nga atmosfera e adhurimit, të cilën e siguron jetesa adhurimore.

Pejgamberi ynë ka mjaft hadithe që tregojnë virtytshmërinë e abdestit:



“Nuri dhe ndriçimi i besimtarit arrijnë deri aty ku arrin edhe uji i abdesit” *(Muslim, Taharet, 50. Përveç kësaj shihni edhe Nesai, Taharet, 109).*

“Kushdo që merr abdest mirë e saktë, gjynahet e atij personi dalin nga i gjithë trupi, deri edhe gjynahet që gjenden poshtë thonjve të tij” *(Muslim, Taharet, 33. Përveç kësaj shihni për transmetime të ngjashme edhe Nesai, Taharet, 84; Ibni Maxhe, Taharet, 6).*

36

Farzet e abdestit

Abdesti ka katër farze:

1. Larja e fytyrës një herë me ujë;
2. Larja një herë e duarve me ujë bashkë me bërrylat;
3. Fërkimi (mes'h) i një të katërtës së kokës me një dorë të lagur dhe me ujë të pastër e të përdorur;
4. Larja një herë me ujë e këmbëve bashkë me thembrat.

Nëse nuk realizohet njëri prej këtyre farzeve, atëherë abdesti nuk është i plotë. Në mënyrë që abdesti të jetë i përsosur duhet të respektohen sunnetet dhe etika e tij.

Larja nga një herë e fytyrës, duarve dhe këmbëve me ujë është farz, ndërsa larja tri herë e tyre është sunnet.



Të studiojmë – Të mësojmë

Çfarë sunnetesh ka abdesti? Studioni nga veprat e ilmihalit!



Marrja e abdestit

Abdesti merret në këtë mënyrë:

Bëhet nijet për abdest dhe thuhet fjala Eudhu Bismil-lah. Lahen duart deri në bërryla tri herë, fërkohet mirë pjesa mes gishtave, nëse kemi unazë e lajmë edhe vendin ku vendoset unaza. Merret ujë tri herë me dorën e djathtë në gojë dhe shpëlahet mirë. Pastrohen dhëmbët me misvak ose me furçë. Përsëri me dorën e djathtë merret tri herë ujë në hundë dhe pastrohen hundët. Më pas lahet çdo anë e fytyrës. Më pas lahet fillimisht krahu i djathtë, pas tij i majti tri herë, deri në bërryla. Në vijim bëjmë mes'h (fërkojmë) kokën. Sakaq bëhet mes'h pjesa e brendshme e veshëve me gishtat tregues, ndërsa me gishtat e mëdhenj ana e jashtme, po ashtu me të pasmen e duarve bëhet koka. Më pas lahet këmba e djathtë tri herë dhe në vijim e majta. Kështu mundësohet që të lahet edhe pjesa e mesme e gishtave. Kjo është shkurtimisht mënyra e marrjes së abdestit.

Veprimet që prishin abdestin

Veprimet që prishin abdestin janë shkurtimisht si në vijim:

1. Jashtëqitjet e trasha dhe të holla që dalin nga ana e parme dhe e pasme; gjaku, qelbi, sperma etj...
2. Rrjedhja e gjakut, qelbit dhe lëngut të verdhë që del nga çdo pjesë e trupit.
3. Lëshimi i gazrave.

4. Të fjeturit duke qëndruar shtrirë ose duke u mbështetur.

5. Të qeshurit në namaz nga dikush që është përgjegjës fetarisht, aq sa zëri i tij të dëgjohej te personi që i gjendet pranë.



Të studiojmë – Të mësojmë

Konstatoni veprimet e tjera që prishin abdestin nga veprat e ilmihalit dhe ndajini ata me nxënësit e tjerë të klasës!

Gusli

Larja e të gjithë trupit nga këmbët deri te koka, duke përfshirë edhe gojën e hundën, quhet gusul (larje trupore).

Në Kur'an, duke u urdhëruar në trajtën: "Nëse jeni të papastër (si pasojë e marrëdhënieve bashkëshortore apo e derdhjes së farës), pastrohuni (duke u larë krejtësisht)!" (*Maide*, 5/6), bëhet e ditur se duhet të marrim gusul në mënyrë që të mos jemi më të papastër (xhunub).

Virtytshmëria e guslit

Megjithëse gusli është një pastërti konvencionale, të cilën feja kërkon që të plotësohet, në aspektin material është një pastërti trupore. Specialistët bëjnë të ditur se gusli ka dobi në aspekt të shëndetit të njeriut. Krahas eliminimit të papastërtive materiale që gjenden në trup, bëhet e ditur se gusli i fal vitalitet njeriut, lehtëson lodhjen e tij, shton forcë në qarkullimin e gjakut.

Përveç sa më sipër, dobisë e tij janë edhe në aspektin shpirtëror e psikologjik. Ata që lahen me qëllim adhurimi e ndiejnë veten më të qetë shpirtërisht.

Pejgamberi ynë i ka nxitur muslimanët për marrjen e guslit. Disa nga hadithet që lidhen me marrjen e guslit gjatë ditëve të premtë nga muslimanët janë si në vijim:



"Kur dikush prej jush do të shkojë në namazin e xhumasë le të marrë abdest trupor" (*Buhari, Xhum'a, 2, 5, 12; Tirmidhi, Xhum'a, 3; Nesai, Xhum'a, 7, 25; Ibn Maxhe, Ikamet, 80*).

"Kushdo që merr abdest ditën e premtë bën një veprim të drejtë; për më tepër, nëse merr abdest trupor, kjo është edhe më mirë" (*Ebu Dau'ud, Xhum'a, 5. Përveç kësaj shihni edhe Nesai, Xhum'a, 9*).

Situatat e domosdoshme për marrjen e guslit

Situatat që e kanë të domosdoshme marrjen e guslit janë heqja e papastërtive, qofshin ato për shkaqe seksuale, për shkak të menstruacioneve apo të lehonisë. Personat që janë xhunub duhet të marrin gusul kur falin namaz, kur bëjnë tavaf, kur bëjnë sexhden e tilavetit (këndimit), kur prekin Kur'anin ose kur lexojnë Kur'an. Edhe femrat marrin gusul kur kanë përfunduar situatat e tyre të menstruacioneve dhe të lehonisë.

Farzet e guslit


Farzet e guslit janë tre:

1. Larja e gojës.
2. Larja e hundës nga brenda.
3. Larja e gjithë trupit nga koka te këmbët.

Kryerja e guslit

Personi që do të bëjë gusul, së pari thotë fjalën bismil-lah, më pas bën nijet për gusul. Në rast se ka ndonjë papastërti, e eliminon atë nga çdo pjesë e trupit. Më pas lan vendet e turpshme. Në vijim merr abdest duke respektuar të gjitha kriteret e nevojshme (nëse mblidhet ujë në vendin ku merret gusli, lan këmbët në kohën kur e ka përfunduar guslin dhe do të dalë). Pasi të marrë abdest, nëse do ta përdorë ujin duke e marrë me një tas, së pari e hedh në kokë, më pas në supin e djathtë dhe më pas në të majtë nga tri herë dhe e lan mirë trupin duke e fërkuar. Nëse lahet në dush hyn nën dush dhe lan çdo pjesë të trupit. Në mënyrë që të mos mbetet vend i palarë, bën kujdes në larjen e kërthizës dhe të vrimave të vathëve.

Tejemmumi



Tejemmumi nënkupton veprimin e prekes me duar të diçkaje si dheu i pastër apo të diçkaje tjetër nga lloji i dheut, fërkimin e fytyrës dhe të krahëve me qëllim që të zërë vendin e abdestit ose guslit në situatat kur nuk gjendet ujë, apo kur nuk ka mundësi ta përdorë ujin. Me këtë veprim eliminohet edhe mungesa e abdestit.

Tejemmumi është një formë adhurimi simbolike e posaçme për muslimanët. Ai është një lehtësi feta-

re. Muslimani është i mësuar që të kryejë adhurim duke qenë i pastër. Kur nuk gjen ujë dhe ndien se është i pistë konvencionalisht, nuk mund të dalë në praninë e Allahut të

Lartmadhëruar. Tejemmumi bën të mundur që personi të mos kryejë adhurim duke qenë i privuar nga kjo gjendje e pastërtisë. Kështu tejemmumi përballon nevojën shpirtërore që ndien muslimani mbi këtë çështje. Duke e kthyer njeriun në dheun, i cili është thelbi i krijimit, gjallëron tek ai ndjenjat e modestisë dhe respektit ndaj Krijuesit.

Farzet e tejemmumit

Tejemmumi ka dy farze:

1. Shprehja e nijetit.
2. Përplasja e dy duarve mbi dhé të pastër, fërkimi i fytyrës me njërin prej tyre, ndërsa me tjetrën i krahëve.

Po ashtu, gjatë marrjes së tejemmumit duhet të bëhet fërkimi i krejt fytyrës dhe i krahëve, si dhe eliminimi i ndonjë mbetjeje në gjymtyrë, që është pengesë për mes'hin.

Kushtet e tejemmumit

Tejemmumi është një veprim i vlefshëm dhe i posaçëm që zë vendin e abdestit dhe guslit. Për t'u orientuar drejt këtij veprimi të vlefshëm nevojiten disa kushte.



Të diskutojmë së bashku

Konstatoni kushtet e tejemmumit nga veprat e ilmihalit dhe flisni mbi ta në klasë!

40

Kryerja e tejemmumit

Tejemmumi bëhet si në vijim: një person që është pa abdest ose që duhet të marrë gusul, i përplas dy herë duart mbi dhé të pastër ose në diçka të përgatitur nga dheu dhe me ta bën mes'h fytyrën. Më pas i përplas sërish duart për herë të dytë dhe me këtë bën mes'h dy krahët deri në bërryla. Ky veprim bëhet me qëllim eliminimin e situatës që krijon mungesën e abdestit, ose me qëllim faljen e namazit a kryerjen e një adhurimi, i cili nuk është i vlefshëm pa pasur abdest.

Thënia e fjalës bismil-lah kur nisim tejemmumin, përplasja e duarve në dhé me gishtat e hapur dhe lëvizja e tyre sa para-prapa, përplasja e tyre lehtësisht me njëra-tjetrën (pasi të jenë ngritur duart, nëse janë pluhurosur së tepërmi) me qëllim që të bjerë pluhuri i tyre, bërja mes'h e fytyrës, më pas e krahëve dhe kur të kryhen këto veprime të mos lihet hapësirë kohë ndërmjet, të gjitha këto janë ndër sunnetet e tejemmumit.

Ndërkohë që në tejemmum bëhen mes'h krahët bashkë me bërrylat, veçohet gishti i madh i dorës së majtë dhe duke nisur nga ana e brendshme e gishtave të tjerë dhe majat e gishtave të dorës së djathtë, bëhet mes'h deri në bërryla ana e jashtme e krahut. Më pas duke u kthyer në anën e brendshme të dorës së djathtë, pasi bëhet hallkë me gishtin e madh të dorës së majtë dhe me gishtin e vogël, bashkë me gishtin e madh bëhet mes'h ana e brendshme e dorës deri në bërryl. Pasi shtyhet gishti i madh më tutje, bëhet mes'h edhe pjesa e sipërme e gishtit të madh. Me të njëjtën metodë bëhet mes'h edhe dora e djathtë me dorën e majtë.



Mes'h do të thotë të vësh dorën mbi vendin ku do të bëhet mes'h. Mes'hi (fërkimi) është një pastrim konvencional. Edhe tejemmumi kryhet pasi të bëhet mes'h fytyra dhe krahët me dorën që është fërkuar në dhé të pastër.

Krahas këtyre mes'hi në abdest dhe në gusul është paraqitur edhe si një lehtësi dhe plotësohet si pastrim konvencional. Ndër këto lehtësi mund të përmendim mes'hin e kryer mbi mestet që vishen në këmbë dhe mes'hin e kryer mbi fashën.

Mes'hi mbi meste

Mestet janë një lloj këpucësh të prodhuara me materiale si lëkura dhe lëndë të ngjashme me të, të cilat nuk depërtojnë ujë, që i mbulojnë këmbët bashkë me thembrat dhe që mund të rrinë në këmbë edhe pa lidhëse. Ndërsa çizmet dhe kambalet, të cilat mbulojnë këmbët bashkë me thembrat, janë në pozitën e mestit, por me kusht që të mos kenë papastërti, të cilat bëhen pengesë për namazin. Mund të bëhet mes'h edhe gjatë marrjes së abdestit, me kusht që këpucët të jenë veshur ndërsa personi ka qenë me abdest. Kjo është një lehtësi që tregon feja islame.

Veprimet që prishin abdestin, prishin edhe mes'hin. Përveç kësaj, vlefshmëria e mes'hit përfundon edhe në rast se mestet dalin nga këmba, hiqen ose përfundon kohëzgjatja e vlefshme e mes'hit.

Le të lexojmë

Lexoni nga librat e ilmihalit mbi hollësi të mëtejshme të mes'hit të bërë mbi meste!

Mes'h mbi fashë dhe plagë

Gjatë marrjes së abdestit ose të guslit, kur është fjala për të larë me ujë një pjesë të trupit, e cila është vendosur në allçi ose është lidhur me fashë për ndonjë arsye, siç mund të jetë plagosja, në të tilla raste fasha nuk duhet të hiqet, por duhet të bëjmë mes'h mbi të. Nëse edhe kryerja e mes'hit është e dëmshme, ky veprim nuk duhet të bëhet. Kryerja e mes'hit një herë mbi allçinë sipër fakturës ose mbi plagë, si për abdest ashtu edhe për gusul, kalon në vend të larjes një herë të asaj gjymtyre konvencionalisht.

Kur bëhet mes'h mbi fashë nuk është e nevojshme që mes'hi i bërë të prekë të gjithë fashën, por mjafton që të bëhet mes'h pjesa më e madhe e kësaj gjymtyre.



Të studiojmë – Të mësojmë

Studioni dispozitat legjislative që lidhen me mes'hin mbi fashë!



Disa rrethana të posaçme për femrat



Femrat kanë disa rrethana, të cilat janë të posaçme vetëm për ta. Në aspekt të dispozitave të tyre fetare, këto rrethana duhet të dihen, ashtu siç duhet të dihen edhe dispozitat fetare që lidhen me to.

Nga mitra e grave të rritura kalojnë tre lloje gjaku. Gjaku që vjen në periudha të caktuara nga gratë mes moshave të caktuara quhet gjak menstruacionesh. Gjaku që vjen për një farë kohe pas lindjes është gjaku i lehonisë. Lloji që mbetet jashtë këtyre dhe që në përgjithësi vjen si rrjedhojë e një sëmundjeje quhet gjak anomalie. Është e nevojshme që femra t'i dijë këto informacione në aspekt të jetës adhurimore dhe të jetës seksuale me bashkëshortët e tyre, si dhe dispozitat fetare që lidhen me to.



Menstruacionet (Hajdi)

Sekrecionet që vijnë në kohë të caktuara nga mitra e femrës, e cila është në moshë të pjekur, nuk është shtatzënë dhe nuk ka shkaqe të tjera si sëmundja apo lindja e një fëmije, quhen menstruacione. Të dhënat e sotme mjekësore bëjnë të ditur se gjaku i ciklit menstrual nis rreth moshës 11-13-vjeçare dhe përfundon rreth moshës 45-50-vjeçare; kohëzgjatja e menstruacioneve është rreth 3-6 ditë (*Ilmihal, ISAM, I/212*). Hajdi shprehet edhe me terma si menstruacionet, regl dhe të përmuajshmet.

Kohëzgjatja e tyre, sipas medh'hebit hanetit, është më e pakta tri ditë dhe më e shumta dhjetë ditë. Nuk është kusht që brenda kësaj kohe gjakrrjedhja të jetë e vazhdueshme. Herë pas here mund të ndërpritet dhe të nisë sërish. Koha pa gjakrrjedhje që kalon mes dy periudhave të menstruacioneve quhet "periudha e pastërtisë". Kohëzgjatja e pastërtisë është më së paku pesëmbëdhjetë ditë. Periudha e menstruacioneve, për sa kohë nuk ndërpritet plotësisht e gjithë gjakrrjedhja, e cila vjen brenda kohës së menstruacioneve, në cilëndo ngjyrë qoftë, nuk konsiderohet se ka përfunduar. Kur gjakrrjedhjet që vijnë nga gruaja të jenë plotësisht të bardha kuptohet se menstruacionet kanë përfunduar.

Feja islame, duke rregulluar qasjet e gabuara që e përjashtonin gruan me menstruacione nga jeta e përditshme, ka kërkuar nga gratë që në një proces natyral të menstruacio-

neve, përveç marrëdhënieve seksuale me bashkëshortët e tyre, të vijojnë marrëdhëniet normale. Privimi i gruas nga namazi në këtë periudhë është një lejueshmëri fetare ndaj saj.

Lehonia (Nifas)

Gjaku që vjen nga mitra e gruas pas lindjes quhet nifas. Nuk ka një kufi minimal kohor për këtë. Mund të jetë një ose dy ditë, madje më e shkurtër se kjo. Ndërsa periudha më e gjatë është dyzet ditë. Pastërtia ndërmjet periudhës së lehonisë prej dyzet ditëve konsiderohet nifas. Për shembull, nëse do të ketë gjakrrjedhje për dhjetë ditë, më pas do të ndërpritet për pesë ditë dhe më pas do të ketë gjakrrjedhje edhe për dhjetë ditë të tjera, kjo periudhë njëzetepesëditore konsiderohet e gjitha si kohëzgjatje lehonie.

Gjendja e lehonisë krijohet edhe si rezultat i përfundimit të shtatzënisë së fëmijës, duart dhe këmbët e të cilit janë formësuar. Nga ana tjetër, nëse ndërpritet një shtatzëni kur fëmijës nuk mund t'i dallohen ende organet, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me gjendje lehonie. Pas ndërprerjes së kësaj shtatzënie gjakrrjedhja vazhdon për më e pakta tri ditë dhe, nëse para kësaj ka kaluar një periudhë kohore pastrimi prej pesëmbëdhjetë ditësh, kjo gjakrrjedhje konsiderohet si gjak menstruacionesh. Nëse nuk është kështu, atëherë është gjak që buron nga një anomali.

Disa dispozita në lidhje me hajdin dhe nifasin

Gruaja me menstruacione ose lehoni, gjatë periudhave në fjalë është privuar nga nama-zi. Ajo nuk mund të falë namaz, nuk mund të mbajë agjërim, nuk mund të bëjë tavaf Qabenë, nuk mund të bëjë sexhden e tilavetit, si dhe nuk mund të kryejë marrëdhënie seksuale me bashkëshortin e saj. Të gjitha këto janë haram. Ndërsa agjërimet e Ramazanit që rastisin në këtë kohë i mban më vonë. Sa i përket marrjes së guslit nga një grua, periudha e menstruacioneve dhe e lehonisë të së cilës ka përfunduar, kjo është farz.

Kur tejkalohet kufiri maksimal i përcaktuar për hajdin dhe nifasin, kryerja e marrëdhënieve seksuale nga gruaja me bashkëshortin e saj është e lejuar. Mirëpo nëse ndërpritet gjakrrjedhja para se të arrihet në kufirin maksimal, kryerja e marrëdhënieve seksuale nuk është e lejuar menjëherë. Në këtë situatë gruaja ose duhet të jetë larë, ose duhet të ketë kaluar mbi kohën e ndërprerjes së gjakrrjedhjeve një kohë namazi.

Një grua që është me menstruacione ose lehonë, mund të përmendë Allahun dhe të bëjë tesbihe, po ashtu ajetet në trajtë duaie mund t'i këndojë me nijetin e duasë. Disa dijetarë të Islamit kanë thënë se gratë me menstruacione ose lehona mund edhe të këndojnë Kur'an.



Pastërtia e personave me rrethana të justifikueshme



Abdesti konsiderohet i prishur nëse individi ka shqetësime të vazhdueshme, të cilat emërtohen si 'anomali'. E tillë mund të jetë gjakrrjedhja e vazhdueshme nga hundët, mosmbajtja e urinës, rrjedhja e vazhdueshme e sekrecioneve nga plaga, gjakrrjedhja si pasojë e një çrregullimi të enëve të gjakut etj.. Nëse një justifikim i tillë vazhdon për një kohë të caktuar, aq sa të mos krijojë mundësi që personi të marrë abdest dhe të falë namaz, ky individ gjatë jetës së tij adhuremore konsiderohet i justifikuar, pra me anomali. Nëse anomalia, e cila në fillim vazhdon për aq kohë sa të mos japë mundësi sa personi të marrë abdest e të falë namaz



gjatë kohëzgjatjes së një namazi, ndërsa më pas shfaqet të paktën një herë të vetme për secilën prej kohëve të namazit, konsiderohet se situata e justifikuar vijon.



Le të kujtojmë

Islami është feja e lehtësisë. Ai nuk ngarkon mbi njerëzit gjëra, të cilat e tejkalojnë forcën e tyre. Po ashtu, edhe ndaj personave me justifikim ka disa lehtësi. Shembull i kësaj janë disa prej lehtësive që u njihen personave me anomali, me qëllim që të mund të falin namazet pa ndër vështirësi.

Personi i justifikuar merr abdest për çdo kohë namazi. Justifikimi që vazhdon nuk e prish abdestin e tij. Me abdestin që ka marrë brenda asaj kohe, për sa kohë nuk ndodh diçka tjetër që e prish, mund të falë namaz farz, vaxhib ose nafile aq sa të dëshirojë. Krahas përfundimit të kohës së namazit prishet abdesti i personit me anomali. Abdesti i personit me anomali prishet edhe pasi të ketë ndodhur diçka që prish abdestin, përveç situatës së justifikuar.

Nëse gjendja e justifikuar nuk shkaktohet gjatë një kohe namazi të tërë, justifikimi eliminohet dhe ai person del së qeni person i justifikuar..



Të diskutojmë së bashku

Jepni shembuj nga situatat e justifikuara dhe flisni mbi ta!

44



Përmbledhja e kapitullit



Feja islame i jep shumë rëndësi pastërtisë, gjë që e tregon më së miri edhe hadithi në trajtën: “Pastërtia është gjysma e besimit.”

Të qenët e muslimanit i pastër në çdo drejtim është detyrë fetare. Po ashtu, është e domosdoshme që trupi i personit, veshjet, ushqimet që ha dhe pi, vendet ku banon dhe vendet ku adhuron, të jenë të pastra.

Pastërtia ndahet në tri kategori: në pastërtinë materiale, pastërtinë shpirtërore dhe në pastërtinë konvencionale, ku bën pjesë edhe pastërtia materiale, edhe ajo shpirtërore.

Pastrimi nga papastërtitë materiale nënkupton pastrimin nga papastërtitë e trupit, të veshjeve dhe të vendit ku do të falim namaz. Ky quhet pastrim nga ‘papastërtitë materiale’.

Pastrim shpirtëror do të thotë të pastrohesh nga të këqijat morale dhe gjynahet. Pastërtia shpirtërore në thelb do të thotë të braktisë cilësitë e këqija dhe të pajisesh me moral të bukur. Personat që arrijnë të realizojnë pastrimin shpirtëror përfitojnë edhe parime të bukura morale, të tilla si përsëritshmëria, sinqeriteti, drejtësia, vërtetësia dhe besueshmëria.

Pastrimi konvencional nënkupton pastrimin nga papastërtitë shpirtërore të quajtura hadeth. Hadeth quhet gjendja e mungesës së abdestit, situata e të qenit xhunub, gjendja e menstruacioneve dhe lehonja të gratë. Pastrimi prej tyre bëhet i mundur me marrjen e abdestit në kohën kur mungon abdesti dhe marrjen e guslit në situatat e tjera. Kjo quhet 'pastrim nga hadethi'.

Pastërtia nga hadethi, në shumë pikëpamje jep kontribute të rëndësishme në pastrimin material. Për shembull, gusli dhe abdesti janë njëkohësisht një pastërti materiale.

Abdest do të thotë të lash fytyrën, duart bashkë me bërrylat, të bësh mes'h kokën, të lash këmbët bashkë me thembrat.

Për të kryer disa adhurime, të tilla si falja e namazit dhe kryerja e tavafit, marrja e abdestit është farz.

Ndërsa gusul quhet larja e trupit nga këmbët deri te koka, duke përfshirë edhe pjesën e brendshme të gojës dhe të hundës.

Situatat që e kanë të domosdoshme guslin janë koha kur përfundon periudha e menstruacioneve dhe e lehonisë te femrat.

Në situatat kur nuk gjendet ujë, ose kur nuk ekziston mundësia e përdorimit të tij, në mënyrë që të zëvendësohet abdesti ose gusli, përplasen duart në dhë të pastër ose në diçka të ngjashme me dheun, bëhet nijet dhe fërkohen duart e më pas bëhet mes'h mbi fytyrë e krahë. Ky është një pastrim simbolik.

Gratë kanë disa situata të posaçme, siç janë menstruacionet, lehonja dhe anomalia.

Gjakrrjedhja në kohë të caktuara që vjen nga mitra e një femre, e cila është në moshë të pjekur, që nuk është shtatzënë dhe nuk ka shkaqe të tjera si sëmundja apo lindja e një fëmije, quhet hajd.

Gjaku që vjen nga femra pas lindjes quhet nifas. Për periudhën minimale të kësaj nuk ka një kufi. Mund të jetë një ose dy ditë, madje mund të përkojë me një kohë edhe më të shkurtër. Ndërsa periudha më e gjatë është dyzet ditë.

Gruaja me menstruacione ose lehonë, brenda kësaj kohe nuk bën adhurime, të tilla si falja e namazit, mbajtja e agjërimet, kryerja e tavafit të Qabesë, kryerja e sexhdes së tilavetit. Po ashtu, nuk kryen marrëdhënie seksuale me bashkëshortin. Brenda kësaj kohe gruaja është e privuar nga namazi, kurse agjërimet e Ramazanit, të cilat rastisin në këtë kohë, i mban më vonë. Po ashtu, është farz marrja e abdestit trupor nga gruaja, menstruacionet dhe lehonja e së cilës kanë përfunduar.

Gjaku që vjen nga mitra e gruas, përveç gjakrrjedhjeve të menstruacioneve dhe lehonisë, quhet gjak për shkak të ndonjë anomalie. Ky gjak prish vetëm abdestin.



Të rishikojmë kapitullin



1. Cila është rëndësia e pastërtisë në pikëpamje të individit dhe të shoqërisë?
2. Në sa pjesë mund ta ndajmë pastërtinë?
3. Cili është dallimi ndërmjet pastërtisë shpirtërore dhe asaj konvencionale?
4. Ç'lidhje ka mes pastërtisë së mjedisit, të drejtave të njeriut dhe gjallesave të tjera?
5. Ç'kontribut japin adhurimet ndaj pastërtisë materiale dhe shpirtërore?
6. Ç'kuptoni nga përkufizimi që Pejgamberi ynë i ka bërë fesë duke e cilësuar si 'e sinqertë'?
7. Cilat janë lehtësitë që njeh feja jonë në çështjen e abdestit dhe të guslit?
8. Si vepron gjatë abdestit personi që ka fashë mbi plagë në çdonjërin prej gjymtyrëve të abdestit?
9. Si falin namaz personat që kanë një shqetësim të tillë si mosmbajtja e urinës?



Pyetje vlerësuese



1. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk përfshihet te pastërtitë materiale?

- A) Pastërtia trupore
- B) Pastërtia e veshjes
- C) Pastërtia e zemrës
- D) Pastërtia e vendit

2. Cili nga termat e mëposhtëm nuk lidhet me pastërtinë konvencionale, e cila përfshin pastërtinë materiale dhe atë shpirtërore?

- A) Gusli
- B) Abdesti
- C) Tejemmumi
- D) Pastërtia e veshjes

3. Cila nga alternativat e mëposhtme është e drejtë?

- A) Femrat me menstruacione i shtyjnë për më vonë namazet që kalojnë gjatë ditëve me menstruacione.
- B) Nuk i braktisin namazet, i falin ashtu siç janë.
- C) Në ditët me menstruacione janë të privuara nga namazi
- D) Janë të privuara nga agjërimi i Ramazanit që rastis me ditët e menstruacioneve.

4. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk përfshihet te farzet e guslit?

- A) Nijeti
- B) Larja e gojës
- C) Larja e hundës
- D) Larja e gjithë trupit

5. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk bën pjesë te pastërtia shpirtërore?

- A) Pastërtia e zemrës
- B) Mbajtja e fjalës
- C) Besueshmëria
- D) Pastërtia e mjedisit

ආරාධනා මාලාව

KAPITULLI

3





Namazi

1. Namazi dhe rëndësia e tij
2. Llojet e namazit
3. Kohët e namazit
4. Farzet e namazit
5. Vaxhibet e namazit
6. Situatat që prishin namazin
7. Dispozita të tjera në lidhje me namazin
8. Falja e namazit
9. Sexhdeja e sehvit dhe e tilavetit
10. Namazi në situata të posaçme
11. Bashkimi i namazeve
12. Xhamia dhe namazi me xhemaat
13. Roli shoqëror i xhamive
14. Etika e xhamisë
15. Namazi me xhemaat
16. Çfarë përfiton njeriu nga adhurimi i namazit?

RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull trajtohet çështja e namazit, si një ndër adhurimet më të rëndësishme të fesë islame. Çështjet që preken janë si më poshtë:

- Vendi dhe rëndësia e namazit në fenë islame;
- Të dhëna në lidhje me namazin, të tilla si të qenët e tij farz, kohët, llojet, mënyra e faljes, farzet, vaxhibet, sunnetet dhe veprimet që prishin namazin;
- Namazi me xhemaat dhe funksioni shoqëror i xhamive;
- Çfarë përfiton njeriu nga namazi.

SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Pasi të keni lexuar këtë kapitull:

1. Do të perceptoni rëndësinë e namazit, si një ndër adhurimet e përditshme të muslimanit.
2. Do të mësoni kohët e namazeve, mënyrën se si falet namazi dhe se si do të falin namaz të sëmuret e udhëtarët.
3. Do të kuptoni dallimin ndërmjet namazeve të Bajramit dhe namazeve të xhenazes në krahasim me namazet e tjera.
4. Do të mësoni ç'janë sexhdet, të tilla si sexhdeja e sehvit dhe ajo e tilavetit dhe se si kryhen ato.
5. Do të mësoni të dhëna në lidhje me rëndësinë e namazit me xhemaat dhe rolin shoqëror të xhamive.
6. Do të mësoni të dhëna në lidhje me përfitimet e individit nga namazi.

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

1. Konsultoni veprat e ilmihalit për të parë më gjerësisht të dhënat që lidhen me namazin.
2. Mendoni funksionin thelbësor të namazit në fenë islame.
3. Mendoni përse falni namaz.
4. Studioni dhe mësoni se si falte namaz Pejgamberi ynë.
5. Përse Pejgamberi ynë ka urdhëruar: "Çasti kur unë jam më i lumtur është çasti kur jam në namaz". Mendoni mbi këtë.
6. Si perceptohet namazi në rrethin tuaj? Si një moment qetësie, për të cilin ndihet mallëngjim, apo si një moment i mundimshëm? Mendoni mbi këtë.
7. Përse namazi renditet ndër të parët tek urdhëresat e Kur'anit? Vlerësoni.
8. Ç'mendoni në lidhje me kryerjen e të këqijave nga ata që falin namaz, edhe pse në Kur'an thuhet që namazi me siguri të largon nga çdo lloj e keqeje? Vlerësoni.

1

Namazi dhe rëndësia e tij



Namazi, i cili mundëson në mënyrë të vazhdueshme lidhjen e njeriut me Zotin, është njëri ndër kushtet e Islamit. Për çdo musliman që ka arritur moshën e pjekurisë, falja e namazit në pesë kohë të ditës është farz. Në Kur'anin Famëlartë dhe në hadithe ka mjaft urdhëresa dhe këshilla në lidhje me namazin. Në njërin prej këtyre ajeteve urdhërohet si në vijim:



“Lexo (o Muhammed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kur'anit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar; vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni” (*Ankebut, 29/45*).

Ndërsa kuptimi i një ajeti tjetër është si më poshtë:



“Faleni namazin dhe jepeni zeqatin! Çfarëdo të mire që të bëni për shpirtin tuaj, do ta gjeni tek Allahu. Në të vërtetë, Ai sheh mirë gjithçka që bëni” (*Bakara, 2/110*).

Në hadithe theksohet edhe se namazi mund të ndrisë zemrën e personit, se ai që dëshiron të shtojë ndriçimin në zemrën e tij, mund ta arrijë këtë me namaz.

Rasulullahu (s.a.s.) urdhëron kështu:



“Islami është themeluar mbi pesë themele: të dëshmosh se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Allahut; të falësh namazin ashtu siç dihet; të japësh zekatin; të bësh haxh Qabenë, shtëpinë e Allahut dhe të mbash agjërimin e Ramazanit” (*Buhari, Iman, 1, 2, Tefsiru sure (2) 30; Muslim, Iman, 18-22. Përveç kësaj shihni edhe Tirmidhi, Iman, 3; Nesai, Iman, 13*).

Forca e pafund e Allahut, rregulli i mahnitshëm që ka vendosur në univers, mirësitë e panumërta që i mundëson njeriut, të gjitha këto i shtyjnë njerëzit e ditur drejt lavdërimit të thellë, respektit, dashurisë dhe falënderimit ndaj Tij. Namazi është shprehja e vazhdueshme dhe e rregullt e këtij respekti dhe dashurie. Njeriu ka nevojë për këtë, sepse njeriu, ndryshe nga gjallesat e tjera, zotëron gjykimin, ka ndjenja, mendime dhe shpirt. Ashtu si trupi ka nevoja, edhe shpirti ka nevojat e tij. Namazi është ushqimi i përditshëm i shpirtit të njeriut që beson tek Allahu. Qëndrimi larg namazit do të thotë të dënosh shpirtin me uri. Ai që jeton me ndërgjegjen se çdo çast arrin në mirësi të pafund të Allahut dhe që ndien në çdo moment mëshirën e Tij, dëshiron ta mbajë gjallë lidhjen me burimin e asaj mirësie, dhuntie dhe mëshire. Namazi jep kontribut të madh në forcimin e lidhjes mes robit dhe Zotit.





Namazet ndahen në katër grupe, duke pasur parasysh dispozitat e tilla si farzi, vaxhibi, sunneti dhe mustehabi. Më poshtë do të prekim shkurtimisht secilin prej tyre.

Namazet farz

Namazet farz ndahen në dy kategori: në farz ajn dhe farz kifaje. Te namazet farz ajn përfshihen namazet që janë farz për çdo musliman, i cili ka arritur moshën e pjekurisë dhe që është me mendje të shëndoshë (përgjegjës fetarisht). Këta janë pesë kohë namaz dhe namazi i xhumasë për meshkujt. Ndërsa namazi i xhenazes është farz kifaje. Në rast se disa nga muslimanët e plotësojnë këtë farz, muslimanët e tjerë që janë në pozitë ta plotësojnë atë, shpëtojnë nga përgjegjësia.

Namazet vaxhib

Namazet vaxhib, ashtu si namazet farz, megjithëse janë namaze për të cilat është përgjegjës çdo musliman i ngarkuar fetarisht, në aspekt të forcës nuk janë në nivelin e namazit farz. Këta janë namazi i vitrit, namazi i Bajramit, namazi i tavafit, kazaja e namazeve nafile të prishur dhe namazet e zotuara.

Namazet nafile

Namazet jashtë namazeve farz dhe vaxhib mund të emërtohen me një nocion apo term të përgjithshëm si 'namaze nafile'. Në këtë kategori përfshihen namazet sunnet dhe mustehab, si dhe namazet e tjera që falen me qëllim fitimin e namazit. Sunnetet që falen para ose në fund të namazit të pesë kohëve, namazi i teravisë dhe namazet e tjera nafile përfshihen të gjithë te namazet nafile. Ndërkaq ka edhe dijetarë që namazet nafile i trajtojnë në një kapitull të veçantë, përveç namazeve sunnet. Sipas këtij dallimi, namazet sunnet janë në përgjithësi namazet 'Reuatib', që falen para ose pas namazeve të kohës, ndërsa namazet nafile janë namazet që falen edhe me qëllime të ndryshme, siç është dëshira për t'u afruar me Allahun dhe për të fituar sevap. Këto namaze emërtohen 'Regaib'. Të tillë namaze janë: namazi i tehexh-xhudit, namazi i paradites, namazi i istihares, namazi ettehijjatu'l-mesxhid, namazi husuf (namazi i eklipsit hënor), namazi kusuf (namazi i eklipsit diellor).



"Një musliman, nëse fal çdo ditë dymbëdhjetë rekate namaz për hir të pëlqimit të Allahut në dispozitën nafile, përveç farzeve, Allahu i Lartmadhëruar e vë atë në xhennet në një qoshk" ose "Për të ndërton një qoshk në xhenet" (Muslim, Musafirin, 103. Përveç kësaj shihni edhe Ebu Dau'ud, Tatau'u, 1; Tirmidhi, Salat, 189; Kijamu'l-lejl, 66, 67).

3

Kohët e namazit



Namazet farz, namazi i vitrit, namazi i teravisë dhe namazi i Bajramit falen në kohë të caktuara. Për këto namaze koha është kusht. Namazet farz falen brenda pesë kohëve, të cilat janë: sabahu, dreka, ikindia, akshami dhe jacia. Namazi i xhumasë falet në drekë; namazi i vitrit dhe i teravisë falet në kohën e jacisë dhe pas namazit të jacisë.

Është kusht që namazet të falen në kohët e tyre. Namazi që falet pa ardhur koha nuk është i vlefshëm dhe duhet falur sërish. Falja e namazeve farz brenda kohës së caktuar quhet eda, ndërsa falja pasi të ketë dalë koha quhet kaza. Namazet farz dhe vaxhib, që nuk falen në kohë, bëhen kaza në kohë të tjera. Namazet sunnet, namazet e xhumasë dhe të Bajramit nuk bëhen kaza pasi të ketë ikur koha. Vetëm namazi i sabahut, për cilëndo arsye të mos jetë falur, në të njëjtën ditë, pasi dielli të ketë lindur dhe të jetë lartësuar pak, mund të bëhet kaza bashkë me sunnetin.

Në ditët e sotme kohët e namazeve konceptohen me llogari astronomike. Kohët e namazeve janë shkurtimisht kështu:

**Të studiojmë – Të mësojmë**

Lexoni informacione të tjera mbi përgjegjësinë shpirtërore të mosfaljes së namazeve në kohë dhe lënies së tyre për kaza!

Lexoni informacione të tjera mbi përgjegjësinë shpirtërore të mosfaljes së namazeve në kohë dhe lënies së tyre për kaza!

Koha e namazit të sabahut është koha që fillon kur në anën lindore nis të përhapet bardhësia në vendin ku do të lindë dielli, e deri në momentin kur dielli lind. Namazi i sabahut mund të falet që nga çasti kur kjo bardhësi e përhapur nis të duket për herë të parë në horizont. Limiti i fundit kohor i namazit të jacisë është po ashtu deri në këtë moment. E thënë ndryshe, kjo është koha që ndan namazin e jacisë me namazin e sabahut. Koha e namazit të sabahut vazhdon deri në lindjen e diellit.

Koha e namazit të drekës fillon që nga çasti kur dielli arrin në zenit dhe vijon deri kur nis të anohet drejt perëndimit. Koha kur sendet e lëshojnë hijen njësoj sa madhësia e tyre quhet 'Asru'l-euuel: Ikindia e parë', ndërsa kur hija është dyfish më e madhe quhet 'Asru'th-thani'.

Edhe koha e namazit të xhumasë është e njëjta me kohën e namazit të drekës.

Koha e namazit të ikindisë është koha që nis duke filluar nga përfundimi i kohës së drekës e deri kur të perëndojë dielli. Ndërsa vonimi i namazit të ikindisë deri në kohën kerahet para perëndimit të diellit është mekruh. Kjo periudhë kohe, që nis kur dielli fillon të marrë ngjyrë të kuqërreme e deri sa të perëndojë, është koha kur namazi i falur është mekruh (i papëlqyeshëm).



Koha e namazit të akshamit nis pasi dielli të perëndojë dhe vazhdon deri sa të humbasë shafaku i muzgut, i cili krijohet aty ku perëndon dielli. Shafaku i muzgut është bardhësia që shfaqet pasi perëndon dielli, pra, ngjyra e kuqërremtë në horizontin ku perëndon dielli dhe që shfaqet më pas. Ngaqë e ka kohën e kufizuar, falja e namazit të akshamit në kohën e tij të parë është mustehab. Për sa kohë nuk ka një justifikim, nuk duhet të vonohet.

Koha e namazit të jasisë është koha që nis që nga përfundimi i kohës së namazit të akshamit e deri në hyrjen e namazit të sabahut. Koha e namazit të jasisë nis krahas me zhdukjen e shafakut të muzgut që krijohet në anën ku ka perënduar dielli e vazhdon deri në agim, që është fillimi i namazit të sabahut. Kur vjen agimi, përfundon edhe koha e jasisë.

Koha e namazit të vitrit është koha e namazit të jasisë. Ndërsa namazi i vitrit falet pas namazit të jasisë.

Koha e namazit të teravisë është pas namazit të jasisë, si dhe vazhdon deri në kohën e namazit të sabahut. Namazi i teravisë mund të falet si para, ashtu edhe pas vitrit, por namazi i teravisë nuk mund të falet pa u falur namazi i jasisë.

Koha e namazeve të Bajramit fillon që nga koha kur dielli lartësohet në mëngjes dhe deri kur të dalë koha kerahet, për të vazhduar deri sa dielli të arrijë në zenit.

4

Farzet e namazit

54

Farzet e namazit janë dymbëdhjetë. Gjashtë prej këtyre janë para se të fillojë namazi dhe këto quhen kushtet e namazit. Ndërsa gjashtë prej tyre janë brenda tij dhe quhen shtyllat e namazit.

Kushtet:

- Pastrim nga hadethi (papastërtitë konvencionale) (marrja e abdestit nga ai që nuk ka abdest, marrja e guslit nga personi që është xhunub);
- Pastrimi nga papastërtitë (të mos gjendet papastërti në trup, në veshje dhe në vendin ku falet namazi, e cila do të jetë pengesë për namazin);
- Setru auret (mbulimi i pjesëve të trupit që duhet të mbulohen gjatë faljes së namazit);
- Istikbalu kible (orientimi drejt kibles gjatë faljes së namazit);
- Koha (falja e namazit brenda kohës);
- Nijeti (shprehja e nijetit për namazin që do të falet).

Shtyllat (pjesët përbërëse): a. Tekbiri iftitah (nisja e namazit me tekbir);

- Kijam (qëndrimi më këmbë);
- Kiraat (këndimi i një pjese nga Kur'ani);
- Ruku (përkulja aq sa duart të arrijnë deri në gjunjë);

- e. Sexhde (të bësh sexhde duke prekur ballin dhe hundën në tokë dhe duke vendosur duart, gjunjët dhe këmbët në tokë);
- f. Ka'de-i ahire (koha e qëndrimit ulur në fund të namazit, aq sa të këndohet Ettehijatu).

5**Vaxhibet e namazit**

Namazet kanë edhe farze, edhe vaxhibe. Në rast kryerje me vonesë të njërit prej vep- rimeve farz ose vaxhib, ose në rast se është harruar kryerja e çdonjërit prej tyre, bëhet “sexhdeja e sehvit”. Nëse vaxhibi braktiset me vetëdije namazi falet përsëri. Disa nga vaxhibet e namazit janë si më poshtë:

- 1) Të nisësh namazin me fjalën ‘Allahu ekber’;
- 2) Të këndosh suren ‘Fatiha’ në çdo rekat të namazeve;
- 3) Të këndosh nga një sure ose një ajet (që të mund të zërë vendin e një sureje pas Fatihasë) në çdo rekat, në dy rekatet e para të namazeve farz, në namazin e vitrit dhe namazet nafilë;
- 4) Të mos mjaftohemi vetëm me vendosjen e ballit në tokë gjatë kryerjes së sexhdes, por të vendosim edhe hundën;
- 5) Qëndrimi i parë ulur në namazet me tri dhe katër rekate;
- 6) Dhënia e selamit në fund të namazeve.

**55****6****Situatat që prishin namazin**

Është e domosdoshme që personi që fal namaz ta kryejë faljen duke respektuar farzet, vaxhibet, sunnetet dhe etikën e tij. Mos respektimi i këtyre nuk përputhet me thelbin dhe me shpirtin e namazit. Sjelljet që bien në kundërshtim me namazin, duke u bazuar te niveli i kësaj kundërshtie, ose e bëjnë mekruh namazin, ose e prishin atë. Së pari duhet të mundohemi të shpjegojmë shkurtimisht kriteret që prishin namazin.

Në rastet kur njëri prej farzeve të namazit është i mangët, namazi prishet. Përveç këtyre ka edhe kriteret e tjera që prishin namazin. Më të rëndësishmet prej këtyre kriterëve mund t’i radhisim si më poshtë:

1. Të flasësh në namaz;
2. Të hash dhe të pish diçka, të përtypësh çamçakëz;
3. Të qeshurit e personit aq sa ta dëgjojë vetë ai (nëse qesh aq sa ta dëgjojnë ata që ka pranë prishet edhe abdesti);

4. Të japësh selam, të marrësh selam, të qash për shkak të diçkaje në lidhje me botën, të rënkosh, të kollitesh pa pasur justifikim, t'i frysh diçkaje...
5. Të angazhohesh me një punë, aq sa t'i krijosh përshtypjen atij që sheh nga jashtë se nuk je në namaz. Kjo e fundit quhet 'Ameli kethir'.



Të studiojmë – Të mësojmë

- Mësoni nga veprat e ilmihalit hollësi të mëtejshme mbi situatat e tjera që prishin namazin!
- Përse e prishin namazin veprat e quajtura ameli kethir? Flisni mbi këtë çështje.

7

Situatat e tjera në lidhje me namazin



Krahas farzeve dhe vaxhibeve të namazit, gjenden edhe sunnetet dhe mekruhet e namazit.

Disa prej sunneteve që përfshihen në namaz janë si më poshtë:

- 1) Ngritja lart e duarve gjatë këndimit të tekbitit iftitah.
- 2) Këndimi heshtur i togfjalëshit 'Subhanekell-llahumme' pas tekbitit iftitah në krye të namazit, më pas përsëri këndimi në mënyrë të heshtur i fjalës 'Eudhubismil-lah' para sures Fatiha, po ashtu këndimi i fjalës bismil-lah në rekatet e tjera para sures Fatiha dhe thënia e fjalës 'amin' në fund të çdo sureje Fatiha.
- 3) Shqiptimi i shprehjes 'Allahu ekber' gjatë vajtjes nga kijami në ruku dhe në sexhde, po ashtu edhe thënia 'Semiallahu limen hamideh' gjatë ngritjes nga rukuja në kijam, si dhe shprehja 'Allahu ekber' përsëri gjatë ngritjes nga sexhdeja dhe gjatë vajtjes në sexhdenë tjetër.
- 4) Shqiptimi i shprehjes 'Subhane Rabbije'l-adhim' për më e pakta tri herë, po ashtu edhe thënia e shprehjes 'Subhane Rabbije'l-ala' tri herë në sexhde.
- 5) Këndimi i duave pas dhënies salat dhe selam në dy anët në qëndrimet e fundit ulur në të gjithë namazet.
- 6) Dhënia selam nga ana e djathtë pas daljes nga namazi dhe më pas nga ana e majtë është sunnet.



Të studiojmë – Të mësojmë

Studioni nga veprat ilmihali hollësi mbi sunnetet e tjera të namazit!

Namazet kanë edhe mekruhe (veprime të papëlqyeshme).

Mekruh janë të gjitha ato veprime, qëndrime dhe situata, të cila pengojnë përqendrimin në namaz, ose që nuk përputhen me respektin dhe me vartësinë ndaj Allahut. Në formë të përgjithshme këto e kanë burimin nga braktisja e njërit prej sunneteve të namazit. Po ashtu edhe të qëndrojmë në namaz në një situatë, e cila na angazhon zemrën dhe që pengon fokusimin në namaz është mekruh. Për shembull, qëndrimi në namaz në një mjedis ku ka muzikë, edhe pse personi ka mundësi të tjera për qëndrimin në namaz, ose qëndrimi në namaz duke qenë i shqetësuar për vjedhjen e një sendi, apo kur personi ndien nevojën për të kryer defekim ose urinim.

Nga veprat e fikhut dhe të ilmihalit mund të shohim një listë të përgjithshme të mekruheve që lidhen me namazin.



Falja e namazit



Do të tregojmë si shembull faljen e dy rekateve sunnet të namazit të sabahut duke respektuar farzet, vaxhibet dhe sunnetet:

- Qëndrojmë drejt kiblës duke qenë me abdest.
- Shprehim nijetin duke thënë: “Bëra nijet të fal namazin e sabahut, me qëllim fitimin e pëlqimit të Allahut”.
- Ngrehmë duart deri në nivelin e veshëve dhe këndojmë tekbir duke thënë: “Allahu ekber”.
- Më pas i lidhim duart në mënyrë që dora e djathtë të jetë mbi dorën e majtë, ndërsa pastaj i vendosim nën kërthizë. (Femrat i lidhin duart mbi gjoks, duke vendosur dorën e djathtë mbi dorën e majtë.)
- Më pas këndojmë duanë “Subhaneke”. Në vijim shprehim fjalën Eudhubismil-lah, këndojmë Fatihanë dhe një sure të shkurtër nga Kur’ani ose një ajet të gjatë apo tri ajete të shkurtra. Kjo është masa më e paktë e këndimit të Kur’anit, megjithatë mund të këndojmë edhe më shumë se kaq.
- Në vijim themi “Allahu ekber” dhe arrijmë në ruku. Pasi themi tri herë “Subhane Rabbije’l-Adhim” në ruku, ngrihem duke thënë “Semiallahu limen hamideh” dhe ndërsa jemi më këmbë themi “Rabbena leke’l-hamd”.
- Më pas, duke thënë “Allahu ekber”, së pari vendosim në tokë gjunjët, në vijim duart, më pas ballin dhe hundën dhe arrijmë në sexhde. (Gjatë sexhdesë gishtat e duarve dhe këmbëve i mbajmë të drejtuara nga kibla. Meshkujt nuk i mbështesin bërrylat në tokë.)
- Pasi të shqiptojmë “Subhane Rabbije’l-Ala” tri herë në sexhde themi “Allahu ekber” dhe qëndrojmë ulur aq sa të themi “subhanallah”.
- Përsëri arrijmë në sexhde duke thënë “Allahu ekber”. Më pas ngrihem më këmbë duke thënë “Allahu ekber” dhe lidhim duart.
- Edhe rekatin e dytë e falim si ai i pari. Mirëpo në rekatin e dytë nuk këndojmë duanë “subhaneke”. Vetëm themi Bismil-lah dhe nisim këndimin e sures Fatiha.



- Pas sexhdeve të rekatit të dytë qëndrojmë të ulur mbi gjunjë. Në këtë qëndrim këmbën e majtë e shtrijmë për tokë, gishtat e këmbës së djathtë i mbajmë drejt të drejtuar nga kibla, kurse duart i vendosim mbi gjunjë. Japim selam duke kënduar “Ettehijatu”, “Salauat” dhe dua.
- Dy rekatet farz të namazit të sabahut dhe të gjitha namazet dyrekateshe (sunnat ose nafile) i falim në këtë mënyrë. Në namazet prej tri dhe katër rekatesh, pasi ulemi në rekatën e dytë dhe shprehim “Ettehijatu”, themi “Allahu ekber” dhe ngrihem në këmbë e plotësojmë namazin. Mirëpo në rekatën e tretë dhe të katërt të namazeve prej tri ose katër rekatesh nuk këndojmë gjë pas sures Fatiha.

Namazet e kohës

Çdo ditë ka nga pesë kohë namaz. Namazi i sabahut ka dy rekate farz, namazi i drekës katër, namazi i ikindisë katër, namazi i akshamit tri dhe namazi i jacisë katër rekate farz. Ndërsa namazi i vitrit që falet pas jacisë është tri rekate. Por ka edhe sunnete që falen para, pas ose si para ashtu edhe pas farzit të kohës. Në përputhje me këtë, bashkë me sunnetet që falen para, pas ose si para dhe pas në një ditë (24 orë) ka 17 rekate farz, 3 rekate vaxhib (namazi i vitrit) dhe 20 rekate sunnat, pra plot 40 rekate namaz. Këtë mund ta tregojmë kështu me anë të një skeme:

58

KOHËT	Sunnati i parë	Farzi	Sunnati i fundit	Gjithsej
Sabahu	2	2		4
Dreka	4	4	2	10
Ikindia	4	4		8
Akshami		3	2	5
Jacia	4	4	2	10
Vitri (pas jacisë)			(vaxhib 3)	3
Gjithsej	14	17	9	40

Sunnati më i efektshëm ndërmjet sunneteve pas farzeve dhe namazit të vitrit është sunnati i namazit të sabahut. Ndërsa sunnati i namazit të ikindisë dhe sunnati i parë i namazit të jacisë është ndër sunnetet gajri muekked.

Namazi i sabahut

Nijeti për faljen e namazit të sabahut bëhet në trajtën: ‘Po bëj nijet për faljen e namazit të sabahut’. Këndimi i një pjese më të shumtë Kur’ani në farzin e namazit të sabahut pas këndimit të Fatihasë është sunnat. Personi që fal namazin e sabahut në mënyrë

individuale, tekbiret dhe fjalinë ‘Semiallahu limen hamideh’, Fatihanë dhe ajetet që do të shtojë, mund t’i këndojë me zë.



Të diskutojmë së bashku

Tregoni se si falet farzi i namazit të sabahut!

Namazi i drekës

Dy rekatet e para të sunnetit prej katër rekatësh të namazit të drekës falen pikërisht si dy rekatet e namazit të sabahut. Dallimi i vetëm është te nijeti. Bëhet nijet duke thënë: “Po bëj nijet për sunnetin e parë të namazit të drekës së sotme.” Po ashtu, qëndrimi ulur pas rekatit të dytë (jo qëndrimi i fundit ulur), për shkak se është qëndrimi i parë ulur (ka’de), vetëm në këtë qëndrim këndohet ‘et-Ettehijjat’. Edhe falja e dy rekateve të tjera është njëloj. Dallimi i vetëm është këndimi i duasë “Subhaneke” kur personi ngrihet në rekatën e tretë.

Përveç moskëndimit të një sureje pas Fatijasë në dy rekatet e fundit, edhe falja e katër rekateve farz është pikërisht si sunneti i parë i drekës.

Edhe falja e dy rekateve sunnet të fundit të drekës është njësoj si sunneti i namazit të sabahut.



Namazi i ikindisë

Në qëndrimin ulur pas faljes së dy rekateve sunnet nga katër rekatet sunnet te namazi i ikindisë, si shtesë e duasë Ettehijjat këndohen edhe duatë Sal-li dhe Barik. Më pas personi ngrihet dhe fal dy rekatet e fundit. Këto rekate dyshe janë njësoj si namazet e posaçme dyrekatëshe. Prandaj, çdonjëri prej tyre, pra çdo dyrekatësh falet pikërisht ashtu si dy rekatet sunnet të namazit të sabahut. Ndryshimi i vetëm është se nuk jepet selam ndërkohë që falet ky rekat. Ndërsa farzi i namazit të ikindisë falet pikërisht si farzi i namazit të drekës.

Namazi i akshamit

Tri rekatet farz të namazit të akshamit falen si tri rekatet farz të namazeve të drekës dhe ikindisë. Më pas personi ulet dhe këndon duatë “Ettehijjat dhe salauatet” dhe “duanë

Rabbena", ndërsa në vijim jep selam në të dyja anët. Në farzin e namazit të akshamit, për shkak të kohës së shkurtër këndohen sure të shkurtra. Sunneti i namazit të akshamit falet pikërisht si sunneti i namazit të sabahut. Falja e këtij sunneti në formën e gjashtë rekateve është mustehab.

Namazi i jaciesë

Katër rekartet e para sunnet të namazit të jaciesë falen pikërisht si katër rekartet sunnet të namazit të ikindisë. Edhe katër rekartet farz falen ashtu si farzet e namazeve të drekës dhe ikindisë. Sa i përket sunnetit të fundit të dy rekateve, edhe këta falen pikërisht si dy sunnetet e namazeve të sabahut dhe të akshamit. Edhe sunneti i fundit i namazit të jaciesë mund të falet njësoj si katër rekartet. Megjithatë, mund të falet edhe duke dhënë selam një herë në dy rekate.

Në namazet nafile që falen gjatë natës, më e vërtetshme është të jepet selam një herë në çdo dy rekate.

Namazi i vitrit

Namazi i vitrit është tri rekate. Dy rekartet e para falen njësoj si sunneti i namazit të sabahut. Në qëndrimin ulur pas dy rekateve personi ngrihet në rekatën e tretë, pasi ka kënduar duanë Ettehijjat. Në vijim këndohet Bismil-lah, Fatihaja dhe një pjesë nga Kur'ani, ndërkohë që personi është ende më këmbë ngrihen duart dhe këndohet tekbir duke thënë "Allahu ekber". Më pas ngrihen përsëri duart dhe këndojmë duanë "Kunut" kur jemi më këmbë. Në vijim themi "Allahu ekber" dhe drejtohem drejt rukusë e sexhdeve. Më pas personi ulet. Këndohen duatë "Ettehijjat", "Salauat" dhe "Rabbena", si dhe jepet selam në të dyja anët.

Namazi i xhumasë

Për meshkujt, falja e namazit të xhumasë është në dispozitën farz ajn. Ata që falin namazin e xhumasë atë ditë nuk e falin namazin e drekës.

Namazi i xhumasë falet patjetër në xhami dhe me xhemaat. Para farzit këndohet hutbe. Farzi i namazit të xhumasë është dy rekate. Para dhe pas farzit falen sunnetet e xhumasë nga katër rekate. Pas kësaj, ai që dëshiron fal katër rekate namaz me emrin "Dhuhri ahir" dhe dy rekate namaz si "sunneti i kohës".

Dita e premte është shumë e rëndësishme për muslimanët. Të lahesh e të pastrohesh, të veshësh rroba të pastra apo të sillësh mirë, janë ndër kushtet etike të xhumasë.



Të studiojmë – Të mësojmë

- Hollësi të tjera për kushtet e nevojshme të vlefshmërisë së namazit të xhumasë lexojini nga veprat e ilmihalit.
- Po ashtu, studioni nga këto vepra se cila kategori njerëzish nuk është përgjegjëse për namazin e xhumasë.

Namazi i xhenazes

Kushti i namazit të xhenazes është nijeti. Me këtë nijet përcaktohet nëse i vdekuri është burrë apo grua, vajzë apo djalë. Bëhet nijet për të falur namaz në emër të Allahut, për të kënduar dua për xhenazen dhe për t'iu përshtatur imamit.

Pas këndimit të tekbitit të parë duart lidhen ashtu si në namazet e tjera dhe këndohet duaja “Subhaneke”. Pasi merret tekbiti i dytë pa ngritur duart, bashkë me imamin këndohen duatë “Allahumme sal-li dhe allahumme barik”. Pas tekbitit të tretë bëhet dua për të vdekurin dhe muslimanët e tjerë. Pas tekbitit të katërt jepet selam, së pari në anën e djathtë, më pas në anën e majtë dhe përfundohet namazi.

Është mustehab (veprim i pëlqyeshëm) që xhenazet të varrosen sa më parë. Nuk është diçka e pëlqyeshme që varrimi të vonohet pa pasur ndonjë justifikim.

Namazet e Bajramit

Gjatë vitit ka dy bajrame:

1. Bajrami i Ramazanit: janë dita e parë, e dytë dhe e tretë e muajit sheu’ual, që ndjek muajin Ramazan.
2. Bajrami i Kurbanit: janë dita e dhjetë, e njëmbëdhjetë, e dymbëdhjetë dhe e trembëdhjetë e muajit dhilhixh-xhe, si muaji i dymbëdhjetë i muajve hënorë.

Të dy namazet e Bajramit janë nga dy rekate. Namazi falet në ditën e parë të Bajramit, pasi dielli të lindë dhe të ketë kaluar koha kerahet (koha e papëlqyeshme). (Shihni çështjen mbi kohët e namazit).

Falja e namazit të Bajramit për ata që kanë farz namazin e xhumasë është vaxhib.

Në namazet e bajrameve, në dallim nga namazet e tjera, ka edhe gjashtë tekbitë shtesë. Tri prej këtyre janë në rekatin e parë, ndërsa tri në rekatin e dytë.

Namazi i Bajramit falet si në vijim:

- Së pari bëhet nijet për faljen e namazit të Bajramit (Ramazan ose kurban).
- Këndohet tekbit duke respektuar imamin.
- Pas këndimit të duasë Subhaneke ngrihen sërish duart deri në nivelin e lartësisë së veshëve bashkë me imamin dhe këndohet tri herë tekbit. Në dy tekbitet e para duart lihen mënjane, ndërsa në të tretën lidhen, këndohet Fatiha dhe një pjesë nga Kur’ani.
- Më pas kryhen rukuja e sexhdet dhe plotësohet rekati i parë
- Në rekatin e dytë, pasi këndohet Fatiha dhe një pjesë Kur’ani nga imami, personi nuk kalon në ruku, por këndon përsëri tri herë tekbit. Në çdo tekbit duart lihen mënjane. Më pas, me tekbitin e katërt personi arrin në ruku dhe e plotëson namazin ashtu si namazet e tjera.
- Në vijim imami ngjitet në minber dhe këndon hutbe (këndimi i kësaj hutbeje është sunnet). Pas përfundimit të hutbesë këndohen dua.

Namazi i teravisë

Namazi i teravisë është një namaz sunnet, i cili në Ramazan falet pas namazit të jaxisë. Ai mund të falet me xhemaat ose individualisht. Duke qenë se namazi i teravisë nuk është ndër sunnetet e agjërimit, por i muajit të Ramazanit, këtë namaz mund ta falin edhe ata që nuk mbajnë agjërim për ndonjë arsye. Në Ramazan edhe namazi i vitrit falet me



xhemaat pas teravisë. Namazin e teravisë e fal çdo musliman mashkull, femër, udhëtar ose jo udhëtar.

Në rast se namazi i teravisë falet duke dhënë selam një herë në dy rekate, veprimet për faljen e tij janë njësoj si sunneti i namazit të sabahut. Ashtu siç mund të falet duke dhënë selam një herë në dy rekate, mund të falet edhe duke dhënë selam një herë në katër rekate. Në këtë rast falet njësoj si sunneti i parë i jacisë, por më e virtytshme është falja duke dhënë selam një herë në dy rekate.



“Kushdo që fal namazin e teravisë duke besuar në virtytshmërinë e Ramazanit dhe duke e pritur sevapin nga Allahu, atij i falen gjynahet e shkuara” *(Buhari, Iman, 37; Muslim, Musafirin, 173, 174. Përveç kësaj shihni edhe Ebu Dau’ud, Ramazan, 1; Tirmidhi, Saum, 1; Nesai, Kijamu’l-Lejl, 3, Saum, 39, 40, Iman, 31, 32; Ibni Maxhe, Ikamet, 173, Sijam, 3, 39, 40).*



Sexhdet e sehvit dhe të tilavetit

Termi sehvi ka kuptimin kuptimin e mashtrimit dhe të harresës. Edhe sexhdeja e sehvit vjen në kuptimin e sexhdes së gabimit. Sexhdet sehvi janë sexhde që kryhen për shkak të vonimit të njërit prej farzeve të namazit, braktisjes së njërit prej vaxhibeve ose voni-

mit të tyre për shkak të ndonjë gabimi, për shkak të harresës apo si pasojë e një hutimi momental. Si rezultat, edhe vonimi i farzeve përfshihet te braktisja e vaxhibit. Mangësia që shkaktohet në namaz plotësohet me sexhdet e sehvit. Kryerja e sexhdeve sehv në situatat e nevojshme është vaxhib.

Në rastin e braktisjes së sunneteve të namazeve nuk është e nevojshme kryerja e sexhdeve sehv.



Të studiojmë – Të mësojmë

Studioni nga veprat e ilmihalit mbi situatat, në të cilat nevojitet sexhdeja e sehvit dhe se si kryhet ajo!

Sa i përket sexhdes së tilavetit:

Në Kur'anin Famëlartë gjenden katërmbëdhjetë ajete sexhdeje. Çdo person përgjegjës që këndon ose dëgjon njërin prej këtyre ajeteve, duhet të bëjë sexhdenë e tilavetit. Edhe pse nuk është kusht kryerja menjëherë e sexhdesë së tilavetit, është më mirë që të kryhet pasi të këndohet ajeti i sexhdesë.

Personi që do të kryejë sexhdenë e tilavetit duhet të jetë me abdest, rrobat t'i ketë të pastra njësoj si në namaz dhe pjesët e turpshme të mbuluara.

Kur këndohet ajeti i sexhdesë është veprim i pëlqyeshëm që të kryhet sexhdja menjëherë, kur kjo nuk është e mundur atëherë personi që lexon dhe ata që dëgjojnë duhet të thonë: "Semi'na ue eta'na gufraneke Rabbena ue ilejke'l-mesir".

Situatat që prishin namazin, prishin edhe sexhden e tilavetit.



Të studiojmë – Të mësojmë

Studioni suret ku gjenden ajetet e sexhdesë në Kur'anin Famëlartë dhe numrat e ajeteve.

10

Namazi në situata të posaçme

Muslimani, në cilëndo pozitë apo kusht qoftë, ka nevojë ta vijojë kontaktin me Zotin e tij. Si rrjedhojë, qoftë në rrethana të zakonshme, qoftë në rrethana të jashtëzakonshme, ai është në pozitë që të plotësojë adhurimin e tij të përditshëm. Megjithatë, duke ditur vështirësitë në të cilat gjendet shpesh njeriu, janë marrë parasysh disa lehtësi. Kjo situatë pasqyron parimin e lehtësisë së fesë islame në jetën adhurimore. Këtu do të trajtojmë disa prej këtyre lehtësive.



63



Namazi i udhëtarit

Personi që është udhëtar quhet 'seferi'. E kundërta e personit në pozitën seferi është 'mukim' (vendës). Mukim do të thotë banor në një vend, që nuk është udhëtar. Me termin 'mukim', në jurisprudencën islame quhet personi që banon në vendlindjen e tij (në njësinë e tij administrative), ose në një vend që është në pozitën e atdheut për të. Kështu, një person që del nga një vend dhe nisat drejt një vendi me një distancë prej më e pakta 18-orëshe, afërsisht 90 km, emërohet si 'Misafir/udhëtar'.

Në përgjithësi, udhëtimi bart disa lloje vështirësish dhe problemesh që nuk përjetojnë në periudha të zakonshme dhe në një situatë kur individ është vendës. Si rrjedhojë, ndaj udhëtarëve janë njohur disa lehtësi në lidhje me jetën e tyre adhurimore.

Udhëtari, farzet prej katër rekatësh i fal në formën e dy rekatëve, ndërsa rekatet treshe dhe dyshe i fal në të njëjtën formë. Edhe pse nuk arrin t'i falë sunnetet, është më e përshtatshme që t'i falë kur të ketë kohë të përshtatshme.



Udhëtarët, ashtu siç nuk janë përgjegjës me namazet e xhumasë dhe të Bajramit, nuk janë përgjegjës as me kurbanin. Mirëpo nëse dëshirojnë i plotësojnë këta dhe marrin sevapin e tyre. Në rast se nuk kanë arritur të falin namazin e xhumasë, nevojitet të falin namazin e drekës së asaj dite.

Personi që largohet nga vendlindja duke bërë nijet për udhëtim, për sa kohë nuk kthehet në vendlindjen e tij ose nuk bën nijet për të qëndruar për 15 ditë në vendin ku shkon, apo bën nijet për të qëndruar më shumë se kaq, në të tilla rrethana situata e tij prej udhëtari vazhdon.

64



Le të lexojmë

Lexoni nga veprat e ilmihalit hollësi të tjera që lidhen me namazin e udhëtarit!

Namazi i të sëmurit

Njëra prej situatave ku individët ndiejnë vështirësi dhe përjetojnë probleme është gjendja e të qenit i sëmurë. Sipas rëndesës së sëmundjes, këto probleme pakësohen ose shtohen. Mirëpo njerëzit, qoftë edhe nëse janë të sëmurë, duhet të vijojnë lidhjen e përditshme me Allahun e Lartmadhëruar. Për këtë arsye, edhe të sëmurët kanë nevojë për adhurim. Madje, nevoja e tyre është ndoshta edhe më e tepërt. Si rrjedhojë, edhe të sëmurët, për sa kohë gëzojnë shëndet mendor, janë përgjegjës për disa detyra fetare. Megjithatë, feja jonë u ka njohur atyre disa lehtësi, të cilat u njihen të sëmurëve edhe kur është fjala për namazin.

Mbi të gjitha, një i sëmurë është përgjegjës për faljen e namazit në përputhje me fuqinë që ka. Ai që nuk ka forcë të qëndrojë më këmbë ose një i sëmurë, qëndrimi më këmbë i të cilit do të bëhej shkak për vonesë në përmirësimin e sëmundjes ose për shtim të saj, ulet dhe e fal namazin duke qenë ulur. Nëse nuk është i aftë as të ulet e fal namazin i shtrirë mënjane, ose duke qenë i shtrirë mbi shpinë dhe falet me shenja.

Falja me shenja do të thotë të përkulësh kokën si shenjë ndaj rukusë dhe sexhdesë. Falja me shenja mund të bëhet më këmbë, por mund të bëhet edhe ndërsa personi qëndron ulur.

Namazet e një të sëmuri, i cili nuk është i aftë të falë edhe namaz me shenja, mbeten për më vonë dhe kur të shërohet i bën kaza. Sipas disa dijetarëve, namazet që zgjasin për më shumë se një ditë dhe një natë, bien plotësisht nga ai. Edhe nëse gëzon shëndet të plotë mendtor dispozita është e tillë.

11

Bashkimi i namazeve



Falja e namazeve të drekës dhe ikindisë, të akshamit dhe jaciesë, në situata kur gjendet një justifikim legjitim, si për shembull mosndalimi i automjetit të transportit publik ndërqytetës, në asnjërën prej kohëve si dreka dhe ikindia apo akshami e jacia, është ndër lehtësitë që njihet në çështjen e namazit.

Namazet që mund të bashkohen si rrjedhojë e një justifikimi të vlefshëm fetarisht, janë namazi i drekës dhe ikindisë, si dhe namazi i akshamit dhe jaciesë, që vijnë pas njëri-tjetrit. Njësoj siç namazi i sabahut nuk mund të bashkohet me asnjë namaz, edhe dreka me akshamin ose ikindia me jacinë nuk mund të bashkohen.



Le të kujtojmë

Për shkak të një justifikimi të vlefshëm fetarisht, falja e namazit të ikindisë bashkë me atë të drekës në kohën e drekës, po ashtu edhe falja e jaciesë dhe akshamit në kohën e akshamit emërohet si 'xhem'u takdim (bashkimi duke i falur në një kohë të marrë para); falja e drekës bashkë me ikindinë në kohën e ikindisë, po ashtu edhe falja e akshamit bashkë me jacinë në kohën e jaciesë emërohet si 'xhem'u te'hir (bashkimi duke i marrë në një kohë të pasme).

Personi që do të falë namazet duke i bashkuar për shkak të një justifikimi të vlefshëm fetarisht, i fal këta namaze njëri pas tjetrit dhe sipas radhës; nuk fal sunnetet që mbeten mes dy farzeve. Për shembull, nëse autobusi në të cilin hip dikush që do të bëjë udhëtim ndërqytetës bën pushim në kohën e drekës dhe nëse nuk do të ndalet në kohën e ikindisë, ky person, pasi fal farzin e namazit të drekës pa falur sunnetin e ndërmjetëm këndon kamet edhe për farzin e namazit të ikindisë dhe menjëherë në vijim fal farzin e ikindisë. Kështu bartet ikindia në kohën e drekës. Kjo quhet xhem'u takdim. Përkundër kësaj, edhe nëse autobusi i tij nuk do të ndalet në periudhën e drekës, por do të ndalet



në kohën e ikindisë, duke bashkuar drekën me ikindinë, bën nijet të falë namazin e drekës dhe të ikindisë duke i bashkuar ata dhe në kohën e ikindisë së pari fal namazin e drekës. Pa falur sunnetin e fundit të drekës dhe sunnetin e ikindisë, këndon kamet menjëherë dhe fal edhe farzin e ikindisë. Në këtë mënyrë personi bart drekën në kohën e ikindisë. Ndërsa kjo quhet xhem'u te'hir.

12

Xhamia dhe namazi me xhemaat



Allahu i Lartmadhëruar urdhëron kështu: “Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zeqatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.” (*Teube, 9/18*).

66

Për sa kohë nuk ka një justifikim të rëndësishëm, falja e namazeve nga muslimani në xhami me xhemaat është një detyrë e rëndësishme fetare. Sa i përket kësaj çështjeje, ka mjaft hadithe që nxisin faljen e namazit me xhemaat dhe na përkujtojnë peshën që marrim mbi vete në rast ë braktisjes së namazit me xhemat.



“Nëse dikush pastrohet mirë në shtëpinë e tij dhe më pas shkon në njërën prej shtëpive të Allahut për të plotësuar një farz prej farzeve të Allahut, çdonjëri prej hapave që hedh fshin nga një gjynah; ndërsa hapi tjetër i tij e ngre atë një nivel më lartë” (*Muslim, Mesaxhid, 282*).

Namazit me xhemaat i kushtohet kaq shumë rëndësi për shkak të kontributit që ka në lidhje me unitetin, bashkimin, solidaritetin dhe ndihmesën e ndërsjellë në xhemaat. Më poshtë, nën titullin ‘Namazi me xhemaat’ janë dhënë informacione më të gjera mbi këtë kriter.

13

Roli shoqëror i xhamive

Vetë kuptimi i fjalës ‘xhami’ jep shumë të dhëna të rëndësishme në lidhje me rolin shoqëror të xhamive, sepse fjala ‘xhami’ do të thotë ‘mbledhës, bashkues’. Që nga periodhat e hershme xhamia ka luajtur rol të rëndësishëm në mbajtjen gjallë të shpirtit të unitetit, bashkimit, solidaritetit dhe ndihmesës së ndërsjellë që gjendet në thelbin e Islamit.

Xhamia ka luajtur një rol qendror në formimin e shoqërisë së parë islame. Me këtë qëllim, Hz. Pejgamberi, pas hixhretit, sapo mbërriti në Medine, menjëherë urdhëroi ndërtimin e një mesxhidi; ai ka nisur nga xhamia për të formuar institucionet islame dhe institucioni i parë islam i formuar ka qenë pikërisht xhamia. Ai ka organizuar këtu mbledhjet këshillimore me sahabet e tij dhe themeli i mjaft aktiviteteve të hairit është hedhur po ashtu në xhami. Kështu, xhamitë, që nga periudhat e hershme të Islamit, kanë vijuar të kenë një rol të rëndësishëm në jetën e muslimanëve.

Kur e shohim nga pikëpamja e shembullit të Hz. Pejgamberit, vërehet se xhamitë kanë një brendi ndryshe, përtej të qenit një vend adhurimi. Xhamitë kishin një rol thelbësor, pasi ishin një vend ku realizoheshin aktivitete edukative, ku diskutoheshin disa tema që i interesonin shoqërisë, ku strehoheshin persona që nuk kishin shtëpi dhe vendbanim, si dhe ku realizoheshin mjaft veprime të tjera të hairit. Madje, xhamitë kanë qenë përcaktuese në formimin e qendrave të vendbanimit. Në vendbanimet që do të ndërtoheshin, së pari është përcaktuar vendi i xhamisë, më pas pjesët e tjera të qytetit janë formuar rreth saj. Kështu xhamitë kanë ofruar shërbim si institucione shumëdimensionale, në të cilat zgjidheshin problemet e muslimanëve, ku forcoheshin uniteti dhe bashkimi i tyre, ku hidheshin themelet e solidaritetit social, ku vijoheshin shumë aktivitete krahas kryerjes së adhurimit etj..

Xhamia ka një funksion bashkues. Ajo bashkon në të njëjtin saf njerëzit që janë të vetëdijshëm për vartësinë ndaj Allahut; në të lihen mënjanë dallimet profesionale, sociale dhe kulturore, lihen mënjanë privilegjet dhe njerëzit janë të gjithë si një trup i vetëm. Cili institucion mund ta mundësojë afrimitetin shoqëror, bashkimin, solidaritetin dhe ndihmesën shoqërore më mirë se xhamia?



Të diskutojmë së bashku

Diskutoni me njëri-tjetrin mbi rolin shoqëror të xhamive në ditët e sotme!

14

Etika e xhamisë



Rregullat që kanë të bëjnë me etikën e xhamisë mund t'i analizojmë nën tre tituj kryesorë. Si më kryesorët ndër këto rregulla janë ato që kanë të bëjnë me marrëdhëniet njerëzore dhe të mirësjelljes, të cilët nevojitet të respektohen nëpër xhami. Xhamitë janë vende ku njerëzit mblidhen për adhurim dhe veprimtari me cilësi fetare. Atje njerëzit bëhen të gjithë bashkë. I njëjti vend ndahet në mënyrë të përbashkët nga shumë njerëz. Të gjendesh bashkë me njerëzit dhe të përdorësh të njëjtin vend është diçka që kërkon edhe respektimin e disa rregullave të mirësjelljes. Rregulla të tillë si respekti,



dashuria, mirësjellja, shmangia ndaj sjelljeve dhe qëndrimeve që mund të shqetësojnë të tjerët, kujdesi që të mos lëndohen të tjerët dhe mosshqetësimi i tyre, janë që të gjithë rregulla që kërkohen të plotësohen në kuadrin e etikës së mirësjelljes në fenë islame.

Pejgamberi ynë ka kërkuar që të mos shkojmë në xhami me aroma që shqetësojnë të tjerët. Nga kjo pikëpamje, duke qenë se xhamitë janë vende që bashkojnë njerëzit, nevojitet të qëndrojmë larg qasjeve dhe sjelljeve që shqetësojnë të tjerët. Për shembull, të shkosh në xhami me çorape që mbajnë aromë të keqe, të mbash qëndrime dhe sjellje që mund të shqetësojnë njerëz të tjerë, të gjitha këto janë veprime që nuk përputhen me etikën e xhamisë.



Ajeti në kuptimin: “O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë” (*A’raf, 7/31*), tregon për kriterin themelor në lidhje me këtë çështje. Po ashtu, edhe Hz. Pejgamberi urdhëron si në vijim: “Kur dikush prej jush do të shkojë në xhuma le të marrë gusul” (*Buhari, Xhum’a, 2, 5, 12; Muslim, Xhum’a, 1, 2, 4; Tirmidhi, Xhum’a, 3; Nesai, Xhum’a, 7, 25; Ibn Maxhe, Ikamet, 80*).

Kriteri i dytë që duhet të respektohet në çështjen e etikës së xhamisë është mirëmbajtja me pastërti dhe përkujdesja ndaj xhamive. Të qenët të papastër dhe të parregullt të një vendi, në të cilin kryhen adhurime dhe ushtrohen veprimtari të ndryshme me cilësi fetare, bëhet shkak që çdokush që vjen në atë vend të ndihet i shqetësuar. Kjo situatë bie në kundërshtim edhe me adhurimin e kryer në qetësi të plotë shpirtërore. Për këtë arsye përkujdesja dhe pastërtia e xhamive është përgjegjësia e përbashkët e xhemaatit të xhamisë.

Ndërsa kriteri i tretë është etika në lidhje me adhurimin. Në mënyrë figurative xhamitë janë emëruar si ‘Bejtullah’, pra, shtëpitë e Allahut. Si rrjedhojë, ato konsiderohen vende të shenjta. Është e domosdoshme që të ruhet shenjtëria dhe respekti ndaj këtyre vendeve të shenjta, të cilat janë ndërtuar për të shprehur adhurim ndaj Allahut. Prandaj edhe në xhami hyjmë duke qenë me abdest. Nuk është e lejuar që në xhami të hyjmë thjesht për të kaluar, njësoj siç jemi duke ecur në rrugë, pra pa pasur asnjë detyrim ose një situatë që e bën të domosdoshme këtë. Në të njëjtën mënyrë, edhe të lypësh brenda në xhami është haram, ndërsa të bësh tregti brenda saj nuk është e lejuar. Kjo është diçka që nuk bie në përputhje me respektin që duhet të tregohet ndaj xhamisë.

15

Namazi me xhemaat



Të falësh namazin me xhemaat është një sunnet i rëndësishëm dhe një ndër karakteristikat dalluese të Islamit.

Të braktisësh namazin me xhemaat, pa pasur një justifikim të vlefshëm, nuk është e drejtë, pasi kështu braktiset një simbol i rëndësishëm i fesë islame (njëra ndër veprat në pozitën e simbolit). Xhemaati është njëri ndër kriteret më të rëndësishme që mundëson

bashkimin e unitetin, forcon dashurinë, respektin dhe solidaritetin, bëhet shkak për këmbimin e dijes dhe kulturës. Përveç kësaj, shpresohet që adhurimi i kryer bashkë me njerëz vepërmirë do të pranohet më mirë pranë Allahut.

Rasulullahu (s.a.s.) urdhëron kështu:



“Namazi që falet me xhemaat është njëzet e shtatë herë më i virtytshëm se namazi që falet më vete” (Buhari, Ezan, 30; Muslim, Mesaxhid, 249. Përveç kësaj shihni edhe Nesai, Imamet, 42; Ibni Maxhe, Mesaxhid, 6).

16

Çfarë përfiton njeriu nga adhurimi i namazit?



“Kur një musliman (ose besimtar) merr abdest, ndërsa lan fytyrën, gjynahet që ka kryer me sy dhe shikim, largohen bashkë me ujin e abdestit (ose me pikën e fundit të ujit). Kur lan duart, gjynahet që ka kryer me duar largohen bashkë me ujin e abdestit (ose me pikën e fundit të ujit). Kjo ndodh deri në atë pikë sa individi pastrohet nga të gjitha gjynahet. Ndërsa kur lan këmbët, gjynahet që ka kryer me këmbë i bien bashkë me ujin e abdestit (ose me pikën e fundit të abdesit). Së fundmi, ai musliman pastrohet plotësisht nga gjynahet” (*Muslim, Taharet, 32. Përveç kësaj shihni edhe Tirmidhi, Taharet, 2*).

Namazi është një ndër adhurimet më të rëndësishme që i përfiton njeriut vlera të bukura dhe e përçon atë drejt qetësisë shpirtërore. Namazi ndriçon zemrën, pastron shpirtin, largon njeriun nga të këqijat, e shtyn atë drejt mendimeve pozitive dhe të qenit me moral të bukur. Namazi e përçon njeriun drejt pëlqimit të Allahut duke e pastruar nga gjynahet.

Namazi është miraxhi i besimtarit, është ngjitje në praninë e Allahut. Prandaj edhe për besimtarët që kanë arritur të kapin shijen e besimit, namazi është burim i një lumturie të madhe. Sepse për një musliman, gëzimi më i madh është të pranohet në praninë e Allahut. Prandaj, në saje të namazit, muslimani arrin të kapë këtë lumturi. Për këtë arsye besimtarët e vërtetë nuk e shohin kurrë namazin si një peshë, por e presin gjithë hare e gëzim. Njëri prej shtatë grupeve të njerëzve, të cilët Hz. Pejgamberi i cilëson si persona me zemër të lidhur ndaj mesxhideve dhe që jep sihariqin për ta se do të arrijnë në shpëtim në jetën e ahiretit, janë njerëzit me zemër të lidhur ndaj mesxhideve. Besimtari, në saje të mesxhideve lartësohet në praninë shpirtërore të Allahut dhe afrohet me Të.

Namazi, i cili është shpërndarë në orë të caktuara të ditës, përqafon çdo aspekt të jetës së njeriut, krijon disiplinë të brendshme tek individi dhe jep mundësinë që ky i fundit të kontrollojë veten. Në saje të kësaj, njeriu arrin të largohet nga të këqijat. Ja pra, gjëja më e rëndësishme që namazi i përfiton njeriut është të luajë funksionin e një mburoje, e cila e mbron atë nga të këqijat.

Namazi është një edukim sinqeriteti. Njeriu që fal namaz mëson sinqeritetin dhe përzemërsinë. Sinqeriteti i muslimanit pasqyrohet tashmë në çdo fushë të jetës dhe kështu muslimani nis të sillet me sinqeritet në të gjitha veprat dhe sjelljet e tij.

Namazi, përveçse në jetën shpirtërore, fal gjallëri edhe në jetën materiale. Ai ndihmon që njeriu të jetë i kujdesshëm dhe i rregullt ndaj pastërtisë e shëndetit, si dhe i krijon atij zakonet e administrimit të kohës.

Namazi, i cili falet në kohë të caktuara, i mban mendjet të gjalla në çështjen e fuqisë dhe forcës absolute të Allahut, duke ruajtur në vetëdije amanetin që i është ngarkuar.



Të diskutojmë së bashku

Përgatisni në mënyrë të listuar dobite që përfiton njeriu nga namazi.



“Namazi është vepra e parë, për të cilën robi do të gjykohej ditën e kiametit. Nëse është i rregullt në namaz, puna e tij ecën mirë dhe me fitim. Nëse nuk është i rregullt në namaz, atëherë humbet dhe del me dëm. Nëse nga farzet e tij rezulton ndonjë mangësi, atëherë Zoti urdhëron si më poshtë:

- Shihni nëse robi im ka namaze nafile. Kështu mangësia e farzeve plotësohet bashkë me nafilet. Më pas edhe për veprat e tjera gjykohej në këtë mënyrë” *(Tirmidhi, Meuakit, 188. Përveç kësaj shihni edhe Ebu Dau’ud, Salat, 149; Nesai, Salat, 9; Ibn Maxhe, Ikamet, 202).*

Ndërsa një dobi tjetër që përfiton njeriu nga namazi është krijimi i marrëdhënies me të tjerët dhe njohja me problemet e tyre. Kështu namazi e shpëton njeriun nga mbyllja në vetvete dhe nga shkëputja prej shoqërisë, po ashtu edhe nga përjetimi i disa problemeve dhe jep kontribut në socializimin e tij. Namazi, pa njohur dallim race, gjuhe, ngjyre, shteti, të qenit të personit i varfër apo i pasur, i mbledh besimtarët në një saf dhe forcon vetëdijen e shoqërisë.



“Mjerë ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet dhe që vetëm duken e nuk i ndihmojnë nevojtarët” *(Maun, 107/4-5).*



Përmbledhja e kapitullit

Namazi është shtylla e fesë. Ky adhurim ditor i namazit ka vend shumë të rëndësishëm në jetën e muslimanëve. Namazi, i cili mundëson lidhjen e pashkëputur mes muslimanit dhe Zotit të tij, është ushqimi i shpirtit.

Ekzistojnë mjaft informacione që përfshihen në jurisprudencën islame, të tilla si të qenët e namazit farz, llojet, mënyra e faljes, farzet, vaxhibet, sunnetet dhe veprimet që e prishin namazin. Një pjesë e këtyre janë trajtuar në kapitullin që sapo lexuat. Për infor-

macione më të gjera në lidhje me këtë çështje duhet të konsultoni veprat e ilmihalit.

Ka lloje të ndryshme namazesh, të cilat kategorizohen si farz, vaxhib dhe nafile, duke u nisur nga dispozita e tyre dhe këta kryhen në kohë të caktuara.

Namazi ditor prej pesë kohësh dhe namazi i xhumasë janë namazet farz. Namazi i vitrit, namazet e Bajramit, namazet e zotuar dhe falja e namazeve nafile që janë prishur pasi kanë filluar, janë vaxhib. Namazi i xhumasë është namaz që falet një herë në javë, ndërsa namazet e Bajramit falen dy herë në javë.

Në mënyrë që namazi të jetë i vlefshëm, duhet të falet duke respektuar farzet, por edhe vaxhibet. Po ashtu, është e nevojshme të respektohen sunnetet dhe etika e tij, në mënyrë që të jenë të përsosura. Ndërsa në mënyrë që namazi të mos jetë i cunguar, duhet të shmangemi nga veprimet që prishin namazin.

Për ata që ndodhen në situata të veçanta, si për shembull të sëmurët, udhëtarët dhe personat me anomali, janë njohur disa lehtësi në çështjen e namazit.

Namazi i xhenazes, i cili është farz kifaje, është një namaz që falet pa ruku dhe pa sexhde.

Sexhdetë e sehvit janë të nevojshme për shkak të vonimit të njërit prej farzeve të namazit, harrimit, vonimit apo braktisjes së njërit prej vaxhibeve.

Ndërsa sexhdetë e tilavetit nevojiten për shkak të leximit ose dëgjimit të njërit prej aje-teve të sexhdesë që citohen në Kur'an.

Xhamia zë një vend mjaft të rëndësishëm në shoqërinë islame. Ajo ka një funksion shumë të rëndësishëm sidomos në aspekt të mundësimit të afrimitetit shoqëror, informimit të muslimanëve për problemet dhe shqetësimet e njëri-tjetrit dhe gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta. Prandaj në fenë islame namazi me xhemaat është urdhëruar me këmbëngulje.

Namazi është një adhurim që e largon njeriun nga veprimet negative, mundëson që ai të jetë person me moral të bukur dhe që mban gjallë vazhdimisht lidhjen e tij me Allahun.





Të rishikojmë kapitullin



1. Përse namazi është cilësuar si shtylla e fesë?
2. Cilat janë kushtet dhe pjesët përbërëse të namazit? Duke qenë se të dyja këto grupe përfshihen ndër farzet e namazit, ç'dallim ka mes kushteve dhe pjesëve përbërëse të tij?
3. Ç'dallim ka ndërmjet namazit të xhenazes dhe namazeve të tjera?
4. Çfarë nënkupton bashkimi i namazeve? Cilat namaze mund të bashkohen? A ka kushte bashkimi i namazeve? Si mund të shpjegohet bashkimi i namazeve kundrejt faljes së namazeve në kohën e tyre?
5. Cili është funksioni shoqëror i xhamive?
6. Çfarë përfiton njeriu nga namazi?



Pyetje vlerësuese



1. Cila nga alternativat e mëposhtme është sexhdeja e tilavetit?

- A) Sexhdja që kryhet për shkak të vonimit të njërit prej farzeve të namazit, ose braktisjes së njërit prej vaxhibeve a vonimit të tij.
- B) Sexhdeja që kryhet për shkak të leximit të njërit prej ajeteve të sexhdesë në Kur'an.
- C) Sexhdeja që kryhet vetëm për falënderim ndaj Allahut, pa pasur ndonjë shkak.
- D) Sexhdeja që kryen dikush që ka një nevojë ose një dëshirë, me qëllim që ta kërkojë këtë nga Allahu.

2. Cila është dispozita e kohës për namazin?

- A) Është ndër kushtet e namazit.
- B) Është ndër pjesët përbërëse të namazit.
- C) Është ndër vaxhibet.
- D) Është ndër sunnetet.

3. Sa është numri i ajeteve të sexhdesë në Kur'anin Famëlartë?

- A) 6666 B) 111 C) 33 D) 14

4. Sa rekate është namazi i xhenazes?

- A) Katër rekate.
- B) Dy rekate.
- C) Nuk ka rekat në namazin e xhenazes.
- D) Një rekat.

5. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është ndër farzet e namazit?

- A) Kijam.
- B) Këndimi i Fatihasë në çdo rekat të namazit.
- C) Koha.
- D) Sexhdeja.

adhuri m m

KAPITULLI


4





Agjërimi

1. Agjërimi dhe rëndësia e tij
2. Termat themelorë në lidhje me agjërimin
3. Llojet e agjërimin
4. Muaji i Ramazanit dhe agjërimi si farz
5. Nijeti dhe koha e agjërimin
6. Situatat në të cilat mosmbajtja e agjërimin është e lejuar
7. Situatat që prishin agjërimin
8. Shlyerja e agjërimin dhe situatat që nevojiten për të
9. Kazaja e agjërimin dhe situatat që nevojiten për të
10. Situatat që nuk e prishin agjërimin
11. Situatat që janë mekruh për agjëruetin
12. Çfarë përfiton njeriu nga adhurimi i agjërimin?



RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull:

- Trajtohen aspekte të ndryshme të adhurimit të agjërimit.
- Tregohet rëndësia e adhurimit të agjërimit.
- Shpjegohen disa terma që lidhen me agjërimin dhe Ramazanin, të tilla si: iftar, syfyr, imsak dhe mukabele.
- Përveç kësaj, jepen të dhëna edhe mbi dispozitat e jurisprudencës në lidhje me agjërimin, si dhe trajtohen përfitimet që ka njeriu nga adhurimi i agjërimit.

SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Pasi të keni lexuar këtë kapitull:

1. Do të përfitoni disa të dhëna themelore mbi çështjen e agjërimit.
2. Do të mund të kuptohet se cili është kuptimi i termave si syfyri, imsaku, iftari, fidja dhe sadakaja e fitres, të cilat i dëgjojmë shpeshherë në muajin e Ramazanit.
3. Do të përfitoni informacionet e nevojshme mbi dispozitat e jurisprudencës fetare në lidhje me agjërimin dhe do të mësoni justifikimet që e bëjnë të lejuar mosmbajtjen e agjërimit në muajin e Ramazanit, situatat që e prishin dhe që nuk e prishin agjërimin.
4. Do të mund të krijoni një mendim mbi çështjen e përfitimeve që ka njeriu prej agjërimit.

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

1. Mundohuni të studioni nga vepra të tjera të dhëna që lidhen me muajin e Ramazanit dhe adhurimin e agjërimit.
2. Studioni mbi marrëdhënien që ekziston ndërmjet muajit të Ramazanit dhe Kur'anit Famëlartë.
3. Analizoni ndikimet që ka agjërimi mbi shëndetin trupor dhe shpirtëror të njeriut.
4. Duke menduar mbi gjallërinë që sjell muaji i Ramazanit te shoqëritë muslimane, vlerësoni shkaqet e kësaj gjallërie.

1

Agjërimi dhe rëndësia e tij



Agjërimi, si njëri prej adhurimeve kryesore të Islamit, plotësohet me nijet dhe me qëndrimin larg të ngrënit e të pirit, si dhe larg marrëdhënieve seksuale, duke filluar që nga zbardhja e agimit e deri në perëndimin e diellit. Agjërimi është farz për çdo musliman që zotëron shëndet të plotë mendor dhe që ka arritur në moshën e adoleshencës. Në pikëpamje juridike fetare, për vlefshmërinë e agjërimit dhe strukturën e jashtme të tij nevojitet që të plotësohen kushtet e përmendura në këtë përkufizim. Mirëpo agjërimi nuk përbëhet vetëm nga qëndrimi larg të ngrënit, të pirit dhe kryerjes së marrëdhënieve seksuale.

Përmendja e agjërimit në Kur'anin Famëlartë si mjet i arritjes në devotshmëri, thekson qëllimin thelbësor të agjërimit. Ky qëllim është vetëdijesimi i individit ndaj përgjegjësisë kundrejt vetes, rrethit të afërt dhe të largët, rrethit social e natyror, si dhe ndaj Allahut. Agjërimi është urdhëruar që të jetë një mjet për të fituar këtë vetëdije. Në kuadër të këtij qëllimi, nëse merret parasysh se agjërimi i mbajtur do ta përçojë njeriun drejt qëllimit në fjalë, kuptohet më mirë rëndësia e adhurimit të agjërimit.

Ashtu si në adhurimet e tjera, edhe agjërimi plotësohet për shkak se është urdhër i Allahut. Megjithatë, personi mundohet të studiojë dhe të mësojë urtësitë e agjërimit. Si rrjedhojë, dijetarët që merren me studime dhe mendojnë mbi këto çështje kanë tre-guar për mjaft dobi të agjërimit në aspektin social, moral dhe shëndetësor.

Personi që mban agjërime fiton aftësinë e të qenit i durueshëm, e përballimit të vështirësive, rezistencës ndaj urisë dhe etjes, si dhe zotërimit ndaj dëshirave të nefsit. Po ashtu, percepton se në ç'kuptim vjen varfëria dhe të mospasurit; si rezultat i kësaj fiton ndjenja të tilla si dhembshuria, mëshira, ndihmesa ndaj të tjerëve dhe të qenit i dobishëm ndaj njerëzve; di vlerën e gjërave që zotëron, shmanget nga israfi (përdorimi pa kriter).

2

Koncepte themelore në lidhje me agjërimin



Syfyri

Ushqimi i natës, që hahet para kohës së imsakut dhe në kohën e fillimit të agjërimit, quhet syfyri. Në ajetin: “Dhe hani e pini derisa të dallohet fija e bardhë (bardhësia) e agimit nga fija e zezë (errësira e natës), pastaj plotësojeni agjërimin derisa të bjerë mbrëmja” (*Bakara, 2/187*) aludohet pikërisht mbi kohën e syfyrit.

H. Pejgamberi e ka nxitur ushqimin e syfyrit dhe ka thënë se në të ka begati. H. Pejgamberi (s.a.s.) ka urdhëruar: “Ngrihuni në syfyri, në syfyri ka bereqet” (*Muslim, Sijam, 45*).



Imsaku

Fjala imsak, e cila në fjalor shprehet me kuptimin ‘të mbash’, si koncept fetar do të thotë të qëndrosh larg veprimeve që prishin agjërimin, të tilla si të ngrënët, të pirët dhe kryerja e marrëdhënieve seksuale, duke filluar që nga mëngjesi kur nis të dalë agimi e deri në perëndimin e diellit. Koha e fillimit të agjërimit është fexhri sadik, pra, koha kur nis të zbardhë agimi. Ndërsa koha e përfundimit të tij është perëndimi i diellit.

Iftari

Iftari është i kundërti i syfyrit. Iftar do të thotë kryerje e njërit prej veprimeve që prishin agjërimin, duke filluar që nga mëngjesi, nisja e agimit e deri në perëndimin e diellit, por ka edhe kuptimin e mosmbajtjes së agjërimit. Në përdorimin e përditshëm fjala iftar nënkupton hapjen e agjërimit sipas metodës së duhur dhe në kohën e duhur nga personi përgjegjës.



Le të kujtojmë

H.z. Pejgamberi, pas hyrjes së kohës së iftarit, këshillon që hapja e iftarit nga agjëruesi të mos vonohet. Këndimi i duave gjatë hapjes së agjërimit është mustehab. H.z. Pejgamberi ka dhënë sihariqin se duatë e bëra gjatë iftarit do të pranohen dhe ai vetë ka bërë dua në trajtën: “Allahu im! Mbajta agjërim për pëlqimin tënd, hapa agjërimin me riskun që më dhe Ti, pranoje atë nga unë, sepse ti je dëgjues dhe ditës i çdo gjëje” (*Ibn Maxhe, Sijam, 48; Darekutni, II/185*).

78

Mukabele

Fjala mukabele vjen në kuptimin e krahasimit dhe të ballafaqimit. Në kulturën turke kjo fjalë përdoret për traditën që realizohet në trajtën e leximit të Kur’anit nga dikush dhe dëgjimin e tij nga të tjerët. Praktikisht, ai që lexon, e bën këtë përmendësh, ndërsa ata që dëgjojnë e ndjekin nga Kur’ani pjesën që këndon ai. Në këtë kontekst, edhe këndimi i Kur’anit në prani të xhemaatit quhet mukabele.



Të studiojmë – Të mësojmë

Studioni historinë e mukabelesë!

Këndimi dhe dëgjimi i Kur’anit me anë të mukabelesë ka mjaft dobi, të tilla si të nxisë të tjerët për të kënduar Kur’an, krijimin e një qetësie shpirtërore mbi atë që këndon dhe ata që dëgjojnë, si dhe përfitimin e sevapeve.

Fidje

‘Fidje’ ka kuptimin e një çmimi të paguar për të shpëtuar dikë nga një situatë e vështirë, ose nga një pengmarrje, ndërsa si term agjërimi, vjen në kuptimin e dhënies së parasë a diçkaje tjetër ndaj të varfërve në vend të agjëtimeve që nuk ka mbajtur, sigurisht nëse nuk ka shpresë për të bërë kaza agjërimin që nuk është mbajtur gjatë muajit të Ramazanit.

Fidja në lidhje me agjërimin është ofrimi nga dikush i ushqimit ose pagimi i këtij ushqimi ndaj një të varfëri, në këmbim të çdo dite që nuk ka mbajtur agjërim, apo që nuk arrin të mbajë agjërim për shkak të moshës së thyer ose të një sëmundjeje, për të cilën nuk ka shpresë shërimi. Në këtë pikë Kur’ani Famëlartë urdhëron: “Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, si shpagim duhet të ushqejnë nga një të varfër për çdo ditë agjërimi” (Bakara, 2/184).

Personat e sëmurë dhe që nuk mund të mbajnë agjërim, po ashtu edhe të moshuarit, si dhe të sëmurët që nuk kanë shpresë përmirësimi, japin fidje për çdo ditë të muajit të Ramazanit. Sasia e fidjes është sa sasia e fitres. Fidje mund të jepet në fillim të Ramazanit, por edhe gjatë ose në fund të muajit. Ata që do të japin fidje, mund t’ia japin atë krejtësisht një të varfri, por mund t’ua japin edhe të varfërve të ndryshëm. Personat që janë në këtë situatë, në rast se nuk kanë mundësi as të japin fidje, duhet të kërkojnë falje nga Allahu.

Fitre

Fitre, e cila përmendet shpesh edhe si sadakaja e fitrit, në një pikëpamje është sadakaja që jepet me rastin e Bajramit të Ramazanit. Kuptimi i saj është ai i sadakasë së krijimit. Në popull shprehet edhe si sadaka për kokë dhe jepet në formën e falënderimit.

Fitre është një sadaka që japin muslimanët, të cilët zotërojnë pasuri në sasinë e nisabit më shumë se nevojat e tyre themelore dhe që e japin në emër të personave, për kujdesin e të cilëve janë përgjegjës. Sasia e nisabit është shpjeguar gjerësisht në kapitullin e zekatit. Kjo sasi, për sadakanë e fitrit, do të thotë të zotërosh një kursim dhe pasuri në vlerën e më e pakta 80,18 gr flori, përveç nevojave themelore dhe borxheve.

Sadakanë e fitrit e japin edhe ata që nuk kanë mbajtur agjërim gjatë muajit të Ramazanit.

Koha kur do të jepet sadakaja e fitrit, pra koha në të cilën dhënia e saj nga personi është vaxhib, është pikërisht mëngjesi i Bajramit të Ramazanit. Si rrjedhojë, për personat që kanë ndërruar jetë para asaj dite, ose që kanë qenë të pasur, por ndërkohë kanë rënë në pozitën e të varfrit, sadakaja e fitrit nuk është vaxhib. Sipas këtij rregulli, personi i ngarkuar për kujdesin ndaj një fëmije që ka lindur para daljes së diellit të natës së Bajramit, në rast se është përgjegjës për dhënien e sadakasë së fitrit, është përgjegjës edhe për dhënien e fitrit të këtij fëmije.



Le të diskutojmë

Studioni dhe diskutoni në klasë nga veprat e ilmihalit mbi sadakanë e fitrit, kujt i jepet ajo dhe si i jepet.

Ndryshe nga nisabi i zekatit, në nisabin e sadakasë së fitrit, nuk është kusht që kursimet që zotëron personi jashtë nevojave themelore, të jenë në cilësinë e rentabilitetit real ose potencial dhe mbi këta kursime të ketë kaluar një vit.

Sasia që do të jepet për sadakanë e fitrit është ushqimi i përditshëm i një të varfri në një masë normale. Po ashtu, është e lejuar edhe dhënia e sadakasë së fitrit në kuadër të vlerës së saj. Më e virtytshme është të zgjidhet ajo që është edhe më e përshtatshme për interesin e të varfrit.

3

Llojet e agjërimit



Agjërimet ndahen në katër grupe: farz, vaxhib, nafile dhe mekruh. Le t'i trajtojmë shkurtimisht në vijim.

1. Agjërimet farz. Janë agjërimi i muajit Ramazan, kazaja e agjërimit të muajit Ramazan, të cilët nuk janë mbajtur për ndonjë arsye dhe agjërimet keffaret (agjërime të shlyerjes). Edhe agjërime farz dhe vaxhib ndahen në dy kategori: agjërime me kohë të caktuar dhe agjërime me kohë të pacaktuar. Sipas këtij klasifikimi, agjërimi i muajit të Ramazanit është një agjërim me kohë të caktuar. Ai duhet të mbahet në muajin e Ramazanit. Agjërime që do të mbahen si keffaret (shlyerje) për agjërime që i përkasin muajit të Ramazanit, dhe të cilët kanë mbetur kaza, janë farze me kohë të pacaktuar. Këta mund të mbahen në çdo kohë që dëshirohet dhe në ditët të cilat nuk janë mekruh.

2. Agjërime vaxhib. Kazaja e agjërimeve të zotuar dhe kazaja e agjërimeve nafile është vaxhib. Edhe agjërime vaxhib ndahen në dy kategori: në agjërime me kohë të caktuar dhe agjërime me kohë të pacaktuar. Sipas kësaj, një agjërim i zotuar për t'u mbajtur në një ditë të caktuar, është një vaxhib i caktuar. Cilëndo ditë të jetë shprehur zotim për mbajtjen e tij, atë ditë është vaxhib që të mbahet ai agjërim. Edhe agjërimi që është zotuar të mbahet, pa caktuar ndonjë kohë, është një agjërim me kohë të pacaktuar. Mbajtja e agjërimit mund të bëhet në çfarëdolloj kohe, me kusht që të mos jetë mekruh.

3. Agjërime nafile. Fjala 'nafile', në kontekstin e këtushëm nuk ka kuptimin si në gjuhën turke, në trajtën 'punë e kotë dhe e panevojshme'. Fjala 'nafile' këtu vjen me kuptimin e një veprimi të kryer me tepri, pra që është bërë si shtesë e diçkaje. Sipas kësaj, agjërime që mbahen për hir të Allahut, pa qenë në kategorinë farz dhe vaxhib, në përgjithësi trajtohen nën titullin 'Agjërime nafile'. Edhe agjërime të emërtuara si sunnet, mustehab, mendub dhe nafile janë pikërisht në këtë pozitë.



Të studiojmë – Të mësojmë

Studioni nga librat e ilmihalit mbi agjërime sunnet, mustehab, mendub dhe nafile!

Agjërimet mekruh. Agjërimet që do të mbahen në ditën e parë të Bajramit të Ramazanit dhe në katër ditët e Bajramit të Kurbanit janë tahrimen mekruh (mekruh pranë haramit). Sepse këto ditë, në pikëpamje të muslimanëve, janë ditë gëzimi dhe hareje. Mbajtja e agjërimit në këto ditë, për shkak se vjen në kuptimin e mosfestimit të bajrameve përkatëse, nuk është konsideruar si veprim i drejtë. Nga ana tjetër, të shmangemi nga gostia e ditëve të Bajramit, të cilat nënkuptojnë ditët e gostisë së Allahut ndaj robërve të tij, nuk është e drejtë.

Mirëpo ka edhe agjërimet që janë tenzihen mekruh (mekruh pranë hallallit), siç është mbajtja e agjërimit ditën e ashures dhe vetëm ditën e premtë ose vetëm ditën e shtunë, ose nisja e agjërimit tjetër pa hapur iftar në mbrëmjen e agjërimit të parë.

Në agjërimet nafile, në rastet kur personi është në moshë dhe gjendje të kryejë marrëdhënie seksuale me bashkëshortin/bashkëshorten, është një ndër ndjeshmëritë e adhurimit në Islam që të mbahet agjërimi pasi të jetë marrë miratimi i bashkëshortit/bashkëshortes, ndërsa në rastet kur personi punon kundrejt një pagese, të mbahet agjërimi pasi të jetë marrë leje nga punëdhënësi. Të vepros në kundërshtim me sa më sipër është mekruh.

4

Muaji i Ramazanit dhe agjërimi që është farz

Muaji i Ramazanit është muaji i agjërimit. Allahu i Lartmadhëruar na njofton në Kur'anin Famëlartë se Ramazani është muaji i agjërimit. Domosdoshmëria e mbajtjes së agjërimit në këtë muaj nga muslimanët është bërë e ditur me ajetin: "...Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë!.." (*Bakara, 2/185*).

Çdo musliman me mendje të shëndoshë dhe që ka arritur në moshën e pjekurisë, për sa kohë nuk ka një pengesë, mbajtja e agjërimit të Ramazanit nga ana e tij është farz. Mirëpo ata që janë të sëmurë, deri në atë shkallë sa të mos mund të mbajnë agjërim dhe ata që ndodhen në udhëtim, mund të mos mbajnë agjërim. Të sëmurët, pasi të shërohen bëjnë kaza agjërimet që nuk kanë bërë, ndërsa udhëtarët e bëjnë këtë pasi të kthehen në vendlindjen e tyre. Nëse për personin e sëmurë nuk ekziston mundësia të shërohet, ai jep fidje për çdo ditë që nuk mban agjërim; pra i jep ushqim një të varfri për çdo ditë. Gratë në gjendjen e hajdit (menstruacioneve) dhe nifasit (lehonisë) nuk mbajnë agjërim në këto ditë, por i plotësojnë të gjitha ditët e mbetura pa agjërim.

Personi që prish me qëllim dhe me dëshirë agjërimin e Ramazanit bën kaza agjërimin që ka prishur, po ashtu paguan edhe keffaret (shpërblesë). Keffareti i agjërimit është të mbahet agjërim për dy muaj me radhë, nëse nuk është e mundur kjo të japë ushqim për 60 të varfër.



"O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat" (*Bakara, 2/183*).

5

Nijeti dhe koha e agjërimit



Ashtu si në të gjitha adhurimet, edhe në rastin e agjërimit nijeti është kusht. Agjërimi nuk mbahet duke qëndruar pa ngrënë dhe pa pirë, ndërkohë kur nuk është shprehur nijet për agjërimit. Nga kjo pikëpamje, qoftë farz, vaxhib apo nafile, për të gjitha agjërime nevojitet të shprehet nijet.

Nijeti është një vendim i krijuar në mendjen e personit. Nëse personi merr një vendim dhe shpreh vendosmëri për ta realizuar atë që ka vendosur, atëherë konsiderohet se ka bërë nijet për atë punë. Po ashtu, konsiderohet si veprim i bukur që ky nijet të shprehet edhe me gjuhë.

Të ngrihemi në syfyr për agjërimit është një nijet. Mënyra më e përshtatshme në nijetin e agjërimit është që personi, i cili do të mbajë agjërimit, të shprehë nijet për agjërimitin para se ta nisë atë. Megjithëkëtë, dijetarët e Islamit e kanë përcaktuar më gjerësisht kohën e nijetit. Në përputhje me këtë, koha e nijetit për agjërimitin e Ramazanit, agjërimitin e zotimit me kohë të caktuar dhe agjërime nafile, vazhdon që nga perëndimi i diellit e deri në periudhën e paradites. Brenda kësaj kohe mund edhe të shprehet nijeti, por nuk mund të shprehet nijet para se të lindë dielli, ose në kohën kur dielli vjen pikërisht në zenit apo më pas deri në aksham. Shprehja e një nijeti të tillë deri në kohën kur dielli arrin në zenit ndodh në rast se nuk bëhet fjalë për një situatë që prish agjërimitin, siç është të ngrënë dhe të pirë.

Ngaqë çdo agjërimit i secilës prej ditëve të Ramazanit është më vete, bëhet nijet për çdo ditë të Ramazanit. Nuk mund të shprehim nijet të përgjithshëm në fillim të Ramazanit.

82

6

Situatat që e bëjnë të lejueshme mosmbajtjen e agjërimit



Mosmbajtja e agjërimit në Ramazan pa pasur asnjë justifikim konsiderohet si një ndër gjynahet e mëdha. Mirëpo ka disa justifikime që e bëjnë të lejueshme mosmbajtjen e agjërimit në Ramazan. Për shkak të këtyre justifikimeve, agjërimiti i Ramazanit mund të mos mbahet ose mund të prishet pasi të jetë nisur. Më të rëndësishmit e justifikimeve që bëjnë të lejueshme mosmbajtjen e agjërimit në Ramazan ose prishjen e tij pasi të ketë filluar janë si më poshtë:

- **Sëmundja.** Një musliman që shqetësohet se mos i shtohet sëmundja nëse mban agjërimit, ose i vonohet shërimi nga ajo sëmundje, nuk është i detyruar ta mbajë agjërimitin e Ramazanit. Më pas bën kaza në numër të ditëve që nuk ka mbajtur. Një musliman që ka dhënë fidje duke mos mbajtur agjërimitin për shkak të një sëmundjeje, shërimi i së cilës është i pashpresë, nëse më pas fiton forcën për të mbajtur agjërimit, bën kaza ditët që nuk ka mbajtur më parë. Fakti që më parë ka dhënë fidje për ditët që nuk ka mbajtur, nuk e shmang nga përgjegjësia.

- **Pleqëria.** Personat në moshë të thyer, të cilët për shkak të moshës nuk janë të aftë të mbajnë agjërim dhe janë në një situatë, në të cilën nuk mbajnë dot agjërim, mund të mos agjërojnë. Në vend të kësaj japin fidje në numër të ditëve që nuk kanë mbajtur agjërim. Kjo fidje mund të jepet në fillim të Ramazanit, por mund të jepet edhe më pas. Ajo mund t'i jepet një të varfri, por mund të shpërndahet edhe ndërmjet disa të varfërve.
- **Udhëtimi.** Një person që është nisur në një udhëtim gjatë Ramazanit dhe i cili fetarisht quhet sefer (udhëtar), nëse dëshiron mund të mos mbajë agjërim. Ditët që nuk ka mbajtur i bën më pas kaza secilën prej tyre. Mirëpo është më mirë që udhëtari, në rast se nuk do të krijojë shumë vështirësi tek ai, të mos e lërë agjërimin për kaza, por ta mbajë atë. Nëse do të ketë vështirësi ose ka ushqime të përbashkëta me shokët e tij, ndërkohë që ata nuk mbajnë agjërim, është më e virtytshme që të mos mbajë as ai agjërim.
- **Të jesh shtatzënë ose nënë që ushqen foshnjën me gji.** Gratë që janë shtatzënë ose që ushqejnë foshnjën me gji, në rast se mbajnë agjërim, kanë merakun se do të dëmtohen vetë ato ose fëmijët e tyre, prandaj mund të mos mbajnë agjërim për ta plotësuar atë më vonë në formën e kazasë.
- **Uria ose etja e tepërt.** Një person që agjëron, në rast se shqetësohet se për shkak të urisë ose etjes ndodhet në situatë të vështirë shëndetësore dhe i krijohen probleme fizike shëndetësore apo shpirtërore, mund të mos mbajë agjërim, ose mund ta prishë agjërimin që ka nisur. Më pas, në një kohë të përshtatshme, bën kaza agjërimin që nuk ka mbajtur.
- **Të bësh punë të rëndë.** Një musliman që punon në një punë të rëndë, si për shembull në minierë, të cilit nuk i njihet asnjë lehtësi për shkak të Ramazanit (për shembull, nëse e ka të detyrueshme pirjen e ujit për të punuar dhe në rast se e lë këtë punë nuk do të mund të gjejë punë tjetër, apo që ka probleme në përballimin e jetesës), ky person mund të mos mbajë agjërim. Agjërimin që nuk ka mbajtur e bën kaza më pas.
- **Femrat që janë me menstruacione dhe lehona nuk mbajnë agjërim.** Më pas bëjnë kaza aq ditë sa nuk kanë mbajtur agjërim.



Të studiojmë - Të mësojmë

Studioni situatat në të cilat mund të mos mbahet agjërim!

7


Situatat që prishin agjërimin

Prishja e agjërimit pa pasur një justifikim është gjynah. Është e domosdoshme që të bëhet kazaja e çdo lloj agjërimi të prishur. Përveç kësaj, për agjërimin e Ramazanit të prishur qëllimisht, si dënim nevojitet edhe keffaret. Të ngrënë dhe të pirët, kryerja e marrëdhënieve seksuale, konsumimi i duhanit ose i diçkaje të ngjashme qëllimisht gjatë Ramazanit, ndërkohë që personi është me agjërim, pa pasur një justifikim, ashtu siç nevojitet kazanë, nevojitet edhe keffaretin.

Në themel, mbajtja e agjërimit bazohet në parimin e shmangies ndaj të ngrënit e të pirit dhe kryerjes së marrëdhënies seksuale. Si rrjedhojë, kryerja e çdonjërit prej këtyre tri veprimeve e prish agjërimin.



Keffareti i agjërimit dhe situatat që kanë të nevojshëm keffaretin



Për prishjen e çfarëdolloj agjërimit tjetër, përveç atij të Ramazanit, nuk nevojitet keffaret, por vetëm kaza. Në mënyrë që të nevojitet edhe keffaret, si shtesë e kazasë, për shkak të prishjes së agjërimit të Ramazanit, duhet që agjërimit të jetë prishur pa pasur justifikim dhe të jenë kryer marrëdhënie seksuale, ose personi të ketë ngrënë apo pirë me vetëdije.

Keffareti (shlyerja) nuk është një rikuperim i mosmbajtjes së agjërimit, por i prishjes së agjërimit. Për këtë arsye ai që nuk mban agjërime në Ramazan dhe që nuk bën nijet për agjërime, nuk e ka të nevojshme keffaretin. Por, nëse një musliman nuk mban agjërime në

Ramazan pa pasur justifikim, ai ka kryer gjynah të madh. Për një person të tillë, nuk duhet keffaret si kompensim i prishjes së një agjërimit të filluar, por nevojitet të bëhet pendim, duke qenë se ka kryer një gjynah të madh, siç është mosmbajtja e agjërimit në muajin e Ramazanit.



Të studiojmë – Të mësojmë

Studioni veprat e ilmihalit për hollësi të tjera mbi keffaretin e agjërimit!



Kazaja e agjërimit dhe situatat e nevojshme për të

Qëllimi i agjërimit është që të bëhet e mundur arritja e rezultateve të pritura nga agjërimit, krahas mbajtjes së nefsit (unit) larg gjërave ndaj të cilave ndien dëshirë dhe oreks gjatë kohës që është përcaktuar për agjërime. Si rrjedhojë, për sa kohë nuk ndodh si shkak i harresës, situatat që prishin këtë ndalesë, prishin edhe agjërimin. Për shkak të këtyre nevojitet kaza. Në mënyrë që të nevojitet edhe keffareti, pra kundërshtpërblimi

ose shlyerja nevojitet që agjërimi të jetë prishur si në pikëpamjen formësore, ashtu edhe në atë kuptimore. Edhe kjo realizohet qoftë nga ngrënia dhe pirja e diçkaje me vetëdije, po ashtu edhe nga kryerja e marrëdhënieve seksuale.

Pra, këtu përfshihen veprime si të ngrënët dhe të pirët e diçkaje që nuk ka për qëllim të ushqyerit dhe që në kushte të zakonshme nuk është pjesë e gjërave që hahen dhe pihen, apo ndaj të cilave natyra njerëzore nuk ndien parapëlqime, ose të ngrënët formësisht apo kuptimisht të diçkaje, ose për shkak të veprimeve që nuk konsiderohen si marrëdhënie seksuale.



Të diskutojmë së bashku

Rendisni situatat, në të cilat është e nevojshme kazaja e agjërimit dhe flisni në klasë për këtë!

10

Situata që nuk prishin agjërimin

Ka mjaft situata që mund të renditen si të tilla që nuk e prishin agjërimin, por këtu synojmë disa raste, me të cilat njeriu haset shpesh dhe në lidhje me të cilat dyshon nëse i kanë prishur agjërimin apo jo. Disa prej këtyre situatave janë si më poshtë:

1. Të hash apo të pish diçka sepse ke harruar, kjo është diçka që nuk e prish agjërimin. E njëjta gjë vlen edhe për kryerjen e marrëdhënieve seksuale.
2. Të japësh gjak.
3. Të përtypësh pështymën e mbledhur në gojë.
4. Hyrja e pluhurit dhe tymit në fyt pa dëshirën e vetë personit.
5. Vonimi i të larit plotësisht për shkak të situatës së papastërtisë seksuale (xhunub) pas imsakut, ndërkohë kur është e domosdoshme që personi të lahet gjatë natës.



Të studiojmë – Të mësojmë

Diskutoni mbi situatat e tjera që prishin agjërimin!

11

Situatat që janë mekruh për agjëruenin!

Kryerja e disa veprimeve nga agjërueni, megjithëse nuk e prishin agjërimin, konsiderohen si mekruh. Disa prej këtyre veprimeve janë:

1. Shijimi i diçkaje me gjuhë, edhe pa e gëlltitur atë.
2. Mbledhja e pështymës në gojë dhe gëlltitja e saj.
3. Të përtypësh diçka që nuk shkrihet në gojë, së cilës nuk i ndihet shija, nuk ka ngjyrë apo aromë.

4. Të puthësh ose të përqafosh bashkëshortin/bashkëshorten me epsh – Nëse në këtë situatë bëhet fjalë për ejakulim, ose nëse personi gëlltit pështymën e bashkëshortit/bashkëshortes, agjërimi priset.
5. Kryerja e punëve të rënda gjatë Ramazanit. Punë të tilla janë konsideruar mekruh, sepse bëhen pengesë në plotësimin e farzit të agjërit ose plotësimit siç duhet të këtij farzi.

12

Çfarë përfiton njeriu nga adhurimi i agjërit?



Dobia më e rëndësishme e agjërit në aspektin individual është fakti se e mbron njeriun nga të këqijat. Agjërimi që parashikon Islami është agjërimi që mbahet me të gjithë ekzistencën dhe unin e personit. Së pari, agjërimi, duke e shtyrë njeriun drejt mirësisë dhe duke e larguar atë nga të gjitha të këqijat, bën që ky të mbrohet prej gjynaheve.

Ajeti Kur'anor në trajtën: "O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu siç u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqij" (*Bakara, 2/183*), shpjegon qëllimin kryesor në përcaktimin farz të agjërit. Ky qëllim është arritja e muslimanit në devotshmëri.

Agjëruesi, në saxe të agjërit, thyen zinxhirin e disa veseve që e kanë marrë peng dhe që i kanë ngurtësuar zemrën, nuk lejon që këto zakone ta shtyjnë atë drejt të këqijave dhe kështu përjeton lumturinë e përdorimit të vullnetit lirisht drejt së mirës dhe së bukurës. Kështu, agjërimi e mbron njeriun nga mendimet dhe orientimet që bien në kundërshtim me qëllimin e krijimit, pastron zemrën e tij nga të këqijat. Qasjet që kanë për synim vetëm kënaqësitë e kësaj bote janë qasje që e ulin njeriun më poshtë nga niveli njerëzor. Agjërimi, duke e mbajtur për një kohë të caktuar njeriun të privuar ndaj këtyre shijeve, i ofron atij mundësinë të kontrollojë veten dhe të mos e shohë botën vetëm në pikëpamje të kënaqësive materiale, por edhe në pikëpamje të kënaqësive shpirtërore.

Agjërimi i përfiton atij zakonin e mposhtjes së mllefrit dhe të dominimit ndaj nervave.

Agjërimi, duke u vënë fre dëshirave epshore, ndihmon që personi edhe në këtë fushë të zotërojë nefsën e tij. Kështu, ai kontribuon që të kalojë para të këqijave të mundshme që mund të kryhen në këtë rrugë, ndihmon që njeriu të ruajë nderin e tij.

Agjërimi e mëson njeriun të përballojë vështirësitë, të rezistojë ndaj problemeve që i shfaqen, zhvillon ndjenjën e durimit të njeriu, e pjek dhe e afirmojnë atë.

Njeriu e kupton më mirë vlerën e të mirave që ka pasi të jetë privuar prej tyre. Në këtë pikëpamje agjërimi na jep mësim të rëndësishme. Njeriu, duke mos përfituar gjatë kësaj kohe dobi prej të mirave që ka, kupton vlerën e këtyre mirësive. Në këtë mënyrë njeriu e di më mirë vlerën e mirësive të pafund që i ka dhënë Allahu dhe shpreh falënderim ndaj Tij. Kur e shohim nga ky aspekt, agjërimi ndikon në mënyrë domethënëse sa i përket aspektit të mirësive të njeriut. Në saxe të kësaj njeriu ndërgjegjësohet dhe i vlerëson më drejt mirësitë që i janë ofruar.

Njëri prej funksioneve më të rëndësishme të agjërimit është zhvillimi i ndjenjës së falënderimit ndaj Allahut të Lartmadhëruar, i cili i ka dhuruar mirësi atij. Njerëzit që zotërojnë këtë ndjenjë janë të vetëdijshëm për ndarjen e mirësive në mënyrën që ka urdhëruar Allahu.

Në saje të agjërimit njeriut i forcohen ndjenjat e dhembshurisë, i dhimbsen të varfrit, tregon keqardhje ndaj tyre, i ndihmon ata. Ndjenja e dhembshurisë te njeriu lind nga vuajtja. Njësoj siç personi që sëmuret kupton gjendjen e të sëmurëve, kështu edhe i urituri kupton gjendjen e të uriturit. Në këtë aspekt agjërimi zhvillon te njeriu ndjenjën e dhembshurisë dhe të mëshirës. Sepse ai që është i ngopur nuk kupton nga gjendja e të uriturit. Gjendjen e të uriturit e kupton ai që është i uritur.

Njeriu që agjëron gjatë gjithë ditës është në gjendje adhurimi. Njeriu ndien kënaqësi të madhe kundrejt kryerjes së adhurimit me përsëritshmëri ndaj Allahut të Lartmadhëruar. Ja pra, personi agjëruar e përjeton pa ndërprerje këtë kënaqësi, nga mëngjesi deri në mbrëmje. Kjo situatë mundëson që ai të lartësohet shpirtërisht. Kështu agjërimi e lartëson atë shpirtërisht dhe e përçon në pozitën e melekut.

Nga ana tjetër, lumturia që vjen nga fitimi i pëlqimit të Allahut është një dimension më i përparuar që agjërimi i përfiton botës së shpirtërore të njeriut.



“Ngrihuni në syfyr, sepse në syfyr ka bereqet” (*Buhari, Saum, 20*).

“Personi që i shtron iftar agjëruar, pa pasur mangësi në sevapin e agjëruar, merr sevap aq sa merr edhe agjëruar” (*Tirmidhi, Saum, 82; Ibn Maxhe, Sijam, 45*).

“Nëse dikush ha dhe pi, sepse ka harruar që po mban agjërim, le të plotësojë agjërimin, mos ta prishë atë. Sepse atë e ka ushqyer Allahu” (*Buhari, Saum, 7*).



Le të kujtojmë

- Agjërimi e mbron njeriun nga të këqijat.
- Agjërimi e mbron njeriun nga mendimet dhe qasjet që bien ndesh me qëllimin e krijimit.
- Agjërimi e pajis individin me aftësinë e përballimit të nefsit.
- Agjërimi e mëson njeriun të rezistojë ndaj vështirësive.
- Agjërimi i mundëson njeriut zakonin e mposhtjes së zemërimit.
- Agjërimi është një edukim durimi.
- Agjërimi mundëson që njeriu të njohë më mirë vlerën e mirësive që ka.
- Agjërimi forcon ndjenjën e dhembshurisë te njerëzit.
- Agjërime e lartëson njeriun shpirtërisht.





Të rishikojmë kapitullin



1. Ç'do të thotë syfyr, a mund të mbajmë agjërim pa ngrënë syfyr?
2. Ç'do të thotë imsak, kur është koha e imsakut?
3. Ç'do të thotë mukabele?
4. Ç'do të thotë fidje, ç'është sadakaja e fitrit?
5. Cilat janë justifikimet që e bëjnë të lejuar mosmbajtjen e agjërimit?
6. Cili është kuptimi i togfjalëshit keffareti i agjërimit?



Pyetje vlerësuese



1. Cila nga situatat e mëposhtme nuk është një ndër situatat e anomalisë, e cila jep lejimitet për mosmbajtjen e agjërimit në Ramazan?

- A) Të jesh shtatzënë ose që ushqen foshnjën me gji.
- B) Të punosh në një punë aq të rëndë sa të mos mund të rezistosh ndaj mbajtjes së agjërimit.
- C) Të jesh duke bërë itikaf.
- D) Të jesh i sëmurë dhe kur mbajtja e agjërimit vonon shërimin e sëmundjes.

2. Cilin prej veprimeve të mëposhtme duhet të bëjë një person i moshuar, që nuk ka mundësi të mbajë Ramazan?

- A) Nëse ka mundësi, të japë fidje për çdo ditë agjërimit që nuk ka mbajtur.
- B) Nuk duhet të japë fidje, sepse gjithsesi nuk është në gjendje të agjërojë.
- C) Duhet të gjejë një zëvendës dhe të mundësojë që të mbajë agjërimit në vend të tij.
- D) Në çështjen e agjërimit nuk ka asnjë përgjegjësi fetare.

3. Cilin nga veprimet e mëposhtme duhet të bëjë një person që ha dhe pi diçka ngaqë ka harruar se po agjëron?

- A) Duhet ta bëjë kaza atë agjërimit.
- B) Duhet të ndërpresë të ngrënët dhe të pirët e të vazhdojë agjërimit. Si rrjedhojë nuk nevojitet kaza.
- C) Nëse agjërimit që mban është agjërimit i Ramazanit, duhet ta bëjë kaza atë. Nëse mban agjërimit nafile nuk duhet të bëjë kaza.
- D) Duhet të japë fidje në vend të asaj dite.

4. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është njëra prej veprimeve mustehab për agjëruesin?

- A) Të ngriheni në syfyr dhe të vononi syfyrin deri në kohën e imsakut.
- B) Mos të vononi iftarin.
- C) Të këndonit dua gjatë hapjes së iftarit.
- D) Të heshtni ndërsa mbani agjërimit.

5. Cilin nga veprimet e mëposhtme duhet të bëjë personi që çel iftar, i cili supozon se dielli ka perënduar, por që në fakt nuk ka perënduar ende?

- A) Për këtë arsye edhe i nevojitet të bëjë kaza atë agjërimit, por edhe keffaret.
- B) E bën kaza atë agjërimit.
- C) Nuk është i detyruar të bëjë asgjë. Ka çelur iftar duke supozuar se dielli ka perënduar. Në këtë nuk ka asgjë të qëllimshme.
- D) Pagan fidjen e atij agjërimit.



adhurimi im



KAPITULLI

5





Ndarja dhe solidariteti në Islam Zekati dhe sadakaja

1. Ndjenja e ndihmesës dhe e solidaritetit të njeriu
2. Rëndësia që Islami i kushton ndihmesës dhe solidaritetit
3. Sadakaja
4. Zekati si adhurim i ndihmesës dhe solidaritetit
5. Konceptet themelore në lidhje me zekatin
6. Personat që duhet të japin zekat
7. Personat që duhet t'u jepet zekat
8. Mallrat nga të cilat duhet të jepet zekat
9. Çfarë përfiton njeriu nga adhurimi i zekatit?
10. Çfarë përfiton shoqëria nga adhurimi i zekatit?
11. Ndarja e gëzimeve
12. Ndarja e hidhërimeve
13. Institucionet e ndihmesës dhe solidaritetit në traditën turko-islame

RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull:

- Trajtohet zekati, si më i rëndësishmi i adhurimeve financiare në fenë islame dhe sadakaja që përfshin edhe zekatin.
- Krahës atyre që zekati i përfiton njeriut dhe shoqërisë, jepen të dhëna në lidhje me zekatin në aspektin e jurisprudencës fetare.
- Duke u nisur nga fakti se zekati dhe sadakaja janë veprime që zhvillojnë vetëdijen e ndihmesës në fenë islame dhe në formë konkrete, trajtohen çështjet e ndarjes dhe solidaritetit.
- Sa i përket ndihmës ndaj të tjerëve, ndarja e mirësive dhe gëzimeve që ka dhënë Allahu është po aq e rëndësishme sa ndarja e hidhërimeve. Për këtë arsye trajtohen edhe çështje që kanë të bëjnë me ndarjen e hidhërimeve, siç është vizita e të sëmurit.
- Edhe sa i përket ndarjes së gëzimeve, trajtohen bajramet, ashtu edhe ditët dhe netët e mira.

SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Pasi të jetë trajtuar ky kapitull:

1. Do të përfitoni disa të dhëna themelore mbi çështjen e zekatit dhe sadakasë.
2. Do të kuptoni domethënien e termave që përdoren shpesh si një pjesë e pandashme në jetën shoqërore të muslimanëve, të tillë si sadaka, nisab, fidje e fitre. Po ashtu do të kuptoni edhe dallimin ndërmjet tyre.
3. Do të mësoni se për kë është farz zekati, nga cilat mallra dhe në ç'normë duhet të jepet zekat.
4. Do të mund të perceptohen më mirë përmasat e rëndësisë që feja islame i jep ndihmesës.
5. Do të merrni informacione të shkurtra në lidhje me bajramet fetare, ditët dhe netët e shenjta në kuadër të ndarjes së gëzimeve.
6. Edhe në kuadër të ndarjes së vështirësive, do të përfitoni të dhëna në lidhje me disa detyra fetare, të tilla si vizita e të sëmurit dhe detyrat ndaj xhenazës.

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

1. Kur flitet për zekatin është mirë të konsultoheni me ata që kanë dhënë zekat, të cilët janë nga të afërmit dhe të njohurit tuaj.
2. Nëse vetë ju nuk jepni sadaka fitri, bisedoni me familjen tuaj nëse deri tani është dhënë sadaka fitri për ju apo jo.
3. Mundohuni të merrni informacione në lidhje me ajetet kundrejt ndihmesës së drejtpërdrejtë në Kur'an, të tilla si zekati, sadakaja dhe infaku. Po ashtu, mundohuni të kuptoni përse fokusohet kaq shumë Kur'ani te çështja e ndarjes.
4. Mundohuni të merrni të dhëna në lidhje me solidaritetin shoqëror dhe institucionet e solidaritetit të formuar rreth muslimanëve në historinë islame.
5. Do të mësoni të dhëna në lidhje me marrëveshjen vëllazërore të realizuar mes ensarëve dhe muhaxhirëve pasi Pejgamberi bëri hixhret nga Meka drejt Medines.

1

Ndjenja e ndihmesës dhe e solidaritetit te njeriu



Njëra prej veçorive që zotëron njeriu prej krijimit të tij është ndjenja e solidaritetit dhe e ndarjes së asaj që ka me të tjerët. Kjo ndjenjë duhet të vihet në funksion dhe të mundësohet zhvillimi i saj. Siç shihet, zekati ka funksionin e nxjerrjes në pah të kësaj ndjenje, e cila ekziston prej kur njeriu krijohet; zekati e vë në funksion dhe e zhvillon atë, e thënë ndryshe zotëron një funksion sipas të cilit nuk e verbon këtë ndjenjë. Ndoshta funksioni më i rëndësishëm i zekatit është të parandalojë dobësimin dhe zhdukjen e ngadaltë të ndjenjës së ndihmesës dhe solidaritetit që ekziston te njeriu, nga ndikime të tilla si egoizmi, i cili edhe ky gjendet te njeriu që në krijim, si dhe ta pajisë njeriun me vetëdijen e infakut, pra veçorinë e ndarjes së asaj që ka me të tjerët. Në vend të instinktit për të marrë dhe fituar në mënyrë të vazhdueshme, instinkt ky që buron nga egoizmi, forcimi i vetëdijes për të ndarë atë që ke është diçka shumë më e rëndësishme dhe pozitive për njerëzimin. Themeli i solidaritetit dhe ndihmesës bazohet në këtë qasje dhe konceptim. Zekati, jo vetëm që zhvillon këtë konceptim, por njëkohësisht e shndërron atë në një formë institucionale. Ky konceptim që mund të merret si një mënyrë për të krijuar vetëdijen e ndarjes me persona nevojtarë të një pjese nga ajo që ka dhuruar Allahu, formon themelin e solidaritetit shoqëror dhe të ndihmesës në Islam.

Të qenët e zekatit një përgjegjësi fetare bëhet shkak që ndihma të jepet në mënyrë vullnetare, pra, me dëshirë. Të bësh diçka me dëshirë dhe vullnetarisht bëhet shkak që ndihmesa të shndërrohet në një aftësi te njeriu. Tashmë, të japë zekat shndërrohet në kënaqësi për njeriun që e jep.

Dhënia apo ndarja e asaj që ke, e cila nxitet thuajse në çdo sure të Kur'anit me emra si zekat, infak, sadaka apo emra të tjerë të ngjashëm, nëse mund të vihet në funksionim në kuptimin e vërtetë, bëhet shkak për forcimin e solidaritetit dhe të ndihmesës.

2

Rëndësia që Islami i kushton ndihmesës dhe solidaritetit



Njëri prej kriterëve mbi të cilët përqendrohet dhe nxit më shumë Kur'ani është ndarja e riskut që Allahu u ka dhënë robërve.

Brezi i parë i Islamit që u formua nën edukimin e Pejgamberit, sahabet, kanë dhënë shembujt më të bukur të ndihmesës dhe solidaritetit. Kur'ani Famëlartë e lëvdon ndihmesën e tyre.

Brezat e mëpastajmë të muslimanëve kanë mbajtur gjallë për shekuj të tërë shpirtin e ndihmesës që ka injektuar Kur'ani. Kjo qasje është bërë shkak për themelimin e mjaft institucioneve të bamirësisë në kuptimin shoqëror. Fondacionet janë shembulli më i bukur i kësaj.



Rëndësia që Islami i kushton ndihmesës dhe solidaritetit nuk përbëhet vetëm nga një thënie e thjeshtë. Shembulli më i bukur i kësaj është solidariteti dhe ndihmesa reciproke vëllazërore mes muhaxhirëve që kanë migruar nga Meka në Medine dhe muslimanëve medinas. Kjo ndihmesë dhe ky solidaritet janë një shembull sakrifice e ndihme të paparë në histori. Sahabet medinas, vetëm për shkak të besimeve të tyre, ndanë gjithë çfarë zotëronin me vëllezërit mekas, të cilët patën lënë çdo gjë dhe qenë detyruar ta braktisin Mekën. Për këtë arsye, sahabet medinas u njohën me emrin 'Ensar' (ndihmues). Kjo ndihmë vullnetare nuk u realizua për shkak se sahabet medinas, pra ensarët ishin shumë të pasur, por ngaqë me shprehjen e Kur'anit përzgjedhën vëllezërit në vend të tyre. Themeli i kësaj qasjeje nuk bazohet te sasia e mallit që ke, por te sasia e besimit që ke në zemër. Thelbin e kësaj qasjeje të ndihmesës dhe solidaritetit të Islamit mund ta shohim në mënyrë konkrete në këtë praktikë.

Në mjaft ajete në Kur'anin Famëlartë urdhërohet ndihmesa dhe ndarja e asaj që zotërohet. Madje, në kuadër të ndarjes së asaj që ke, Allahu Famëlartë vlerëson edhe thënien e fjalëve të bukura, me qëllim që të fitohet zemra e atyre që janë nevojtarë dhe që nuk kanë gjë për të dhënë.

Njëri prej kapitujve, në të cilin përfshihet në formë të theksuar ky urdhër, është sureja Isra. Ajetet që urdhërojnë dhe këshillojnë ndihmesën në këtë sure, theksojnë edhe disa kriterë në çështjen e moralit të ndihmesës dhe të ndarjes. Këto kriterë mund të përmbledhen si në vijim: të mbash gjithmonë në mendje se është pikërisht Allahu ai që është dhënësi, të ndihmosh të afërmit, të jesh i ekuilibruar gjatë harxhimit, të mos shpërdorosh pa kriter, të japësh ndaj atyre që janë të varfër, ndaj nevojtarëve dhe atyre që kanë mbetur në rrugë, por që nuk mund të kërkojnë. Të gjitha këto parashatrojnë strategjinë e ndihmesës së ekuilibruar.



“Faleni namazin ashtu siç duhet, jepni zekatin. Çfarëdo mirësie të keni kryer për veten, atë do ta gjeni pranë Allahut. Pa dyshim Allahu i sheh të gjitha bëmat tuaja” (*shih Isra, 17/28*).

3

Sadaka



Në thelb të konceptit sadaka, i cili në popull, në përgjithësi përdoret në kuptimin e dhënies së ndihmesës ndaj të varfërve dhe nevojtarëve, shprehjen e mirësisë ndaj tyre, me qëllim fitimin e pëlqimit të Allahut, në të vërtetë qëndron një kuptim shumë më i gjerë se ky. Vetë sadakaja ndahet në disa kategori: farz, vaxhib dhe nafile.

Sadakaja që është farz, në thelb është zekati. Mirëpo mund të formohen situata të tilla në të cilat harxhimi i pasurisë nga muslimani vjen në trajtën e farzit. Në rast se shpëtimi i jetës së një njeriu varet nga harxhimi i asaj pasurie, në këtë rast ky veprim vjen në trajtën e farzit dhe ky është një shembull në këtë pikë. Ndërsa sadakaja e fitrit është sadaka vaxhib.

Sadakatë jashtë sadakave farz dhe vaxhib përmenden nën emrin 'Nafile'. Këtu fjala nafile nuk nënkupton veprimin e panevojshëm dhe të padobishëm, si sadaka që kryhet në formën e shtesës nga sadakatë farz dhe vaxhib dhe që përfiton sevap.



“Lëmosha e zekatit është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për ata që janë ngarkuar me mbledhjen dhe administrimin e tij, për lirim të skllëvërve, për të rënduarit nga borxhet, për (luftëtarët në) rrugën e Allahut dhe për udhëtarët e mbetur rrugëve. Këto janë detyrat e vëna prej Allahut” (*Teube, 9/60*).

Zekati që është farz dhe fitre që është vaxhib, janë sadaka me sasi të caktuara. Në të parën është e nevojshme që të kalojë një vit pasi të jetë arritur niveli i nisabit, ndërsa në të dytën është kusht i mjaftueshëm që të zotërohet sasia e nisabit. Përveç këtyre, sasia e sadakasë që realizohet në formën e ndihmesës ndaj një muslimani në vështirësi, në masën që të mund të përballohet nevoja e tij, është në normën e nevojës minimale.

E shpjeguar kështu nënkupton një kuptim të gjerë të sadakasë, por ajo nuk duhet të supozohet se ka lidhje vetëm me ndihmën materiale. Sadakaja, në kuptimin e gjerë, përfshin çdo veprim të mirë dhe mirësi të kryer. Sipas kësaj, çdo mirësi dhe ndihmesë që personi realizon qoftë për njerëzit, për kafshët apo për natyrën dhe rrethin shoqëror, mund të vlerësohet në përfshirje të konceptit të sadakasë. Në një hadith të Pejgamberit thuhet se edhe të jesh buzagaz ndaj njerëzve është sadaka.

Sadakaja e pajis njeriun me vetëdijen se mundësitë që ka në dorë janë falur nga Allahu. Një person i tillë fiton virtytin e dhënies dhe ndihmesës ndaj atyre që kanë nevojë, për shkak të mirësisë që i ka falur Allahu. Ai i sheh si pjesëtarët e së njëjtës familje njerëzit me të cilët jeton, por që nuk kanë arritur në mirësi ashtu si ai dhe beson se duhet të zhvillojë ndjenjën e solidaritetit. Pikërisht me këtë ndjenjë njeriu pastrohet nga egoizmi dhe kopraccia, me këtë ndjenjë mbushet plot për plot me dëshirën për të kryer mirësi. Jeta në një shoqëri, në të cilën konceptimi i sadakasë tek individët është i zhvilluar, nuk shndërrohet në një fushë padrejtësie, por në një mundësi solidariteti dhe bashkëpunimi.



“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, melekët, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirim të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte” (*Bakara, 2/177*).



Le të kujtojmë

Disa sadaka janë sevap për njeriun edhe pasi ky të ketë ndërruar jetë. Këta quhen ‘sadakatu’l-xharije’ dhe nënkuptojnë sadakanë që vazhdon pa ndërprerje, pra, mirësinë rrjedhëse.

Në një hadith, veprat që janë burim për sevap të vazhdueshëm përcaktohen si më poshtë:

“Kur biri i Ademit ndërron jetë, mbyllet defteri i veprave. Tri prej këtyre janë përjashtim. Ata që shprehin sadaka të pandërprerë (sadakatu’l-xharije), ata që i lënë shoqërisë një dije të dobishme (nxënës/vepër) dhe ata që edukojnë fëmijë, të cilët bëjnë dua të hairit për të” (*Muslim, Uasijje, 14; Ebu Dau’ud, Uesaja, 14; Tirmidhi, Ahkam, 36*).



Të diskutojmë së bashku

- Flisni në lidhje me sadakatu'l-xharijen duke dhënë edhe shembuj të tjerë që hyjnë në përfshirjen e tij.
- Ç'janë gurët e sadakasë? Diskutoni në klasë!



Të komentojmë

Nëse ke vajtur pranë një të sëmuri,
nëse i ke ofruar qoftë edhe një gllënjë ujë,
nesër në ahiret do të marrësh aq shpërblese,
ashtu sikur ke pirë sharabin e Krijuesit për besë.

Yunus EMRE

Komentoni vargjet e sipërme të Junusit!



Le të diskutojmë

“Çdo vepër legjitime dhe e bukur është sadaka” (*Buhari, Edeb, 33; Muslim, Zekat, 53*).

“Të vdekurin e ndjekin tri gjëra deri në varr: fëmijët, pasuria dhe malli i tij. Dy prej këtyre kthehen, njëri mbetet. Fëmijët-familja dhe pasuria kthehen, ndërsa veprat e tij mbeten (bashkë me të)” (*Buhari, Rikak, 42; Muslim, Zuhd, 5*).

“Mos përçmo as edhe një mirësi, mirëpriti të gjithë besimtarët buza-gaz!” (*Muslim, Bir, 144*).

“Nëse një musliman mbjell një pemë dhe nga ajo hanë njerëzit, kafshët ose zogjtë, pjesa e ngrënë bëhet sadaka për muslimanin deri në kiamet” (*Muslim, Musakat, 10*).

“Nëse një burrë përballon nevojat e jetesës së familjes duke shpresuar në pëlqimin e Allahut, ato që harxhon bëhen sadaka për të” (*Buhari, Iman, 41, Megazi, 12, Nefekat, 1; Muslim, Zekat, 49. Përveç kësaj shihni edhe Nesai, Zekat, 60*).

“Dora që merr është më e hairit se ajo që jep. Nis të ndihmosh kryesisht nga personat, përgjegjësinë e të cilëve e ke mbi vetë! Më e hairit nga sadakatë është ajo që jepet prej tepricës nga nevoja e personit. Kushdo që nuk kërkon diçka nga njerëzit, Allahu nuk e bën nevojtar atë. Ndërsa kushdo që është i nginjur, Allahu e bën të pasur atë” (*Buhari, Zekat, 18, Nefekat, 2; Muslim, Zekat, 94-97, 106, 124*).

“Dhënia e sadakasë nuk e pakëson pasurinë. Sa më shumë robi të falë gabimet e të tjerëve, edhe Allahu shton nderin e tij. Kushdo që sillet me modesti për hir të Allahut, edhe Allahu e lartëson atë” (*Muslim, Bir, 69*).

Diskutoni mbi rëndësinë e sadakasë duke u nisur nga hadithet e mësipërme!

4

Zekati si adhurim ndihmese dhe solidariteti



Zekati është përcaktuar si farz gjatë muajit të dytë të hixhretit. Ajetet në Kur'anin Famëlartë në kuptimin: "Falen i namazin, jepen i zekatin..." (*Bakara, 2/43, 110; Haxh, 22/78; Nur, 24/56; Muxhadele, 58/13; Muzemmil, 73/2*) janë argumente që tregojnë se zekati është farz.

Feja islame e ka tërësuar ndihmesën me besimin, ndërsa dhënien e zekatit e ka sjellë në trajtën e njërit prej kushteve themelore të Islamit.

Feja islame e ka tërësuar besimin me ndihmesën dhe dhënien e zekatit e ka përcaktuar ndër kushtet më themelore të Islamit.

Sipas Islamit, pronari i vërtetë i pasurisë që zotëron njeriu është Allahu. Nga kjo pasuri që Allahu ia ka dhënë si amanet duhet t'u japë edhe të tjerëve. Në mjaft ajete shprehet hapur ky kriter (*Nur, 24/33*). Në Kur'an, ndërkohë që jepen veçoritë e besimtarëve të devotshëm, të cilët janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë ndaj Allahut, në mes tyre përmendet sidomos infaku (ndarja e asaj që zotërohet me të tjerët) (*Bakara, 2/2-3*). Fakti që në Kur'anin Famëlartë bëhet e ditur që në mallrat e muslimanëve të pasur gjenden të drejtat e të varfërve (*Dharijat, 51/19; Mearixh, 70/24-25*), tregon se ndihmesa e të pasurve ndaj të varfërve nuk është një mirësi, por përkundrazi është një borxh dhe përgjegjësi njerëzore.

Zekati nënkupton dhënien ndaj muslimanëve të varfër të një sasi të caktuar çdo vit prej pasurisë së muslimanit përgjegjës dhe që konsiderohet i pasur fetarisht.

Islami nuk e ka lënë ndihmesën në dëshirën e personit, por e ka bërë të detyrueshme që të gjithë ata që janë të pasur të japin zekat, duke qenë se zekati është e drejta e të varfërve që kanë në pasurinë e të pasurve, e cila u është dhuruar nga Allahu.

Zekati ka mjaft dobi në lidhje me botën e këtushme dhe me ahiretin. Në botë fal besim, begati, bereqet dhe qetësi, ndërsa në ahiret fal xhennet.

Ajeti Kur'anor në trajtën: "Merr nga pasuria e tyre lëmoshë, me të cilën t'i pastrosh ata dhe t'ua rrisësh veprat e mira! Lutu për ta, sepse lutja jote është vërtet qetësim për ata. Allahu dëgjon dhe di gjithçka" (*Teube, 9/103*), ky ajet pra, tregon përfitimet e atyre që japin zekatin, ndërsa ajeti në kuptimin: "O besimtarë! Në të vërtetë, shumë priftërinj dhe murgj përllajne pasurinë e njerëzve pa të drejtë dhe i largojnë ata nga rruga e Allahut. Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm" (*Teube, 9/34*), tregon dhe shpreh humbjet e atyre që nuk japin zekat.





Le të diskutojmë

Diskutoni në klasë se çfarë kuptoni me begatim të pasurisë, nga e cila jepet zekat!

5

Koncepte themelore në lidhje me zekatin



Me qëllim që të kuptojmë më mirë zekatin është e domosdoshme të dimë disa terma themelorë që lidhen me të. Le të shohim më poshtë disa prej tyre që janë më të rëndësishëm:

Nisab

Fjala nisab, e cila në fjalor jepet me kuptimin e thelbit të çdo gjëje, rrënjës, sasisë mesatare dhe traditës, si koncept është një normë pasurie e vënë për adhurime të tilla si zekati, sadakaja e fitres dhe kurbanit. Nisabi mund të quhet edhe si kufiri minimal i të qenit të pasur ose kriteri i pasurisë minimale. Personi që zotëron kursime financiare mbi borxhin dhe nevojat themelore fetarisht, konsiderohet si njeri i pasur.

Për shkak se kanë tejkaluar kufirin e varfërisë në aspektin fetar, pra nuk kanë rënë nën kufirin e të konsideruarit të pasur fetarisht, personat që zotërojnë pasuri në sasinë e nisabit, nuk është e lejuar që të marrin zekat dhe sadaka. Personat që gjenden në këtë pozitë, në rast se bartin edhe kushtet e tjera, në Bajramin e Kurbanit, është vaxhib që të presin kurban, por edhe të japin sadakanë e fitrit në Bajramin e Ramazanit.

Nisabi, duke qenë kufiri minimal i pranimit si i pasur fetarisht, është përcaktuar nga Hz. Pejgamberi në kushtet e asaj periudhe. Ky kufi minimal, në një pikëpamje tregon edhe standardin e jetesës mesatare të shoqërisë islame të asaj periudhe dhe kriterin e pasurisë. Mallrat që përdoren në përcaktimin e sasisë së nisabit mund të thuhet se janë mjete pasurie ndër më të përhapurat në atë kohë. Përcaktimi i nisabit mbi këto mallra është ruajtur në të njëjtën mënyrë edhe në periudhat në vijim, në të cilat kushtet sociale dhe ekonomike nuk kishin ndryshuar shumë (*Shih Ilmihal, II/5*).



Le të kujtojmë

Nisabi është një normë e vendosur për përgjegjësinë e zekatit. Si rrjedhojë, personi që ka pasuri ose para, përveç borxhit dhe nevojave themelore fetarisht, konsiderohet si i pasur. Pasi mbi këtë pasuri të ketë kaluar një vit, personi bëhet përgjegjës për dhënien e zekatit. Personat, mallrat ose paraja e të cilëve nuk ka arritur në sasinë e nisabit, apo që kanë pasuri në sasinë e nisabit, por që mbi të cilën nuk ka kaluar një vit i plotë hënor, nuk janë përgjegjës në dhënien e zekatit.

Hauaixhi aslije (Nevojat themelore)

Termi 'Hauaixhi aslije' do të thotë 'Nevoja themelore'. Hauaixhi aslije si term nënkupton shpenzimet e nevojave themelore që mbeten pasi është llogaritur nisabi, i cili pranohet si kriter pasurie minimale gjatë përcaktimit të përgjegjësisë së zekatit, sadakasë së fitrit dhe kurbanit.

Këto shpenzime janë shtëpia, mjeti i transportit, ushqimet dhe veshjet vjetore të vetë personit dhe të atyre për të cilët është përgjegjës për t'u kujdesur, sendet e nevojshme shtëpiake, librat personale, mjetet e ndryshme profesionale dhe gjërat e tjera që përfshihen te të mirat materiale të nevojshme për të jetuar.



Nevojat themelore mund të tregojnë ndryshueshmëri sipas kohës, mjedisit dhe kushteve ku jetohet. Për shembull, për personat që bëjnë një jetë nomade, shtëpia nuk është një nevojë themelore, por, nga ana tjetër, personat që kanë një jetë sistematike e të vendosur diku, të pasurit e një shtëpie është një nevojë e detyrueshme. Sipas kësaj logjike, ajo që do të merret parasysh kur flitet për nevojat themelore është sasia që do të përballojë shpenzimet e detyrueshme, të tilla si të ngrënët, të pirët, veshja, strehimi dhe arsimi ndaj vetes e personave për të cilët është i detyruar të kujdeset. Pra, kur llogaritet nisabi i zekatit, i

sadakasë së fitrit dhe i kurbanit, kjo sasi nuk është marrë parasysh, sepse sasia e nevojave themelore është sasia e detyrueshme që i nevojitet një individ për të jetuar.



Personat që duhet të japin zekat



Personat që janë përgjegjës për dhënien e zekatit, janë persona me mendje e gjykim të shëndoshë, që kanë arritur në moshën e pjekurisë dhe që zotërojnë kursime materiale në sasi sa të konsiderohen të pasur fetarisht. Për sa më sipër, cilësitë që duhet të gjen-den te personi përgjegjës për dhënien e zekatit janë si më poshtë:

1. Të jesh musliman.
2. Të kesh arritur në moshën e pjekurisë.
3. Të jesh me mendje të shëndoshë.

4. Të mos jesh borxhli.

Ata që nuk janë muslimanë, fëmijët që nuk kanë arritur në moshën e pjekurisë, si dhe personat me shëndet jo të plotë mendor nuk janë përgjegjës për dhënien e zekatit. Edhe ata që, megjithëse zotërojnë pasuri në sasinë e nisabit ose më shumë se kaq, nëse këtë kursim e kanë si këmbim i borxheve të tyre, nuk janë përgjegjës për dhënien e zekatit.

7

Personat ndaj të cilëve mund të jepet zekat



“Lëmosha e zekatit është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për ata që janë ngarkuar me mbledhjen dhe administrimin e tij, për lirim të skllervëve, për të rënduarit nga borxhet, për (luftëtarët në) rrugën e Allahut dhe për udhëtarët e mbetur rrugëve. Këto janë detyrat e vëna prej Allahut. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë” (*Teube, 9/60*).

Personat ndaj të cilëve jepet zekat mund t’i radhisim kështu:

- Të varfrit;
- Të vobektët;
- Borxhlinjtë;
- Udhëtarët;
- Njerëzit që punojnë dhe luftojnë në rrugën e Allahut;
- Personat, zemrat e të cilëve kërkohet të afrohen ndaj Allahut;
- Nëpunësit e mbledhjes së zekatit;
- Skllervëve, me qëllim që t’u falet liria.

Ndërkohë që jepet zekati ndaj të varfërve, është mirë që të respektojmë radhën e mëposhtme: vëllezërit, motrat, fëmijët e vëllezërve, fëmijët e motrave, xhaxhai, halla, daja dhe teza, fëmijët e këtyre, të afërmit e tjerë, fqinjët, kolegët, të varfrit e tjerë që gjenden në vendbanimin ku jeton personi që do të japë zekatin, si dhe të varfrit që



jetojnë në vende të tjera. Është më e përshtatshme që një person, nëse ka persona nevojtarë afër, së pari t'u japë zekat këtyre.

Zekati nuk mund t'u jepet nënës, babait, gjyshërve dhe gjysheve; djemve, vajzave dhe nipërve e mbesave; bashkëshortit/bashkëshortes, atyre që nuk janë muslimanë dhe të pasurve. Ndaj atyre që nuk janë muslimanë mund të jepet sadaka, por jo zekat.



“Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëllojnë atij që mbjell një kokërr, nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijsëm.

Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, pa e përcjellë atë me përgojim apo fyerje, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.

Fjala e mirë dhe falja e gabimit janë më të vlefshme se lëmosha që përcillet me fyerje. Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Butë (nuk nxiton në dënime).

O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet sa për sy e faqe dhe nuk beson në Allahun e Ditën e Fundit. Ai shëmbëllen me një gur të lëmuar të mbuluar me dhé, mbi të cilin bie shiu me rrebesh, duke e lënë të zhveshur. Ata nuk kanë asnjë dobi nga veprat që kanë bërë, sepse Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin mohues” (*Bakara*, 2/261-264).



Të diskutojmë së bashku

Flisni me shokët mbi ajetet e mësipërme!



Mallrat nga të cilat jepet zekat



Më sipër kemi theksuar se, që të mund të jepet zekati i një pasurie, nevojitet që pasuria të ketë arritur në sasinë e nisabit, tepër nevojave themelore. Po ashtu, është e domosdoshme që kjo pasuri të jetë në cilësinë e rentabilitetit real ose potencial. Produktet bujqësore, kafshët dhe mallrat e tregtisë, në të vërtetë janë në cilësinë e rentabilitetit real. Ndërsa floriri, argjendi dhe paraja janë në cilësinë e rentabilitetit potencial. Sepse këta mund të shndërrohen në investim dhe të sjellin të ardhura. Në kuadër të këtyre parimeve të përgjithshme do të mundohemi të japim të dhëna të shkurtra në lidhje me mallrat që i nënshtrohen zekatit.

Zekati i mallrave të tregtisë, floririt, argjendit dhe kartëmonedhave

Çdo lloj i mallrave të tregtisë, floriri, argjendi dhe kartëmonedhe janë të nënshtuara ndaj zekatit. Personi që ka në dorë njërin prej këtyre mallrave, ndërkohë që jep zekat i vlerëson të gjitha këto së bashku.

Floriri dhe argjendi

Nisabi i floririt, ashtu siç e kemi thënë edhe më sipër, është minimalisht 80,18 gr. Ndërsa nisabi i argjendit është 561 gram. Në vitet e para të Islamit 80,18 gr flori si vlerë ishin ekuivalente me 561 gram argjend. Mirëpo në ditët e sotme argjendi ose sërma e ka humbur ndjeshëm vlerën në krahasim me floririn. Nga kjo pikëpamje, kur llogaritet norma nisab e mallrave që i nënshtrohen zekatit, si kartëmonedhat dhe mallrat e tregtisë, merret për kriter nisabi i floririt. Por personi që ka argjend në sasinë e nisabit ose më shumë se kjo sasi, zekatin e llogarit mbi këtë nisab.

Kartëmonedhat

Në rast se vlera e kartëmonedhave që ka dikush arrin deri në nisab, atëherë i nënshtrohet zekatit. Nëse kartëmonedhat ekzistenciale nuk arrijnë në sasinë e nisabit, nëse personi ka flori dhe mallra tregtie, i bashkon me ta dhe nëse të gjitha këta arrijnë në nivelin e nisabit, jepet zekati i tyre.

Sa u përket aksioneve, duke qenë se nxirren prej kompanive dhe grupeve të ndryshme, ato janë si mallrat e tregtisë që shiten e blihen në bursën e pasurive të tundshme, jepet zekat mbi vlerën e këtyre. Sa i përket zekatit të aksioneve që kanë të bëjnë me dokumente ortakërie në fitim dhe dëm, në cilëndo prej kompanive, nëse kompania punon duke shitur dhe blerë mallra, personi që zotëron aksione të një kompanie të tillë, jep zekat mbi vlerën e aksioneve. Nëse kompania është kompani industrialiste ose realizon menaxhimin e një biznesi dhe kapitali i saj është i lidhur me makineritë a mjetet e punës, personi që zotëron një ortakëri në një strukturë të tillë, nuk e jep zekatin nga vlera e aksioneve që ka në dorë, por nga fitimi vjetor i tij.

Zekati i kafshëve

Kafshët, nga të cilat nevojitet zekati, janë delja, dhia, gjedhët, mandat, deveja dhe kali. Delet, dhitë, gjedhët, mandat dhe devetë, të cilat ushqehen me qëllim riprodhimi, përfitimimi të qumështit ose leshit dhe që më shumë se gjysmën e vitit e kalojnë nëpër kullota, në rast se arrijnë në sasinë e nisabit, i nënshtrohen zekatit.

Zekati i prodhimeve bujqësore

Nga prodhimet e përfituara si rezultat i vaditjes me anë të shiut ose ujërave të lumenjve jepet si zekat një e dhjeta e prodhimit, ndërsa nga ato që vaditen duke bërë shpenzime jepet një e njëzeta.



Të studiojmë – Të mësojmë

Studioni mënyrat e pagesës së zekatit!



Çfarë përfiton njeriu nga adhurimi i zekatit?



“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë, me të cilën t’i pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira! Lutu për ta, sepse lutja jote është vërtet qetësim për ata. Allahu dëgjon dhe di gjithçka” (*Teube, 9/103*).

Pastrimi i besimtarëve nëpërmjet zekatit, gjë që përmendet në këtë ajet, mund të trajtohet si në aspektin individual, ashtu edhe në atë shoqëror. Zekati, në pikëpamjen individuale, e pastron shpirtin nga sëmundje shpirtërore, të tilla si koprancia, egoizmi, zilia ndaj pasurisë së tjetrit, nga smira. Të gjitha këto janë të këqija që bëhen shkak për probleme të tjera më të mëdha shoqërore, të tilla si armiqësia dhe cenimi i të drejtave të të tjerëve.

Përmendja në shumë vende në Kur’an e zekatit bashkë me namazin tregon se sa vend të rëndësishëm zë zekati në pastrimin shpirtëror të personit. Namazi na afron me Allahun dhe na pastron moralisht, ndërsa zekati mund të konsiderohet si shoqërues i namazit, sepse mundëson pastrimin nga dobësitë që burojnë prej vartësisë ndaj pasurisë, si dhe e vetëdijëson njeriun mbi ndihmën dhe solidaritetin me të tjerët.

Mallrat, nga të cilët në pikëpamje të Islamit nuk jepet zekat, pranohen si të ndotur. Malli pastrohet vetëm kur të jetë dhënë zekati i tij. Kështu, muslimani që jep zekatin, përjeton edhe lumturinë e pastrimit nga papastërtitë konvencionale, edhe lumturinë e pastrimit shpirtëror.

Në saje të zekatit personi shpëton edhe nga dobësitë që sjell vartësia ndaj pasurisë. Nëse kjo vartësi mbetet e pakontrolluar, personi mundohet ta shtojë atë pa bërë dallim ndërmjet legjitimes dhe jolegjitimes. Me pasurinë që fiton nuk ndihmon askënd. Zekati e mbron kështu njeriun nga një fund i tillë negativ.

Njerëzit që japin zekatin përjetojnë jo vetëm lumturinë e plotësimi të urdhrat të Allahut të Lartmadhëruar, por edhe atë të gëzimit të të varfërve dhe lumturinë e zëvendësimit të harxhimeve që bëhen në këtë rrugë. Nga ana tjetër, lumturia e marrjes së duarë së të varfrit, i cili gëzon nga zekati i dhënë, është një mjet më i madh fitimi dhe gëzimi për muslimanin.

Ndërsa një lumturi tjetër që do të përjetojë besimtari sa i përket kësaj çështjeje është lumturia që ndien nga falënderimi i mirësisë ndaj kësaj lumturie. Sepse falënderimi i

mirësive bëhet nga vetë lloji i tij. Edhe falënderimi i mallit që Allahu i Lartmadhëruar e jep si mirësi, realizohet duke e ndarë atë me të varfrit. Muslimani që jep zekatin jeton edhe lumturinë e gëzimin e kryerjes së këtij falënderimi.

Nga ana tjetër, zekati ndikon në mënyrë pozitive te të varfrit. Ai parandalon xhelozitë dhe ndjenjat negative që mund të krijohen ndaj pasurisë së të pasurve.

10

Çfarë përfiton shoqëria nga adhurimi i zekatit?



Për një jetesë shoqërore të shëndetshme, një rol të madh luan të qenët i vetëdijshëm se duhet dhënë ndihmë. Në shoqëritë ku nuk është zhvilluar vetëdija e ndihmesës dominon egoizmi. Në një vend ku dominon egoizmi, dashje pa dashje nisin përplasjet dhe konfliktet. Kjo situatë bëhet shkak për shqetësime të ndryshme shoqërore. Edhe pse këto përplasje mund të parandalohen deri diku nëpërmjet sanksioneve ligjore, në zonat ku nuk mbërrin kontrolli dhe inspektimi ligjor ato ushtrohen në mënyrë shumë të pamëshirshme. Për këtë arsye, funksioni më i rëndësishëm i zekatit në pikëpamjen shoqërore është që në vend të konceptimit të egoizmit të mundësojë dominimin e vetëdijes së ndihmesës dhe të parandalojë konfliktet e mundshme në shoqëri.

Në shoqëritë ku zekati funksionalizohet, konceptimi i bujarisë fiton përhapje. Zekati thuhetse gjallëron ndjenjat e solidaritetit në shoqëri, pakëson armiqësinë ndaj mallit dhe pasurisë dhe krijohet një mjedis besimi. Njerëzit e duan njëri-tjetrin, e respektojnë dhe kështu mundësohet qetësia dhe prehja shoqërore.

Një ndihmesë dhe solidaritet i tillë sjell për pasojë edhe konceptimin e të qenit një dhe bashkë në gëzim e në hidhërim, gjë që mundëson afrimetetin shoqëror. Kështu zekati formon një mëshirë e dhembshuri që kalon nga i pasuri drejt të varfrit; një urë respekti dhe dashurie ndaj shtresës së pasur drejt shtresës së varfër.

11

Ndarja e gëzimeve



Fjalja 'Gëzimet shtohen kur ndahen, ndërsa hidhërimet pakësohen' është një thënie e urtë që tregon një të vërtetë të madhe. Ky rezultat, në të cilin arrihet nëpërmjet përvojës së përbashkët të shoqërisë, është pranuar dhe është këshilluar nga feja islame. Të ndash gëzimet dhe hidhërimet e njerëzve është konsideruar si një e drejtë e muslimanit mbi muslimanin. Në këtë kontekst, pranimi i ftesës që të vjen nga dikush, vizita që i bëhet të sëmurit, pjesëmarrja në xhenaze dhe shprehja e ngushëllimeve janë ndër shembujt e ndihmesës që kërkohen në hadithe. Siç shihet, një pjesë prej këtyre lidhen me ndarjen e gëzimeve, ndërsa pjesa tjetër me ndarjen e hidhërimeve. Nga ana tjetër Pejgamberi ynë është bërë shembull ndaj nesh duke ndarë gëzimet dhe hidhërimet e atyre që kishte përreth.

Bajramet

Muslimanët kanë dy bajrame në vit: Bajrami i Ramazanit dhe Bajrami i Kurbanit.

Feja jonë e lartë, Islami, ka përcaktuar si vaxhib sadakanë e fitrit ndaj të pasurve me rastin e Bajramit të Ramazanit, po ashtu ka përcaktuar vaxhib kurbanin me rastin e Bajramit të Kurbanit. Kjo tregon rëndësinë që i jep feja islame ndarjes së gëzimit dhe haresh në bajramet fetare dhe të qenët e të gjithëve pjesëmarrës në këtë hare e gëzim.

Bajramet janë ditë hareje e gëzimi për besimtarët. Muslimanët që plotësojnë urdhrin e Allahut duke mbajtur agjërim në muajin e Ramazanit dhe duke prerë kurban në Bajramin e Kurbanit, që bëjnë sakrificë në rrugën e Allahut për të bërë Bajram, përjetojnë lumturinë dhe gëzimin e të gjendurit në rrugën që ka treguar Allahu.

Në Bajram besimtarët urojnë njëri-tjetrit. Ndërsa Bajrami i atyre që janë larg urohet me anë të dhuratave ose letrave të ndryshme, vizitohen nëna, babai dhe të rriturit, fitohet zemra e tyre, pajtohen të zemëruarit me njëri-tjetrit. Këmbimi i dhuratave në mënyrë të ndërsjellë bëhet shkak që të shtohet gëzimi dhe hareja. Kështu në shoqëri formohet një afritet i bukur.

Netët e mira

Në Kur'anin Famëlartë është theksuar në mënyrë të veçantë Nata e Kadrit, kur thuhet që ajo është më e hairit se një mijë muaj. Nata e Kadrit është nata kur nisi të zbresë Kur'ani. Përveç kësaj, nata kur lindi Hz. Pejgamberi, nata kur u realizua mrekullia e Israsë dhe e Miraxhit, nata Beraet që vjen pesëmbëdhjetë ditë para Ramazanit dhe nata e parë xhuma e tre muajve, që njihen si tre muajt, pra Rexheb, Shaban dhe Ramazan, kanë një vend të veçantë në kulturën tonë dhe në përgjithësi njihen si 'Netët e mira'.

Këto net të veçanta janë periudha kohore, të cilat forcojnë unitetin dhe bashkimin e muslimanëve, forcojnë vëllazërinë mes tyre, bëhen shkak për faljen e Allahut të Lartmadhëruar, si dhe për ndjenja të gëzuara. Për këtë arsye netët e mira konsiderohen si periudha kohore, në të cilat muslimanët ndajnë gëzimin e tyre me njëri-tjetrit.

Për besimtarët këto periudha kohore janë mjet për kontrollimin e vetes, hapin portën për të bërë gjykimin e së shkuarës dhe për t'u përgatitur për të ardhmen.

Ata që në netët e mira kujtojnë detyrat dhe përgjegjësitë ndaj Krijuesit, ndaj familjes, fëmijëve, popullit dhe gjithë njerëzimit, duke qenë të qetë në vetvete, arrijnë t'u largohen gabimeve dhe mangësive, hapin dorën dhe zemrën ndaj të gjithë atyre që kanë nevojë dhe përfitojnë dobi nga begatia e këtyre periudhave kohore.

Netët e mira, duke nisur nga Nata e Kadrit, janë si më poshtë: Miraxh, Berat dhe Regaib.





Të studiojmë – Të mësojmë

Studioni se kur janë periudhat e netëve të mira dhe se ç'duhet të bëhet në këto net. Informacionet e mësuara ndajini me shokët tuaj.

Xhuma

Dita e premte (xhuma) është një ditë shumë e rëndësishme në aspekt të unitetit dhe bashkimit të muslimanëve. Kjo ditë e bekuar thuajse është dita e Bajramit javor. Namazi i xhumasë nuk mund të falet në mënyrë individuale, por vetëm me xhemaat. Kjo nënkupton bashkimin e të gjithë banorëve çdo javë në një vend të caktuar. Të qenët e namazit të xhumasë si njëri prej farzeve më të fuqishme, si dhe përdorimi i shprehjeve shumë të rënda ndaj atyre që e braktisin atë, tregon për vendin dhe rëndësinë e saj në fenë islame. Për shembull, personave që janë përgjegjës për faljen e xhumasë dhe që nuk kanë një justifikim tjetër që të jetë pengesë për vajtjen në namaz, nuk u lejohet të merren me tregti dhe të mos shkojnë të falen ditën e xhuma. Nëse ndodh që ata të merren me tregti dhe të mos falin të xhumanë, kjo është pranuar si haram dhe tregon për rëndësinë që ka pjesëmarrja në namazin e xhumasë.



“Nëse dikush pastrohet ditën e premte duke e larë krejt trupin, flokët e mjekrën, i vajos ata dhe i kreh ose parfumoset me erëra të mira, e më pas shkon në xhami; nëse ky person nuk ulet mes dy personave që janë pranë njëri-tjetrit, më pas dëgjon imamin pa nxjerrë zë, gjynahet që kryen nga ajo xhuma deri në tjetrën i falen” (*Buhari, Xhum’a, 6, 19*).

“Në ditën e xhuma ka një çast që, nëse një musliman rastis në atë çast duke mbajtur agjërim dhe kërkon diçka nga Allahu, pa dyshim që Allahu ia jep atij atë që dëshiron” (*Buhari, Xhum’a, 37, Talak 24, Dea’uat 61; Muslim, Musafirin, 166, 167, Xhum’a, 13-15*).

Namazi i xhumasë është një mundësi shumë e mirë që njerëzit, pavarësisht se ku banojnë, të mos shpëputen nga njëri-tjetri për shkak të konceptimeve individuale, të jenë të informuar për gjendjen e njëri-tjetrit, të kërkojnë zgjidhje për problemet e njëri-tjetrit dhe të ndajnë brengat me njëri-tjetrin.

Hadithet në trajtën: “Për çdokënd në moshë të pjekur marrja e guslit ditën e xhuma është e nevojshme.” (*Buhari, Ezan, 161, Xhum’a, 2, 3, 12; Muslim, Xhum’a, 5, 7; Ebu Dau’ud, Taharet, 127; Nesai, Xhum’a, 2, 6, 8, 11; Ibn Maxhe, Ikamet, 80*), theksojnë parime të rëndësishme sa i përket faktit që njerëzit, të cilët do të jenë në mes të individëve të tjerë, nuk duhet të kryejnë sjellje që shqetësojnë të tjerët. Kjo situatë jep mesazhe të rëndësishme në lidhje me respektin që duhet të tregojmë ndaj njerëzve të tjerë kur jemi pjesë e shoqërisë së tyre.

Muaji i Ramazanit

Muaji i Ramazanit është një klimë adhurimi, në të cilën solidariteti në shoqëritë muslimane arrin nivelin më të lartë. Krahas syfyreve, sofrave të iftarit dhe teravive, aktiviteteve të tjera sociale dhe kulturore, muaji i Ramazanit zë një vend të rëndësishëm në botën islame.

Muaji i Ramazanit i shton një hare dhe gëzim të veçantë jetës së muslimanëve. Kultura e Ramazanit, e cila prej shekujsh të tërë pasurohet edhe me kontribute kulturore vendëse, është një periudhë kohore që pritet me mallëngjim dhe përqafohet me mall.

Gjatë muajit të Ramazanit ndjenjat e solidaritetit te muslimanët thuajse gufojnë dhe shoqëria kaplohet nga emocioni për të ndihmuar të tjerët. Krahas adhurimeve apo ibadeteve të detyrueshme financiare, siç janë zekati dhe fitre, plotësimi i të cilëve është i detyrueshëm, edhe ndihmesat që bëjnë muslimanët në mënyrë vullnetare, përhapen më shpejt. Gjatë këtij muaji thuajse të gjithë jetojnë bashkërisht gëzimin e Ramazanit, njerëzit bëhen më aktivë dhe krijohet një refleks shoqëror për ndarjen e gëzimit të Ramazanit. Kjo situatë shkakton edhe një gëzim shoqëror mjaft përfshirës në muajin e Ramazanit.

Shembuj të tjerë në lidhje me ndarjen e gëzimeve

Në kontekstin e ndarjes së gëzimeve, respektimi i ftesës së vëllait besimtar, pjesëmarrja në dasmën e tij, përgëzimi i tij në çfarëdolloj pune të hairit, të gjitha këto janë ndër detyrat njerëzore dhe që na jepen nga feja Islame. Për të kuptuar rëndësinë që i jep feja islame ndarjes së gëzimeve me fqinjët, të njohurit dhe miqtë, mjafton që të shihni dispozitën që gjendet në veprat e fikhut. Sipas saj, një person që ka bërë nijet për agjërim nafile, në rast se ftohet në një drekë apo darkë dhe ndihet i shqetësuar, duke menduar se nëse nuk merr pjesë do të lëndohet i zoti i shtëpisë, e prish agjërimin dhe më pas e bën kaza atë. Më lart kemi bërë të ditur se Pejgamberi e konsideron përgjigjen ndaj ftesës si njërën prej të drejtave të muslimanit mbi muslimanin. Ky dhe hadithe të ngjashme me të tregojnë rëndësinë që u jep feja islame ndarjes së gëzimeve.

12

Ndarja e hidhërimeve



Njeriu nuk përballët gjithmonë me gjëra të mira e të bukura. Herë pas here mund të hasë edhe situata të hidhura apo të dhimbshme. Dhimbjet me të cilat përballët herë pas here njeriu janë shumë të rënda. Të humbë dikë që e do shumë, të kaplohet nga një sëmundje të rëndë, të humbë gjithë pasurinë, të gjithë këto janë ndër shembujt që e ilustrjnë situatën e mësipërme. Në kohë të tilla njeriu ndien nevojë për dikë që do ta mbështesë, që do ta ngushëllojë. Ata që kanë pranë bashkëshortin/bashkëshorten, miq, fqinj dhe të njohur, mund ta kalojnë më lehtë gjendjen e shokut që përjetojnë për shkak të dhimbjeve dhe vështirësive. Për këtë arsye, ndarja e hidhërimeve është shumë e rëndësishme në aspekt të jetesës shoqërore. Feja islame thekson një konceptim shumë të bukur vëllazërie sa i përket kësaj çështjeje. Në saje të kësaj, njerëzit mund t'i



107

tejkalojnë më lehtë dhimbjet dhe vështirësitë që hasin. Tani do të shohim disa dispozita që thekson Islami:

Vizita e të sëmurit

Të angazhohemi me hallet dhe problemet e njerëzve në shoqërinë brenda së cilës jetojmë, të ndihmojmë nevojtarët dhe personat e vobektë, t'i përgjigjemi ftesës së atyre që na ftojnë, të marrim pjesë nëpër xhenaze, të plotësojmë detyrat fetare dhe të vizitojmë të sëmurët, janë ndër detyrat themelore njerëzore. Feja jonë, plotësimin e këtyre detyrave njerëzore e pranon si një detyrë fetare. Vizita e të sëmurit është një detyrë njerëzore, aq sa ç'është edhe detyrë e këshilluar nga feja islame. Për këtë arsye, feja islame ka qëndruar me ngulm mbi këtë detyrë njerëzore.



“Vizitoni të sëmurin, ngopni të uriturin, shpëtoni pengun!” (Buhari, Xhihad, 1, Et’ime, 1, Nikah, 71, Merda 4).

Pejgamberi ka qëndruar me ngulm mbi vizitën e të sëmurit. Hadithi në trajtën: “Muslimani ka pesë të drejta mbi muslimanin: të marrësh selam, të vizitosh të sëmurin, të kryesh detyrat në lidhje me xhenazen, t'i përgjigjesh ftesës dhe të bësh dua ndaj atij që teshtin duke thënë ‘jerhamukellah: Allahu të mëshiroftë’ (Buhari, Xhenaiz, 2; Muslim, Selam, 4. Përveç kësaj shihni edhe Ibn Maxhe, Xhenaiz), të gjitha këto u kujtojnë muslimanëve detyrat që lidhen me këtë çështje. Në disa transmetime të këtij hadithi gjenden gjashtë pika (nene). Kjo tregon se ky numër që citohet në hadith thekson vetëm një pjesë të të drejtave të muslimanit mbi muslimanin. Hz. Pejgamberi (s.a.s.) i vizitonte të sëmurët, qofshin ato të afërm, qofshin individë që i përkisnin shoqërisë ku jetonte. Ai u uronte shërim sa më të shpejtë atyre dhe bënte dua për ta. Në këtë çështje ka shumë shembuj të kësaj natyre. Ashtu siç tregon Hz. Aisheja (r.a.), kur sëmurej një prej pjesëtarëve të familjes, ai e fërkonte atë me dorën e djathtë dhe këndonte dua duke thënë:

“O Allahu im, Zoti i të gjithë njerëzve! Largoje hidhërimin nga ky njeri dhe fal shërim. Vetëm ti mund të japësh shërim. Nuk ka shërim tjetër pos shërimit tënd. Dhuroji shërim të tillë që te ky njeri të mos mbetet gjurmë nga asnjë sëmundje!”

Në fenë islame, të vizitosh të sëmurin pa parë identitetin e tij, t'u japësh ushqim të uriturve pa bërë dallim nëse janë njerëz apo kafshë, të strehosh të pastrehët, të mundohesh të shpëtosh pengun që ka rënë në dorë të armikut, që të gjitha konsiderohen si detyra fetare. Hz. Pejgamberi ka treguar mjaft mëshirë dhe dhembshuri ndaj shtresave në nevojë të shoqërisë dhe e ka këshilluar këtë edhe ndaj ummetit të tij.

Të vizitosh të sëmurin, të thuash fjalë inkurajuese gjatë vizitës, të bësh dua duke thënë: ‘Allahu të dhëntë shërim!’ po ashtu të kërkosh dua nga ai, janë ndër veprimet që përfshihen tek etika e vizitës.

Të ndihmohet ata që janë në pozitë të vështirë

Të zgjasësh dorën e ndihmës ndaj individëve në vështirësi dhe që kanë nevojë për ndihmë është një kriter mbi të cilin feja islame qëndron me përkushtim. Ndihmesa dhe solidariteti ndaj atyre që janë në situatë të tillë, në përputhje me nivelin e vështirësisë, përtej të qenit një virtytshmëri që këshillohet dhe nxitet, tashmë është shndërruar në një detyrë. Për të fituar sevap dhe për t'u bërë një njeri i mirë, për t'u bërë një musliman i mirë, kjo detyrë merr epërsi dhe nevojitet të plotësohet. Pa dyshim që nuk humbet gjë nga sevapi dhe nga shpërblimi. Madje ka shumë shembuj e situata, në të cilat në rast se nuk jepet ndihmë, personi në nevojë mund të rrezikojë jetën ose të dëmtohet fizikisht, deri në pamundësi për t'u shëruar. Në situata të tilla, të ndihmohet personat në nevojë, me mundësitë që ke, është farz kifaje. Nëse askush prej atyre që kanë mundësi të ndihmojnë, nuk e bëjnë këtë, janë fetarisht përgjegjës, pavarësisht se cilës fe apo besim i përkasin nevojtarët.

Të ndihmohet ata që gjenden në vështirësi dhe të vobektët është një domosdoshmëri e vëllazërisë islame. Njëra prej veçorive më të rëndësishme të besimtarit është solidariteti. Ata që nuk angazhohen me hallet e njerëzve përreth nuk zotërojnë vetëdijen reale islame. Hz. Pejgamberi (s.a.s.) urdhëron kështu në hadithe:



“Muslimani është vëllai i muslimanit. Nuk bën mizori ndaj tij, nuk e lë vetëm atë. Nëse dikush përballon nevojën e vëllait musliman, edhe Allahu e ndihmon atë. Nëse dikush përballon një vështirësi të një muslimani, edhe Allahu eliminon në ditën e kiametit njërën prej vështirësive të tij. Nëse dikush mbulon turpin e vëllait besimtar, edhe Allahu mbulon turpin e tij në ditën e kiametit” (*Texhridi Sarih: 7/360; Rijadhu's-Salihin, 1/284*).

Njëra prej veçorive të Islamit është t'i kushtohet rëndësi e veçantë jetesës shoqërore. Individët që krijojnë një shoqëri të tillë, nuk janë si pjesëtarët e një bashkësie, por si gjymtyrët e një trupi, dhimbja e njërit prej të cilëve ndikon te të gjithë të tjerët. (*Buhari, Edeb: 27*).

Të gjithë pjesëtarët që formojnë shoqërinë janë vëllezër. (*Huxhurat, 49/10*).

Me shprehjen e Pejgamberit, vartësia e besimtarit ndaj besimtarit në shoqërinë islame është si ndërtesa, gurët e së cilës lidhen dhe gërshetohen me njëri-tjetrin. (*Texhridi Sarih: 12/134*).

Në një shoqëri të tillë duhet që asnjë nevojtar të mos mbetet pa ndihmë. Për shembull, në një ajet ku flitet për afatet kohore ndaj borxhliut që gjendet në vështirësi urdhërohet kështu: “Nëse e dini se borxhliu është ngushtë, shtyjani afatin (e shlyerjes së borxhit) derisa ta përmirësojë gjendjen. Por është më mirë për ju që t'ia falni borxhin (në kuptimin e sadakasë). Ah sikur ta dinit” (*Bakara, 2/280*).

Krahas ndihmave materiale, është e nevojshme që të ndihmojmë në mënyrë aktive ata që janë në nevojë dhe në pozitë të vështirë. Edhe ndihmat konkrete që mund të bëhen



në këtë formë janë cilësuar si sadaka në fenë islame. Pejgamberi ynë, në një hadith të tij e shpjegon kështu shpërblimin e këtyre ndihmave:

“Ata që vrapojnë të ndihmojnë një të vetmuar marrin sevap njësoj si të kenë bërë xhi-had në rrugën e Allahut” (*Neueui, Rijadhu's-Salihin, 1/310*).



“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë” (*Al-u Imran, 3/92*).

Ndërsa një mënyrë e ndihmës, së cilës i kushtohet shumë rëndësi në fenë islame, është kardhu'l-hasen. Kardhu'l-hasen nënkupton dhënien e borxhit ndaj atyre që janë në vështirësi. Ky borxh që jepet pa këmbim është ndër veprimet ndaj të cilave Allahu është i kënaqur më së tepërmi.

Xhenazja dhe ngushëllimi



“Thuaj: ‘Vdekja prej së cilës po ikni, do t’ju arrijë. Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, i Cili e di të padukshmen dhe të dukshmen dhe Ai do t’ju njoftojë ju për atë që keni bërë” (*Xhum’a, 62/8*).

Feja jonë u ka ngarkuar muslimanëve disa detyra ndaj atij që ndërron jetë, duke filluar që nga momenti kur sëmuret e deri kur të varroset.

Larja e xhenazes, qefinosja, falja e namazit të saj, hapja e varrit, varrosja dhe kryerja e procedurave për varrim, të gjitha këto janë detyra në cilësinë farz kifaje mbi muslimanët. Kur një pjesë e muslimanëve i plotësojnë këto detyra, përgjegjësia mbi të tjerët bie. Mirëpo në rast se nuk i plotëson askush, të gjithë bëhen përgjegjës për këtë.

Të mos lësh vetëm xhenazen rrugës për te varri, ta shoqërosh atë qoftë edhe deri te varri, është një detyrë e rëndësishme njerëzore. Feja islame e thekson me ngulm këtë detyrë.



Të studiojmë – Të mësojmë

Cilat janë detyrat fetare që duhet të kryhen nga momenti i sëmundjes dhe deri në pjesën në vijim! Studioni!

Ngushëllimi i pjesëtarëve të familjes së personit që ndërron jetë dhe shprehja e duave për faljen e të vdekurit është mustehab, pra veprim i pëlqyeshëm. Ngushëllimi bëhet pasi të jetë varrosur xhenazja. Pejgamberi ynë urdhëron: “Atij që shpreh ngushëllim ndaj personit që i ka ndodhur një fatkeqësi i jepet sevap aq sa të zotit të kësaj fatkeqësie” (*Ibn Maxhe, Xhenaiz, 56; Tirmidhi, Xhenaiz, 71*).

Një tjetër veprim i pëlqyer është që shtëpia e xhenazes të ofrojë ushqim për të afërmit dhe fqinjët. Pejgamberi, kur ka rënë dëshmor Xhaferi (r.a.) ka thënë: "Gatuani ushqim për familjen e Xhaferit, sepse atyre u ka ndodhur diçka e rëndë" (Ebu Dau'ud, Xhenaiz, 30). Mirëpo është mekruh që shtëpia e xhenazes të ofrojë ndaj të tjerëve ushqim dhe hallvë. Sepse ofrimi i gostisë është i lejuar në kohë të gëzuara.

Të gjitha këto janë sjellje njerëzore kundrejt ndarjes së dhimbjes së njerëzve që kanë humbur të afërmit dhe që përjetojnë një hidhërim të madh. Feja islame sheh si detyrë fetare pikërisht këto sjellje njerëzore.



Të komentojmë

"Personin që ndërron jetë e ndjekin tri gjëra, dy prej tyre kthehen pas, njëra mbetet. Atë e ndjekin familja (miqtë dhe të afërmit), pasuria dhe bëmat e tij. Familja, miqtë dhe pasuria kthehen pas, ndërsa bëmat mbeten bashkë me të" (*Muslim, Zuhd, 1*).



"Nëse ndonjëri nga robtë bie në vështirësi dhe bën dua duke thënë: 'Ne erdhëm prej Allahut, do të kthehemi tek Allahu. Allahu im, më jep shpërblimin e fatkeqësisë që më ka ndodhur dhe më dhuro mua diçka më të hairit se kjo', Allahu i Lartmadhëruar e shpërblen për shkak të vështirësisë me të cilën është përballur dhe i jep atij diçka më të hairit se ajo që ka humbur" (*Muslim, Xhenaiz, 4*).



Të komentojmë

Komentojini hadithet e mësipërme në aspekt të ndarjes së hidhërimeve. Bisedoni me shokët tuaj mbi to!

Vizita e varrit dhe përmendja e të parëve

Varret janë emërtuar edhe si mezar, në kuptimin 'vend që vizitohet'. Të vizitosh varrezat është konsideruar si veprim i lejuar, me kusht që kjo vizitë të mos ketë kritere që bien në kundërshtim me Islamin.

Gjatë vizitës varret nuk cenohen, nuk kryhet defekim ose urinim mbi varreza, personi nuk ulet mbi varre dhe nuk mbështetet në ta, nuk fle pranë varreve. Të gjitha këto veprime janë mekruh. Edhe dëmtimi i shtresës jeshile të varrezave pranohet si mekruh, pra veprim i papëlqyeshëm. Të gjitha këto janë pranuar si mungesë respekti ndaj të drejtave të të vdekurve.

Vizita e varreve ka disa dobi. Për shkak të dobive, të tilla si mosharrimi i vdekjes dhe ahiretit nga personi, mosshprehja e vartësisë së tepërt ndaj pasurisë botërore dhe motentimi i kryerjes së padrejtësive ndaj njerëzve, orientimi ndaj mirësisë duke kujtuar mirësitë e njerëzve pozitivë në të shkuarën, shmangia nga të këqijat, duke marrë parasysh edhe të këqijat e njerëzve negativë, vizita e varreve në fenë islame është pranuar si mustehab, sepse vizita e varreve u kujton njerëzve ahiretin.

Këshillohet që të qëndrojmë për një kohë të shkurtër pranë varrit që do të vizitojmë,



pa e cenuar dhe pa u ulur mbi të, të këndojmë dua si për ata që ndodhen në varr, ashtu edhe për ata që janë ende në jetë. Kështu besimtari në varr do të dojë të shuajë vetminë me vëllanë besimtar që ka ardhur dhe do të gëzohet.

Shembuj të tjerë në lidhje me ndarjen e hidhërimeve

Njeriu gjatë gjithë jetës mund të përballet me vështirësi të ndryshme, si për shembull, të pësojë aksident dhe të shndërrohet në person me aftësi të kufizuara. Në një situatë të tillë mund të jetë edhe ndonjëri prej të afërmve të tij. Nga ana tjetër personi mund të humbë edhe pasurinë, që është thujtë në një pozitë të pazëvendësueshme dhe në cilësi jetësore. Të gjitha këto dhe fatkeqësi të ngjashme janë situata të vështira, me të cilat njeriu mund të përballet në jetën e botës si një sprovë.



“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: ‘Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!’ Ata do të shpërblehen me bekim dhe mëshirë nga Zoti i tyre; ata janë në rrugën e drejtë!” (*Bakara, 2/155-157*).

Këto situata, me të cilat personi përballet herë pas here, mund të jenë shumë të rënda dhe prandaj njeriu ndien nevojë për mbështetjen e të afërmve e miqve. Në kohë të tilla ndarja e dhimbjes lehtëson hidhërimin e njeriut dhe brengën e tij, duke bërë që ai ta kuptojë se nuk është i vetëm. Për këtë arsye gjen ngushëllim dhe arrin ta kalojë më me lehtësi situatën e rëndë në të cilën gjendet.

Ndjeshmëria dhe ndërgjegjësimi i muslimanit nuk përputhet me sjelljen indiferente ndaj problemeve dhe vështirësive të të tjerëve. Nga cilido besim dhe konceptim qoftë, të ndajmë hallet dhe vështirësitë e njerëzve që kanë probleme, të jemi ortakë në hidhërimin e tyre është një detyrë e Islamit dhe një detyrë njerëzore.

13

Institucionet e ndihmesës dhe të solidaritetit në traditën turko-islame

Krahas dispozitave të Kur’anit dhe sunnetit, të cilat nxisin ndihmesën dhe solidaritetin, në veçanti modelet legjendare të brezit të parë të Islamit, sahabet, duke përjetësuar në trajtën më të bukur këto shembuj, janë bërë faktorët më efektivë në nxitjen e ndihmesës dhe solidaritetit mes muslimanëve. Shprehja sipas së cilës, nuk mund të jetë besimtar i vërtetë ai që shtrihet i ngopur, ndërkohë që fqinji i tij është i uritur, ka marrë trajtën e një shprehjeje të përbashkët mes muslimanëve.

Sahabet, si brezi i parë i Islamit, shembujt më të bukur të këtyre veçorive i kanë praktikuar personalisht. Pa dyshim që shembulli më i bukur i solidaritetit në mes tyre është për-

jetuar me rastin e muslimanëve që bënë hixhret në Medine bashkë me Hz. Pejgamberin dhe muslimanëve vendës të Medines. Në këtë afrimitet, ensarët, pra muslimanët medinas, kanë ndarë pasuritë e tyre me muslimanët që kishin lënë mallrat, pasuritë dhe shtëpitë e familjet në Mekë.



“Për sa kohë personi nuk do për vëllanë atë që do edhe për vete, nuk konsiderohet se ka besuar” (*Buhari, Iman, 6*).

Pra, në kuadër të këtyre parimeve dhe zbatimeve të përgjithshme, që në fillim muslimanët kanë krijuar një traditë shumë të bukur ndihmese dhe solidariteti. Kjo traditë është bërë shkak për themelimin e institucioneve të fuqishme, që do të mbijetonin për shekuj të tërë në botën islame. Ndër më kryesorët prej tyre janë fondacionet. Turqit, të cilët morën nga të parët e këtyre këto institucione dhe parimet themelore në të cilat bazohen, duke i zhvilluar edhe më shumë ato, e kanë vijuar këtë traditë të bukur për shekuj të tërë.

Ndër institucionet më të rëndësishme që kanë rrënjësuar vetëdijen e ndihmës dhe të solidaritetit në traditën turko-islame janë fondacionet.

Të konkurrosh në mirësi dhe në hair, të harxhosh në rrugën e Allahut dhe të zgjasësh dorën ndaj personave të vetmuar, të varfër dhe të vobektë, të gjitha këto janë ndër kriteret, të cilat Kur’ani Famëlartë i thekson me ngulm dhe na nxit që t’i zbatojmë. Nga mjaft ajete dhe hadithe mësojmë se pikërisht veprime të tilla janë investime që na shërbejnë përjetë. Në Kur’anin Famëlartë urdhërohet kështu: “Për sa kohë nuk harxhoni për Allahun nga gjërat që doni, nuk mund të keni hair” (*Al-u Imran, 3/92*).

Edhe në disa ajete shprehet këshilla në trajtën: “... Pra, bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira...” (*Bakara, 2/148; Maide, 5/48; Muminun, 23/61*).

Po ashtu, edhe ajeti: “... Ndërsa disa, me lejen e Allahut, shkojnë përpara me të mira (përtej detyrimeve), kjo është dhuntia e madhe”, edhe ky ajet pra, na informon se në çfarë mirësie të madhe arrijnë muslimanët që marrin pjesë në garën për të kryer mirësi.

Hz. Pejgamberi kishte dhuruar vetë në formën e vakfit një pjesë të madhe të pasurisë së tij në Medinetu’l-Muneu’uere; të njëjtën gjë kishin bërë edhe të parët e sabaheve, të cilët kanë dhuruar mjaft pasuri të tyre në formën e vakfit. Tashmë, kjo traditë ka bërë që të vendoset një parim mes muslimanëve. Sipas këtij parimi, “Më i hairit ndër njerëzit është ai që është i dobishëm ndaj të tjerëve; më e hairit e pasurisë është ajo që harxhohet në rrugën e Allahut, ndërsa më e hairit nga ato që harxhohen në rrugën e Allahut është ai që përballon gjërat për të cilat njerëzit ndiejnë më shumë nevojë”.

Ajo që përmendet shpesh në gjuhën turke, në trajtën ‘Sadakatu’l-xharije’, ka kuptimin e sadakasë që fiton sevap në mënyrë të vazhdueshme. Veprat që janë burim sevapi të vazhdueshëm në një hadith përcaktohen si më poshtë:





“Kur vdes i biri i Ademit, i mbyllet libri i veprave. Tre prej këtyre veprave janë të përjashtuara: ata që plotësojnë sadakanë e pandërprerë (sadakatu'l-xharije), që lënë dije të dobishme ndaj shoqërisë (nxënës/vepra) dhe ata që edukojnë fëmijë të hairit, të cilët bëjnë dua për mirësinë e tij” (*Muslim, Uasijje, 14; Ebu Dau'ud, Uesaja, 14; Tirmidhi, Ahkam, 36*).

Nuk ka dyshim se termi “sadakatu'l-xharije”, i cili citohet në hadith, përfshin edhe vakfin. Si rrjedhojë, ajo që citohet në hadith në trajtën sadakatu'l-xharije, përfshin vendet e hairit dhe të bamirësisë, siç janë rruga, ura, çezmat, mesxhidi, mensa për të varfrit, spitali dhe shkolla. Për sa kohë njerëzit përfitojnë dobi prej këtyre vendeve, ata që i ndërtojnë këto vende, ose që bëhen shkak për ndërtimin e tyre, ata që i mbështesin, qoftë në kohën kur janë të shëndetshëm e qoftë pas vdekjes së tyre, vijnë në fitojnë sevap.

Është e pamundur të mendosh një fushë të shoqërisë, në të cilën fondacionet që kishin themeluar turqit muslimanë në të shkuarën, nuk kishin zgjatur dorën e ndihmës. Duke u nisur nga fondacionet që jepnin kontribut në përgatitjen e pajës për vajzat e varfra që do të martoheshin, e deri te përkujdesja ndaj kafshëve të transportit, të cilat plakeshin dhe nuk punonin dot; po ashtu mbrojtja e haneve dhe kervansarajeve, në të cilat strehoheshin udhëtarët, apo komplekset e xhamive dhe zogjve migrantë, në të gjitha këto fusha të jetës shoqërore mund të shohim shërbimet e fondacionit.

Njëri prej formacioneve shoqërore civile që ka përjetësuar në formën më të bukur parimet e vëllazërisë, unitetit dhe bashkimit në historinë e popullit turk është institucioni i Ahizmit.

Ky formacion shoqëror, i cili përjetësoi parimin e vëllazërisë së Islamit, duke vazhduar të ecë në gjurmë të institucioneve Futu'uet, të themeluara para tyre në historinë islame me të njëjtat qëllime, ka nxjerrë shumë esnafë e zejtarë, ka dhënë shembujt legjendarë mbi tregtinë e drejtë, zejtarizmin e drejtë, besimin dhe respektin ndaj amanetit.

Një person që do të hynte në Ahizëm, së pari ishte i detyruar t'u përshtatej parimeve të Ahizmit, të përvetësonte rregullat e moralit, të tregtisë dhe të urdhëresave fetare e morale. Veçoritë që duhet të gjendeshin te pjesëtarët e organizatës ishin besueshmëria dhe mirënjohja, drejtësia, besimi, bujaria, modestia, angazhimi për mirësinë e vëllazërve, orientimi i vëllazërve dhe motrave drejt rrugës së drejtë, të qenit falës dhe shprehja e pendesës. Ndërsa zakone dhe sjellje të këqija, të tilla si konsumimi i pijeve alkoolike, gënjeshtria, thashethemet, tradhtia ndaj amanetit, si dhe dredhia bëheshin shkak për largimin nga profesioni.

Njëri prej parimeve më të rëndësishme të organizatës së Ahizmit është rëndësia që i jepet aftësisë profesionale.

Kjo organizatë e bukur, e strukturuar në formë të rregullt në qytete dhe fshatra, pra në çdo cep të shtetit, ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e unitetit, bashkimit dhe vëllazërisë së popullit në periudhat më të rrezikshme dhe të vështira, siç ishin periudha e pushtimit të Anadollit nga mongolët dhe ka dhënë shembullin më të bukur të unitetit të shtetit me popullin.



Përmbledhja e kapitullit



Njëra prej veçorive që zotëron njeriu prej kur është krijuar, ka të bëjë me ndjenjën e solidaritetit dhe të ndihmesës. Zekati ka si funksion theksimin e kësaj ndjenje, vënien në funksion dhe zhvillimin e saj. Zekati parandalon egoizmin dhe e pajis njeriun me vetëdijen e ndihmesës, pra të ndarjes me të tjerët të asaj që zotëron.

Të ndash me personat nevojtarë riskun që të ka dhënë Allahu është njëra ndër veçoritë më të rëndësishme të muslimanit. Po ashtu, njëri prej kritereve që e thekson me ngulm Kur'ani Famëllartë dhe që e inkurajon ka të bëjë me ndarjen e riskut që jep Allahu. Sadakaja është pasqyrimi në praktikë i vetëdijes së ndihmesës në Islam. Në kuptim të gjerë, sadakaja përfshin çdo lloj hairi dhe veprimi të mirë të kryer në emër të sadakasë. Në këtë kontekst, në Kur'anin Famëllartë edhe zekati quhet si sadaka.

Për të qenë përgjegjës me zekatin duhet të jesh i pasur fetarisht. Nisabi është një kriter i vendosur nga feja. Personi që zotëron një kursim në sasi të tillë dhe që e ka si tepricë nga borxhi a nevojat themelore, konsiderohet i pasur fetarisht. Nisabi mund të quhet edhe kufiri minimal i të qenit i pasur ose kriteri i pasurisë minimale. Një person, i cili zotëron mall apo pasuri në nivelin që i nënshtrohet zekatit, përveç borxhit dhe nevojave themelore, bëhet përgjegjës me dhënien e zekatit. Personi, malli ose pasuria e të cilit nuk ka arritur në sasinë e nisabit, ose sasia e nisabit të të cilit nuk ka kaluar mbi të një vit hënor, nuk bëhet përgjegjës për dhënien e zekatit.

Termi 'Hauaixhi aslije' nënkupton 'nevojat themelore' që nuk merren parasysh kur llogaritet nisabi i pranuar si kriter i pasurisë minimale gjatë përcaktimit të përgjegjësisë së zekatit, sadakasë së fitrit dhe kurbanit. Nevojat themelore janë shtëpia, mjeti i transportit, ushqimet dhe veshjet vjetore të vetë personit a të personave për të cilët është përgjegjës, sendet e nevojshme të shtëpisë, librat personale, mjetet e ndryshme të personave profesionistë dhe gjërat e detyrueshme për jetesë.

Personat që duhet të japin zekatin janë ata që zotërojnë shëndet të plotë mendor, që kanë arritur në moshën e pjekurisë dhe që i kanë kushtet e dhënies së zekatit nga kursimet materiale të muslimanëve të pasur.

Personat ndaj të cilëve do të jepet zekat janë të varfrit, të vobektit, borxhlinjtë, udhëtarët, ata që bëjnë xhihad dhe shpallje hyjnore në rrugën e Allahut, personat, zemrat e të cilëve dëshirojnë të afrohen ndaj Islamit, nëpunësit e mbledhjes së zekatit dhe skllëverit, me qëllim që të shpëtojnë nga robërimi.

Në mënyrë që mallrat të jenë të nënshtuar ndaj zekatit, është e domosdoshme të jenë në sasinë e nisabit, mbi nevojat themelore, të kalojnë një vit në pronësinë e të zotit dhe të jenë në cilësinë e rentabilitetit real ose potencial. Produktet bujqësore, kafshët dhe mallrat e tregtisë janë në cilësinë rentabël. Ndërsa floriri, argjendi dhe kartëmonedhat janë në cilësinë e rentabilitetit potencial.

Zekati, duke frenuar vartësinë e tepërt të njeriut ndaj pasurisë, e mban në ekuilibër këtë dëshirë. Kështu personi shpëton nga dobësitë që sjell vartësia e tepërt ndaj pasurisë.

Feja islame i jep shumë rëndësi afrimitetit shoqëror, solidaritetit dhe ndihmesës. Të ndash gëzimet dhe hidhërimet e njerëzve është diçka e domosdoshme. Në këtë kontekst, t'i përgjigjesh ftesës që të bën dikush, të vizitosh të sëmurët, të marrësh pjesë në xhenaze dhe në ngushëllime, janë ndër shembujt e ndihmesës që kërkohet në hadithe.



Një pjesë prej këtyre kanë të bëjnë me ndarjen e gëzimeve, ndërsa pjesa tjetër me ndarjen e hidhërimeve. Nga ana tjetër, vetë Hz. Pejgamberi është bërë shembull për ne, duke ndarë gëzimet dhe hidhërimet e atyre që kishte përreth.

Njeriu nuk përballet gjithmonë me gjëra të mira dhe të bukura. Herë pas here mund të përballet me vështirësi e dhimbje, ndonjëherë dhimbjet me të cilat përballet mund të jenë shumë të rënda, si për shembull, humbja e dikujt që e ka dashur shumë, përballja me një sëmundje të rëndë, humbja e pasurisë etj. Në situata të tilla njeriu ndien nevojë për dikë që ta mbështesë dhe ta ngushëllojë. Ai që ka pranë bashkëshortin apo bashkëshorten, miqtë, fqinjët dhe të njohurit, mund ta tejkalojë më lehtë gjendjen e shokut që përjeton për shkak të dhimbjeve dhe vështirësive. Për këtë arsye, ndarja e hidhërimeve është po aq e rëndësishme sa ndarja e gëzimeve në jetesën shoqërore. Feja islame ka theksuar një konceptim shumë të bukur vëllazërie në këtë kriter. Në sajë të këtij konceptimi njerëzit mund të kalojnë më lehtë dhimbjet dhe vështirësitë me të cilat përballen.



Të rishikojmë kapitullin



1. Cili është funksioni i zekatit në aspekt të vetëdijes së ndihmesës?
2. Çfarë përfshin koncepti i sadakasë?
3. Ç'është nisabi? Cili është dallimi mes nisabit të zekatit dhe nisabit të sadakasë së fitrit?
4. Cili është kuptimi i termit hauaixhi aslije?
5. Kujt i jepet zekati?
6. Kush jep zekat?
7. Nga cilat mallra jepet zekat?
8. Cilat janë përfitimet në aspektin individual të adhurimit të zekatit?
9. Cilat janë përfitimet shoqërore të zekatit?
10. Çfarë funksioni kanë pasur Ahizmi dhe fondacionet në aspekt të krijimit të vetëdijes së ndihmesës?



Pyetje vlerësuese



1. Cilët nga kategoritë e mëposhtme janë përgjegjës për dhënien e sada-kasë së fitrit?

- A) Muslimanët në pozitë të pasur fetarisht, në mëngjesin e Bajramit të Ramazanit, paguajnë për veten dhe për personat për të cilët janë përgjegjës.
- B) E paguajnë të gjithë muslimanët, qofshin të pasur fetarisht apo jo.
- C) Ata që kanë një justifikim, i cili lejon mosmbajtjen e agjërimit në Ramazan, paguajnë nga një sadaka fitri për çdo ditë që nuk kanë mbajtur agjërime.
- D) Ata që prishin pa justifikim agjërimin e Ramazanit të nisur, paguajnë në vend të kësaj.

2. Sa i përket çështjes së zekatit, çfarë qëndrimi mban personi që ka një shtëpi të dytë përveç asaj ku jeton?

- A) E paguan zekatin e kësaj shtëpie mbi vlerën e saj.
- B) Bashkë me të ardhurat e tjera llogarit edhe të ardhurat e saj; nëse kalon sasia e nisabit paguan edhe zekatin.
- C) Nëse e ka dhënë me qira këtë shtëpi, zekatin e saj e paguan mbi këtë vlerë, nëse nuk e ka dhënë me qira, nuk nevojitet zekat.
- D) Nëse e përdor si shtëpi verore nuk nevojitet zekat, nëse jo e paguan mbi vlerën e saj.

3. Ç'duhet të bëjë personi që ka kartëmonedha, të cilat i nënshtrohen zekatit më shumë se sasia e nisabit?

- A) E jep zekatin duke zbritur pjesën e mbetur nën sasinë e nisabit.
- B) E jep zekatin duke përfshirë edhe pjesën e mbetur nën sasinë e nisabit.
- C) Pasi të ketë kaluar sasia e nisabit llogarit zekatin duke përfshirë edhe nevojat themelore.
- D) Në kartëmonedha nuk shihet sasia e nisabit, por jepet zekati, qoftë në sasi të paktë apo të shumtë.

4. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është një ndër konceptet që ka të bëjë me zekatin?

- A) Nisab
- B) Vakfe
- C) Hauaixhi aslije
- D) Sadaka

5. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk ka lidhje me netët e mira?

- A) Regaib
- B) Kadir
- C) Ashure
- D) Berat

adhurimi im



KAPITULLI

6





Haxhi dhe kurban

1. Haxhi dhe rëndësia e tij
2. Koncepte që lidhen me haxhin
3. Vendet që lidhen me haxhin
4. Llojet e adhurimit të haxhit
5. Kryerja e adhurimit të haxhit
6. Umreja
7. Çfarë përfitojnë shoqëria dhe individi nga adhurimi i haxhit?
8. Kurban

RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull:

- Trajtohen temat e haxhit, umresë dhe kurbanit.
- Për të kuptuar më mirë adhurimin e haxhit e kemi të domosdoshme të njohim vendet e shenjta ku realizohet haxhi. Duke u nisur nga ky kontekst, do të prezantohen shkurtime të vendet në të cilat kryhet adhurimi i haxhit.
- Ndërsa shpjegohet rëndësia e adhurimit të haxhit, kryerja e tij dhe termat që lidhen me të, sqarohen njëkohësisht edhe kuptimet simbolike të veprimeve në haxh.
- Preken shkurtime edhe adhurimi i umresë dhe trajtohen dallimet mes haxhit dhe umresë.
- Aludohet mbi rëndësinë e haxhit dhe të umresë në pikëpamje të vëllazërisë islame dhe mbi përfitimet që kanë muslimanët nga haxhi dhe umreja.
- Në fund shpjegohet brendia e adhurimit të kurbanit, kushtet dhe çfarë përfitojnë individit e shoqëria në aspekt të krijimit të vetëdijes së ndihmesës ndaj të tjerëve.

SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Pasi të jetë trajtuar ky kapitull:

1. Do të zotëroni të dhëna themelore në lidhje me vendet e shenjta ku kryhet haxh dhe umre.
2. Do të kuptoni se çfarë nënkuptojnë termat që lidhen me haxhin, të tillë si: ihram, tavaf, vakfe dhe sa'i.
3. Do të mësoni në vija të përgjithshme se si kryhet haxhi.
4. Do të informoheni mbi të dhëna që lidhen me kuptimet simbolike të veprimeve që kryhen në haxh dhe umre.
5. Do të krijoni një ide mbi përfitimet që i vijnë individit dhe shoqërisë nga kryerja e haxhit dhe umresë.
6. Do të perceptoni brendinë e adhurimit të kurbanit, kushtet, qëllimin dhe rëndësinë e tij në aspekt të vetëdijes së afrimitetit dhe ndihmesës.

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

1. Nëse është e mundur dëgjoni edhe CD-të e përgatitura nga Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë me titujt "Mallëngjimi ndaj haxhit" dhe "Umreja".
2. Merrni të dhëna në lidhje me haxhin dhe umrenë nga persona a të njohur që e kanë kryer adhurimin e haxhit e të umresë.
3. Lexoni veprat me titull "Ilmihali i haxhit", "Udhërrëfyesi i umresë", "Të kuptosh haxhin" dhe "Albumi i Hixhazit", të cilat janë përgatitur nga Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë.

1

Haxhi dhe rëndësia e tij



Nga pikëpamja etimologjike, fjala haxh do të thotë 'të synosh dhe të orientohesh', ndërsa si koncept nënkupton 'të vizitosh në kohë të posaçme Qabenë në qytetin e Mekës dhe disa vende rreth saj, si dhe të plotësosh gjatë kësaj kohe disa detyra që duhet të kryhen në lidhje me adhurimin e haxhit'. Haxhi është një ndër pesë adhurimet themelore të Islamit. Personi që kryen adhurimin e haxhit quhet haxhi.



"Vizita (për haxh) e kësaj Faltoreje (e cila është detyrë) për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën është një e drejtë e Allahut mbi njerëzit." (Al-u Imran, 3/97).

Në Kur'an dhe në sunnet bëhet e ditur se haxhi është farz (obligim). Në këtë çështje, të gjithë muslimanët janë në unanimitet. Në Kur'an urdhërohet: "Vizita (për haxh) e kësaj Faltoreje (e cila është detyrë) për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën është një e drejtë e Allahut mbi njerëzit" (Al-u Imran, 3/97). Edhe Hz. Pejgamberi urdhëron: "Islami është ndërtuar mbi pesë kushte: të dëshmosh se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe se Muhammedi është Pejgamberi i Allahut; të falësh namaz; të japësh zekat; të bësh haxh në Qabe dhe të mbash agjërimin e Ramazanit" (Buhari, Iman, 1; Muslim, Iman, 19-22).

Haxhi është një adhurim i ndërthurur me simbole. Është një adhurim që bart në vetvete dimensionin financiar, fizik, individual, shoqëror dhe politik.

Haxhi ofron mundësinë e forcimit të kushteve të besimit dhe të përjetësimit të bukurive morale, të tilla si devotshmëria, durimi, dashuria-durimi, vëllazëria, sakrifica dhe bujaria. Me të gjitha këto veçori haxhi shndërrohet në një proces pastrimi intensiv shpirtëror.

Haxhi mundëson që çdo vit, miliona muslimanë me gjuhë, ngjyra, shtete, gjeografi dhe kultura të ndryshme, por me synim dhe qëllim të njëjtë, të bashkohen, të adhurojnë të gjithë së bashku, të orientohen drejt Allahut, të njihen dhe afrohen me njëri-tjetrin, të diskutojnë problemet e njerëzimit dhe të bëjnë të mundur që të mendojnë mbi zgjidhjet e këtyre problemeve. Muslimanët, të cilët gjatë haxhit heqin veshjet e përditshme dhe hyjnë në ihram, përjetojnë dhe mësojnë konkretisht të mos mburren me pozitat, postet dhe pasurinë e tyre, të mos harrojnë barazinë ndër njerëzit, ringjalljen dhe mbledhjen bashkërisht.

Ndalesat e vëna për personat e veshur me ihram ndikojnë që njeriu të përfitojë vetëdijen e mosdëmtimit as edhe të insekteve, të tregimit të mëshirës e dhembshurisë ndaj krijesave, si dhe të rezistencës ndaj vështirësive. Kështu, personat që kryejnë detyrimin e haxhit, përveçse bëjnë detyrën e robërimit ndaj Allahut, përfitojnë edhe zakonet e të qenit të dobishëm ndaj atyre që kanë përreth, ose më e pakta që të mos i dëmtojnë ata.



"Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria" (Bakara, 2/197).



2

Konceptet që lidhen me haxhin



Mikat

Vende të caktuara, në të cilat hyjnë në ihram ata që vijnë nga zona të ndryshme për të kryer haxh quhen 'Mikat'. Janë pesë vende mikati, të cilat i ka përcaktuar Pejgamberi ynë

Ihram

"Ihrami", si njëri ndër kushtet e haxhit, nënkupton përcaktimin haram të disa veprave dhe sjelljeve për një kohë të caktuar nga personi që ka bërë nijet të bëjë umre, ndërkohe që në kohë të tjera këto vepra dhe sjellje janë të lejuara. Kjo quhet "hyrje në ihram". Kur meshkujt hyjnë në ihram, mbulohen me një pëlthurë të përbërë prej dy pjesësh.



Të studiojmë – Të mësojmë

- Mësoni nga veprat e ilmihalit të dhëna në lidhje me vendet e mikatit.
- Studioni dhe mësoni mbi pastërtitë që duhet të kryejnë kandidatët për haxhinj para se të hyjnë në ihram.

122



"Kushdo që bën haxh për Allahun dhe gjatë haxhit shmanget nga fjalët e këqija apo nga rebelimi ndaj Allahut, kthehet nga haxhi si dita kur ka lindur nga nëna (i pastruar)" (Buhari, Haxh, 4).

Tavaf

'Tavaf' do të thotë të nisesh nga qoshja e Haxheru'l-Esuedit ose në drejtim të tij dhe të rrotullohesh shtatë herë rreth Qabesë me nijet tavafi. Çdo rrotullim quhet 'Shaut'. Me kryerjen e shtatë rrotullimeve formohet një tavaf.

Sa'j

Fjala "sa'j" ka kuptimin e të ecurit shpejt. Sa'j quhen katër vajtje drejt kodrës 'Merue' (duke nisur nga kodra 'Safa' në lindje të Qabesë), gjatë kryerjes së haxhit dhe umresë, si dhe tri kthime nga Merue drejt Safasë. Në sa'j, çdo vajtje nga Safa në Merue dhe çdo kthim nga Merue në Safa quhet 'Shaut'.

Të kryesh sa'j është vaxhib.

Thelbi i sa'jit bazohet në kujtimin e Hz. Haxherit, e cila kur po kërkonte ujë për Hz. Ismailin që e ushqente me qumësht, vraponte sa nga njëra kodër te tjetra.

Shaut

Shauti në tavaf tregon rrotullimin një herë rreth Qabesë sipas metodës së duhur, ndërsa në sa'j tregon vajtjen ose ardhjen ndërmjet kodrave Safa dhe Merue.

Vakfe

Vakfe ka kuptimin e qëndrimit, por si një term haxhi, shpreh fillimisht vakfenë (qëndrimin) në Arafat. Përveç vakfesë së Arafatit, e cila realizohet bashkë me praninë e personit, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, brenda kufijve të Arafatit, duke filluar që nga koha kur dielli arrin në zenit në periudhën e drekës e deri kur të vijë agimi i mëngjesit të Bajramit të Kurbanit dhe që përbën një ndër pjesët më të rëndësishme të haxhit, ekziston edhe qëndrimi në Muzdelife. Edhe ky qëndrim kryhet në Muzdelife natën e Bajramit. Vakfe ose qëndrimi në Muzdelife është ndër vaxhibet e haxhit.

H. Pejgamberi (s.a.s.) urdhëron: "Haxhi është Arafat" (Ebu Dau'ud, Menasik, 68; Ibn Maxhe, Menasik, 57). Prandaj personi që nuk kryen vakfenë e Arafatit nuk konsiderohet se ka kryer haxh.



Vendet që lidhen me haxhin



el-Mesxhidu'l-Haram

'el-Mesxhidu'l-Haram' është një mesxhid i madh, që gjendet në qytetin e Mekës, në mes të të cilit qëndron Qabeja. Ky quhet edhe 'el-Haremu'sh-Sherif'.



Të studiojmë – Të mësojmë

Studioni dhe informohuni mbi ndryshimet arkitekturore që përjetoi el-Mesxhidu'l-Harami nga fillimi deri në ditët e sotme.

Qabeja

Qabeja, drejt së cilës muslimanët orientohen kur falin namaz, është ndërtesa e parë e ndërtuar në sipërfaqen e tokës. Qabeja gjendet në mes të "el-Mesxhidu'l-Haramit" dhe është një ndërtesë e gurtë në formë kubike, e ndërtuar mbi një sipërfaqe prej 145 m². Ajo është e mbuluar me një mbulesë të zezë, e cila ndryshohet çdo vit në stinën e haxhit.

Safa - Merue

Janë emrat e dy kodrave të vogla që gjenden në lindje të Qabesë. Aktualisht ato janë pjesë e kufijve të el-Mesxhidu'l-Haramit. Sa'ji, si një ndër pjesët përbërëse të haxhit, kryhet mes këtyre dy kodrave.



123

Arafat

Arafat është emri i fushës së gjerë që gjendet afërsisht 25 km në juglindje të Mekës. Qëndrimi në Arafat, si kushti më i rëndësishëm përbërës i haxhit, kryhet në këtë fushë. Kufijtë e kësaj fushe të gjerë janë treguar nga Pejgamberi ynë. Në ditët e sotme këta kufij janë shenjuar me tabela.

Muzdelife

Muzdelife është emri i një zone që ndodhet mes Arafatit dhe Minasë, si dhe gjendet brenda kufijve të Haremit. Edhe kufijtë e Muzdelifes gjithashtu janë përcaktuar me tabela. Haxhinjtë, natën para Bajramit falin këtu namazin e akshamit dhe të jacisë duke i bashkuar ata.

Mina

Mina është emri i një zone ndërmjet Muzdelifes dhe Mekës, e cila gjendet ndërmjet kufijve të Haremit.

Goditja me gurë e shtyllave të shejtanit, si një ndër vaxhibet e haxhit që kryhet në ditët 10, 11, 12 dhe 13 të muajit Dhilhixh-xhe, prerja e kurbanit dhe prerja e flokëve bëhen pikërisht këtu.

el-Mesxhidu'n-Nebi

el-Mesxhidu'n-Nebi do të thotë Mesxhidi i Pejgamberit. el-Mesxhidu'n-Nebi është xhamia që ndërtoi Hz. Pejgamberi për herë të parë kur bëri hixhret nga Meka në Medine. el-Mesxhidu'n-Nebi është njëri ndër tre mesxhidet, te të cilët nxitet udhëtimi nga vende të largëta për të falur namaz në ta. Ndërsa dy të tjerët janë 'el-Mesxhidu'l-Harami' dhe 'el-Mesxhidu'l-Aksa'.

Pjesa që gjendet brenda el-Mesxhidu'n-Nebeuiut, mes varrit të Hz. Pejgamberit dhe minberit, quhet 'Rauda'. Hz. Pejgamberi shumë herë i falte këtu namazet.

Gjatë vizitës së el-Mesxhidu'n-Nebeuiut dhe varrit të Hz. Pejgamberit respektohen disa metoda dhe etika. Ata që shkojnë për vizitë veprojnë në kuadër të kësaj etike.

4

Llojet e adhurimit të haxhit

**Haxhi kryhet në tri forma: në ifrad, temettu dhe kiran.**

Haxhi i ifradit është haxhi që kryhet pa plotësuar adhurimin e umresë. Brenda muajve të haxhit të të njëjtit vit, personi hyn në ihram me nijetin e haxhit pa kryer umre dhe nëse kryen vetëm haxh atëherë konsiderohet se ka kryer haxh ifrad. Është emërtuar kështu ngaqë kryhet vetëm adhurimi i haxhit.

Haxhi temettu është haxhi që kryhet brenda muajve të haxhit të të njëjtit vit pasi të jetë kryer umreja dhe personi të ketë dalë nga ihrami, i cili hyn më pas sërish në ihram për të kryer haxh. Duke qenë se personit i krijohet hapësirë mes umresë dhe haxhit, është quajtur 'Temettu' në kuptimin e përfitimit.

Haxhi i kiranit do të thotë të kryesh brenda muajve të haxhit umrenë dhe haxhin bashkërisht, që të dy me të njëjtin nijet. Ngaqë umreja dhe haxhi kryhen me një ihram, ose më saktë bashkohen, janë quajtur si 'Kiran', në kuptimin bashkërisht.

Muajt e haxhit janë muajt sheuual, dhilkade dhe dhjetëditëshi i parë i muajit dhil-hixh-xhe.

**Të studiojmë – Të mësojmë**

Studioni farzet, vaxhibet dhe sunnetet e haxhit!

**Le të kujtojmë**

"Lebbejk Allahumme lebbejk, lebbejke la sherike leke lebbejk, innel hamde ue'n-ni'mete leke ue'l-mulk, la sherike lek."

Kuptimi: "Urdhëro Allahu im, urdhëro! Jam nën urdhrat e tua, urdhëro! Ti nuk ke asnjë ortak. Jam nën urdhrat e tua, urdhëro! Pa dyshim falënderimi të përket ty. Si mirësia, ashtu edhe pasuria është e jotja. Nuk ke asnjë shok."





Kryerja e adhurimit të haxhit



Kryerja e haxhit sipas llojeve të tij është si në vijim:

Haxhi temettu

Haxhi temettu kryhet në një stinë haxhi, duke hyrë në ihrame të ndara qoftë për umrenë, qoftë për haxhin. Kryerja e tij realizohet në etapë të mëposhtme:

ETAPAT E KRYERJES SË HAXHIT TEMETTU

- HYRJA NË IHRAM ME NIJETIN E UMRESË
- TAVAFI I UMRESË
- SA'J
- PRERJA E FLOKËVE DHE DALJA NGA IHRAMI I UMRESË

- HYRJA NË IHRAM ME NIJETIN E HAXHIT
- QËNDRIM NË ARAFAT
- QËNDRIM NË MUZDELIFE
- MINA (GODITJA E SHEJTANIT ME GURË)
- KURBAN
- QETHJA E FLOKËVE DHE DALJA NGA IHRAMI
- TAVAFI I VIZITËS
- TAVAFI I LAMTUMIRËS

126

Haxhi i ifradit

Haxhi i ifradit është haxhi që kryhet pa umre. Kryerja e tij realizohet sipas etapave të mëposhtme:

ETAPAT E KRYERJES SË HAXHIT TË IFRADIT

- HYRJA NË IHRAM ME NIJETIN E HAXHIT
- TAVAFI KUDUM
- SA'J (nëse dëshirohet)
- QËNDRIM NË ARAFAT
- QËNDRIM NË MUZDELIFE
- MINA (goditja e shejtanit me gurë)
- PRERJA E FLOKËVE DHE DALJA NGA IHRAMI
- VIZITA E TAVAFIT
- SA'J (ata që nuk kryejnë sa'jin pas tavafit të kudumit)
- TAVAFI I LAMTUMIRËS

Haxhi kiran

Haxhi i kiranit do të thotë të kryesh umrenë dhe haxhin bashkërisht me një nijet në muajt e haxhit të të njëjtit vit. Etapat e kryerjes së tij janë si më poshtë:

ETAPAT E KRYERJES SË HAXHIT KIRAN

- IHRAM ME NIJETIN E UMRESË DHE HAXHIT
- TAVAFI I UMRESË
- SA'J
- SHËNIM. Në këtë etapë nuk bëhet prerja e flokëve dhe dalja nga ihrami.
- TAVAFI I KUDUMIT
- QËNDRIMI NË ARAFAT
- QËNDRIMI NË MUZDELIFE
- MINA (goditja e shejtanit me gurë)
- KURBANI
- PRERJA E FLOKËVE DHE DALJA NGA IHRAMI
- TAVAFI I VIZITËS
- TAVAFI I LAMTUMIRËS



127



Umreja



Fjala umre ka kuptimin 'vizitë'. Si term, umreja nënkupton 'hyrjen e personit në ihram pa qenë i kushtëzuar nga pikëpamja kohore, bërjen tavaf të Qabesë, kryerjen e sa'jit mes Safasë dhe Merues, prerjen e flokëve dhe daljen nga ihrami'.

Umreja ka dy farze: ihram dhe tavaf. Ndër këta ihrami është kusht, kurse tavafi është shtyllë e tij, ndërsa vaxhibet janë sa'ji dhe prerja e flokëve e më pas dalja nga ihrami.

Në veçanti umreja e kryer në muajin e Ramazanit ka shumë sevape. Hz. Pejgamberi urdhëron kështu në lidhje me umrenë:



"Umreja fshin gjynahet e bëra nga njëra umre deri te tjetra" (*Muslim, Haxh, 437*).

"Sevapi i umresë së kryer në Ra mazan është ekuivalent me sevapin e një haxhi" (*Ibni Maxhe, Menasik, 45*).

Për umrenë nuk ka një kohë të caktuar. Ajo mund të kryhet në çdo kohë. Mirëpo është konsideruar mekruh nëse kryhet duke filluar që nga mëngjesi i ditës së Arefesë e deri në akshamin e ditës së katërt të Bajramit.

Kryerja e umresë është si më poshtë:

Ata që dëshirojnë të kryejnë umre, pasi të kenë bërë përgatitjet e nevojshme dhe të kenë falur dy rekate të namazit të ihramit, bëjnë nijet duke thënë: "Allahu im! Dua të kryej umrenë për pëlqimin tënd. Lehtësoje këtë dhe pranoje!" Më pas shprehin 'telbije' dhe hyjnë në ihram. Pasi të kenë hyrë në ihram në këtë formë bëjnë tavaf Qabenë sipas mënyrës së duhur. Kështu umreja konsiderohet e plotësuar.

Ata që mbeten jashtë kufijve të mikatit hyjnë në ihram për umre në kufijtë e mikatit ose më para tyre. Ata që gjenden në zonën Harem hyjnë në ihram duke dalë nga zona e Haremit. Ndërsa ata që gjenden mes zonës së Haremit dhe kufijve të Mikatit (pra në zonën Hill) hyjnë në ihram aty ku gjenden.

Ata që shkojnë nga Turqia dhe dëshirojnë të kryejnë umre gjatë kohës që gjenden në Mekë, venë në "Ten'im", e cila ndodhet mbi autostradën Medine-Mekë dhe afërsisht 5 km larg el-Haremu'sh-Sherifit, ku edhe aty hyjnë në ihram. Aktualisht këtu gjendet "Mesxhidi i Hz. Aishes".

Në umre nuk ka detyrime si tavafi i Kudumit, qëndrimi në Arafat dhe Muzdelife, goditja me gurë e shejtanit dhe tavafi i lamtumirës.

7

Çfarë përfitojnë individ dhe shoqëria nga adhurimi i haxhit?

Haxhi është një adhurim që thekson universalitetin e Islamit. Është një ndër demonstrimet më të bukura të unitetit dhe bashkimit të muslimanëve. Pa bërë dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, shteti dhe kulture, ai bashkon besimtarët rreth parimeve të vëllazërisë dhe barazisë. Afrimiteti i besimtarëve me njëri-tjetrin mundëson që të njohin njëri-tjetrin dhe po ashtu kultura të ndryshme. Kjo bëhet shkak që të formohet ndërgjegjja e përkatësisë islame.

Haxhi, i cili mundëson bashkimin e muslimanëve që vijnë nga vende të ndryshme të botës me të njëjtin qëllim, kontribuon edhe në formimin e vetëdijes së vëllazërisë së përbashkët mes muslimanëve. Miliona muslimanë me gjuhë, ngjyra, raca, shtete e kultura të ndryshme, po ashtu edhe që janë në pozita të ndryshme sociale a ekonomike, perceptojnë të njëjtin besim dhe ndjenja, perceptojnë se janë vëllezër, se janë një tërësi dhe e jetojnë personalisht haxhin. Në këtë mënyrë, haxhi është një mundësi e pasqyruar për afrimitetin e muslimanëve.

Nga ana tjetër haxhi ka qenë një kuvend dhe qendër dijeje, në të cilin janë takuar, njohur dhe kanë diskutuar dijetarë të ardhur nga zona të ndryshme për shekuj të tërë. Në veçanti në punimet e disa dijetarëve që ishin informuar për ide të reja, për vepra të reja në të shkuarën, me rastin e haxhit, janë përjetuar ndryshime dhe zhvillime serioze.

Muslimanët, të cilët vijnë në Qabe nga çdo anë e botës, realizojnë të njëjtat veprime në të njëjtën mënyrë, edhe pse nuk kanë diskutuar më parë mes tyre. Kështu muslimanët, pa qenë të informuar për njëri-tjetrin, shohin se po kryejnë të njëjtat përpjekje për të arritur drejt idealeve të njëjta. Ndërkohë bëhen të vetëdijshëm se miliona njerëz si ata ndajnë të njëjtin qëllim. Haxhi thekson realitetin se, në cilindo vend të botës që të jetojnë, të gjithë muslimanët zotërojnë vlera të përbashkëta dhe se këto vlera krijojnë bazën e përbashkët të tyre. Duatë dhe pendimet që shprehen në haxh pranojnë. Kështu ata që plotësojnë këtë adhurim, duke u pastruar nga gabimet dhe gjynahet e mëparshme, kthehen në jetën e tyre të përditshme me një gjallërim dhe vetëdije të re:



“Kushdo që bën haxh për Allahun dhe shmanget nga fjalët a sjelljet e këqija (që nuk i përshtaten pëlqimit të Allahut) dhe nga rebelimi ndaj Allahut (përveç të drejtës së rob-it), kthehet nga haxhi njësoj si dita kur e ka lindur nëna (i pastruar nga gjynahet)” (*Buhari, Haxh, 4; Nesai, Menasiku'l-Haxh, 4; Muslim, Haxh, 438, I, 983*).

“Haxhinjtë dhe ata që kryejnë umre janë në pozitën e delegatëve të Allahut. Nëse i bëjnë dua, do t'u përgjigjet duave, nëse kërkojnë falje nga Ai, i fal ata” (*Ibn Maxhe, Menasik, 5*).



Kurban



Brendia e kurbanit

Kurbanit, i cili në fjalor zë vend me kuptimin ‘të afrohesh, diçka që bëhet shkak për të mundësuar afrimitet ndaj Allahut’, si term do të thotë ‘prerje sipas metodës së duhur e kafshëve që plotësojnë kushtet e caktuara në një kohë të caktuar me qëllim adhurimi, ose kurbanit i prerë në këtë mënyrë’.

Praktika e prerjes së kurbanit, e cila e ka shoqëruar njerëzimin që në fillimet e saj, duke lënë mënjanë dallimet mes formës dhe qëllimit, ka qenë një mënyrë adhurimi që ekzistonte thuajse në të gjitha fetë. Si rrjedhojë, në Kur'anin Famëlartë flitet se dy djem të Hz. Adem-it i kanë dhuruar kurban Allahut (*Maide, 5/27*); ndërsa në një ajet tjetër aludohet se te të gjitha fetë hyjnore është vendosur dispozita e kurbanit (*Haxh, 22/34*). Kurbanit ka zënë vend edhe në Islam dhe që nga hershmëria e deri në ditët e sotme, muslimanët kanë treguar përkushtim që të kryejnë me një emocion të madh këtë adhurim.



Të presësh kurban me nijetin e adhurimit në Bajramin e Kurbanit është vaxhib për muslimanët e pasur, të cilët bartin edhe kushtet e tjera të nevojshme. Një pjesë e dijetarëve janë në mendimin se ky është një sunnet muekkek.

Kurbani theksohet fort në mjaft hadithe fisnike.

Hz. Pejgamberi asnjëherë nuk e ka braktisur prerjen e kurbanit.



“Kushdo që ka mundësi, por nuk pret kurban, nuk duhet t’i afrohet mesxhidit tonë” (Ibn Maxhe, “Edahi”, 2; Musned, Ahmed b. Hanbel, II, 321). “O njerëz, për çdo familje, të presë kurban çdo vit, është vaxhib.” (Tirmidhi, “Edahi”, 18; Ibn Maxhe, “Edahi”, 2).

Në mënyrë që dikush të jetë përgjegjës për prerjen e kurbanit kërkohen katër kushte:

1. Të jesh musliman.
2. Të jesh me mendje të shëndoshë dhe të kesh arritur në moshën e pjekurisë.
3. Të jesh vendës (të mos jesh udhëtar).
4. Të jesh i pasur fetarisht.



Personat që janë në pozitën e udhëtarit fetarisht, megjithëse nuk janë përgjegjës me prerjen e kurbanit, për ta nuk ka ndonjë pengesë në prerjen e tij. Është më mirë që të presin kurban në situatat kur prerja e kurbanit nuk është shumë e vështirë dhe kështu të marrin sevapin e kurbanit që kanë prerë.

Pasuria fetare që e bën personin përgjegjës për kurban nënkupton zotërimin e pasurisë në sasinë e nisabit, përveç nevojave themelore, qoftë në cilësi rentabël apo jo. Më lart kemi thënë se muslimanët që zotërojnë pasuri në këtë nivel janë përgjegjës

edhe për dhënien e sadakasë së fitrit.

Edhe nisabi i kurbanit është i njëjtë me kriterin e pasurisë që kërkohet te sadakaja e fitrit, pra sipas kësaj, nevojitet që personi të ketë mundësi financiare minimale përveç borxheve dhe nevojave themelore. E thënë ndryshe, personi, kursimet e të cilit arrijnë në vlerën 80,18 gr flori përveç nevojave themelore, është përgjegjës me prerjen e kurbanit.

Ashtu si thuajse në çdo adhurim, edhe në adhurimin e kurbanit gjendet simbolizimi i afrimitetit shpirtërisht me Allahun, shprehjes së sakrificave për Të dhe i nënshtrimit ndaj Tij. Pa dyshim që njeriu është një qenie që ndien nevojë të krijojë afrimet me hyjnoren. Sipas fesë sonë, Islamit, rrugët për t'u afruar me fuqinë krijuese janë të pafund. Kurhani që gjendet te të gjitha fetë hyjnore dhe që bëhet shkak për mundësimin e afrimitetit me Allahun, është vetëm njëra prej këtyre rrugëve. Për më tepër, duke theksuar në Kur'an se nuk është gjaku dhe mishi i kurbanit ai që do të arrijë tek Allahu, por ndjeshmëria fetare (virtutshmëria) e atyre që plotësojnë këtë adhurim, tërhiqet vëmendja se përtej formës së afrimitetit me atë që është hyjnore, thelbësore është brendia. Nga ana tjetër tërhiqet vëmendja mbi përshtatshmërinë dhe sinjeritetin. Përveç kësaj, sa herë që besimtarët presin kurban, freskojnë kujtimin e sprovës së suksesshme që dhanë Hz. Ibrahim dhe djali i tij, Hz. Ismaili, në lidhje me bindjen dhe nënshtrimin ndaj urdhërësës së Allahut dhe tregojnë me një sjellje simbolizuese që janë të gatshëm për një bindje të ngjashme.



Le të kujtojmë

- Kurhani, ashtu si në shembullin e Hz. Ibrahimit dhe Hz. Ismailit, nënkupton demonstrimin e nënshtrimit të pakushtëzueshëm ndaj urdhrave hyjnorë, por demonstroi edhe sakrifikimin ndaj së shenjtës të përfitimeve dhe të vlerave që duam shumë, e thënë ndryshe, sakrifikimin e tyre ndaj Allahut.
- Kurhani, përtej therjes së kafshës, për të cilën ka disa kushte, nënkupton parashtrimin ndaj Allahut të asaj që ka dhuruar Allahu, me qetësi dhe prehje zemre.
- Adhurimi i kurbanit është një tërësi urtësish, është një thirrje ndaj zemrave të ngurtësuara për shkak të vështirësive të kohës, që kanë harruar vdekjen dhe të përtejmen, që thekson se 'qenia' është e fundme.

Përveç ditëve të Bajramit të Kurbanit, qindra e mijëra kafshë priten edhe në ditët e tjera për nevojat e njerëzve. Por prej tyre, në përgjithësi përfitojnë ata që kanë mundësitë materiale. Ndërsa kurhani është një adhurim i bazuar në ndarjen e tij. Në këtë adhurim mirësia që jep Allahu ndahet konkretisht me të varfrit. Nga mishrat dhe lëkurat e kafshëve të prera për hir të Allahut përfitojnë mjaft të varfër. Therja e kafshëve, e cila në kohë të tjera pritet vetëm me qëllim ushqimi dhe është kryesisht një ngjarje ekonomike, në kurban fiton një dimension fetar dhe moral. Te kurhani nuk dalin në plan të parë vetëm interesat vetjake, por edhe ato shoqërore. Nga kjo pikëpamje, kurhani është një shembull njerëzor, të cilin feja islame e ka konsideruar legjitim dhe sakrificë me natyrë njerëzore e sociale.

Si përfundim, përcaktimi legjitim i kurbanit dhe zhvillimi i vetëdijes së ndihmesës bazohet në konceptimin e sakrificës, afrimitetit shoqëror dhe altruizmit. Kështu vlerësimi dhe kuptimi i adhurimit të kurbanit, pa devijuar nga qëllimi i tij, adhurimi i cili bazohet në një konceptim kaq të bukur, bart një rëndësi të veçantë.





“Thuaj: ‘Në të vërtetë, namazi im, kurbanu im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve’” (En’am, 6/162).

Therja e kurbanit

Së pari nuk duhet të harrojmë se kurbanu është mbi të gjitha një adhurim. Plotësimi i këtij adhurimi realizohet bashkë me therjen e kafshëve që bartin cilësitë e nevojshme. Duke u nisur nga kjo nevojitet që therjen ta kryejnë personat e aftë. Sepse mosmundimi i kafshëve gjatë therjes dhe moscenimi i parimit të dhembshurisë në Islam është i një rëndësie të veçantë. Nga ana tjetër, realizimi në kuadër të rregullave të therjes në mënyrë të përshtatshme është një çështje që lidhet drejtpërdrejt me shëndetin. Përveç kësaj, është e rëndësishme edhe që të mos bëhemi shkak për ndotjen e mjedisit pas prerjes. Edhe kjo ka të bëjë me dëshirën për një mjedis të pastër. Kur marrim parasysh të gjitha këto kup-tohet se therja e kurbanit është një procedurë shumëdimensionale. Nga kjo pikëpamje, ka shumë rëndësi therja në formë të saktë sa u përket parimeve që urdhërojnë kryerjen më së miri të çdo veprimi në fenë islame.

Dispozita fetare në lidhje me therjen e kurbanit

Kurbanu bëhet nga disa lloje kafshësh, të tilla si: delja, dhia, deveja dhe gjedhët. Delja dhe dhia mund të theren në emër të një personi, ndërsa deveja në emër të më e shumta shtatë personave.

Është kusht që delja apo dhia, e cila do të theret si kurban, të jetë më e madhe se një vjeç; gjedhët më shumë se dy vjeç, ndërsa deveja të jetë në moshën pesëvjeçare. Ndërkaq mund të bëhet kurban edhe një mëshqerrë shtatë-tetëmuajshe, e cila ngjan sikur të ishte një vjeç.

Koha e therjes së kurbanit është dita e parë, e dytë dhe e tretë e Bajramit të Kurbanit. Mirëpo është më e virtytshme therja në ditën e parë. Koha e parë e prerjes së kurbanit nis pasi të jetë falur namazi i Bajramit. Në vendet ku nuk falet namazi i Bajramit, kurbanu mund të pritët pas kohës së agimit të ditës së Bajramit. Kur pritët kurbanu, kafsha drejtohet drejt kiblës. Pritët duke thënë ‘Bismil-lahi Allahu ekber’. Kurbanin, nëse është e mundur, duhet ta presë i zoti i shtëpisë, nëse jo duhet të porosisë një musliman që e sheh të përshtatshëm dhe nëse nuk ndien ndonjë shqetësim, edhe ai vetë duhet të marrë pjesë në procesin e therjes. Nëse fjala bismil-lah nuk thuhet qëllimisht, mishi i kurbanit nuk hahet. Është mirë që gjatë therjes së kurbanit të këndohet ajeti: “Thuaj: ‘Në të vërtetë, namazi im, kurbanu im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve’” (En’am, 6/162).

Të sillemi mirë ndaj kafshës që do të pritët si kurban, ta dërgojmë me butësi kafshën në vendin e therjes dhe ta therim atë pa e torturuar, duke përdorur thikë të mprehtë, janë që të gjitha detyra fetare.

Nga mishi i kurbanit të zotimit nuk mund të hajë i zoti i kurbanit, fëmijët, nipërit dhe mbesat, nëna-babai, gjyshërit dhe gjyshet, si dhe personat që janë të pasur fetarisht.

Është mustehab që, së paku një e treta e kurbanit t’u shpërndahet të varfërve. Sepse qëllimi më i rëndësishëm në therjen e kurbanit është të sigurojë hyrjen e mishit në shtëpinë e të varfërve. Duke u nisur nga kjo, më e përshtatshme është ndarja e mishit të kurbanit në tri pjesë: njërën për personat që nuk kanë mundësi të presin kurban, një pjesë t’ua dhurojmë të afërmeve, të njohurve dhe fqinjëve, ndërsa tjetrën ta lëmë mënjane për familjen. Nëse pjesëtarët e familjes së personit që ther kurban janë të shumtë në numër dhe nuk kanë mundësi të mira ekonomike, mund ta lërë mënjane të gjithë mishin e kurbanit dhe të mos e shpërndajë atë. Konsiderohet si një sjellje e bukur t’u ofrojmë edhe fqinjëve jomuslimanë nga mishi i kurbanit.

Lëkura e kurbanit nuk shitet, por mund t’u jepet të varfërve.

**Të studiojmë – Të mësojmë**

Studioni dhe diskutoni mbi arsyet se kur një kafshë nuk mund të bëhet kurban.

Rregullat shëndetësore që lidhen me therjen e kurbanit

Feja jonë urdhëron që ta kryejmë çdo punë në mënyrën më të bukur. Koncepti 'ihsan', i cili vjen në kuptimin e kryerjes së çfarëdolloj pune sipas rregullave dhe në mënyrën më të bukur, ka një vend të rëndësishëm në fenë tonë. Pejgamberi ynë ka urdhëruar: "Kur të therni kafshën, thereni bukur." Në mënyrë që adhurimi i kurbanit të kryhet në formën më të mirë dhe më të bukur, nevojitet që therja të bëhet nga persona të aftë, me qëllim që të mos e torturojnë kafshën. Përveç kësaj është shumë e rëndësishme që kurbanit të theret në një vend të përshtatshëm, mos therja në rrugë, si dhe respektimi me përkushtim i rregullave të nevojshme të pastërtisë është shumë e rëndësishme. Në këtë çështje duhet të respektohen rregullat e pastërtisë dhe të shëndetit që përcaktohen duke u mbajtur parasysh dobia publike.

Një rëndësi të veçantë kanë plotësimi i adhurimit të kurbanit, si dhe parimet dhe qëllimet që duhet të respektohen gjatë plotësimit të adhurimit. Tregimi i mëshirës dhe i dhembshurisë ndaj krijesës, pastërtia dhe respekti ndaj njeriut janë ndër ndjeshmëritë themelore. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që të respektohen maksimalisht rregullat që lidhen me shëndetin, duke vepruar në mënyrë të vetëdijshme gjatë therjes së kurbanit. Po ashtu, duhet të qëndrojmë larg kriterëve që shkaktojnë ndonjë shqetësim përreth, si dhe të shmangemi nga sjelljet e pavetëdijshme dhe të pashëndetshme. Njerëzit që kryejnë adhurime sipas këtyre kriterëve nevojitet të jenë më të ndjeshëm.

Llojet e kurbanit

Në dallim nga kurbanit që theret në Bajramin e Kurbanit, ka edhe lloje të tjera kurbanit që priten përsëri me nijet adhurimi. Llojet e kurbanit të kësaj natyre mund t'i radhisim si më poshtë:

1. Kurbanit i prerë në Bajramin e Kurbanit (ud'hijje).
 2. Kurbanit i zotimit.
 3. Kurbanit i kushtimit (Kurbanit që pritet për fëmijët e sapolindur / Kurbanit që pritet në shenjë falënderimi ndaj Allahut për një fëmijë të sapolindur quhet 'Akika'.) Kurbanit akika mund të pritet duke filluar që nga dita kur lind fëmija e deri kur të arrijë në moshën e pjekurisë. Mirëpo është më e virtytshme që të pritet ditën e shtatë. Në përgjithësi, ditën e shtatë të lindjes vendoset emri i fëmijës dhe jepet një sasi si sadaka.
 4. Kurbanit i haxhit (është kurbanit i falënderimit / hedj, të cilin e presin personat që kryejnë haxhin e llojit kiran ose temettu).
 5. Janë kurbanët e dënimit që priten për shkak të disa mangësive në haxh.
- Sa i përket therjes së kurbanit, nëse personi ka lënë testament para se të ndërrojë jetë dhe ka lënë pasuri aq sa ta përballojë këtë, trashëgimtarët janë të detyruar ta çojnë në fund këtë testament.



Tekbiret e teshrikut

Dita para Bajramit të Kurbanit quhet 'dita e Arefesë'. Duke u nisur nga kalendari hënor, dita e Arefesë është dita e nëntë e muajit dhilhixh-xhe. Në Bajramin e Ramazanit nuk ka Arefe. Pas njëzet e tre kohësh namazi, duke filluar nga namazi i sabahut të ditës së Arefesë e deri në namazin e ikindisë së ditës së katërt të Bajramit këndohen 'tekbiret e teshrikut'. Tekbiret e teshrikut janë si në vijim:

اللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَاللَّهُ أَكْبَرُ اللَّهُ أَكْبَرُ وَ لِلَّهِ الْحَمْدُ

"Allahu është i madh, Allahu është i madh. Nuk ka zot tjetër veç Allahut. Allahu është i madh. Falënderimi i përket Atij."

Tekbiret e teshrikut, sipas pjesës më të madhe të juristëve fetarë, janë vaxhib. Ka edhe që e quajnë si sunnet.

Çfarë përfitojnë individit dhe shoqëria nga adhurimi i kurbanit?

134



"Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi juaj"
(Haxh, 22/37).

Muslimani, jo vetëm fiton sevap duke prerë kurban, por nëpërmjet kësaj sakrifice të bukur ndihmon edhe të varfrit. Ashtu si te të gjithë adhurimet e bukura, edhe kurbanit e afron robin me Allahun. Në Kur'an bëhet e ditur se tek Allahu nuk do të arrijë mishi dhe gjaku, por devotshmëritë e atyre që therin kurban. Kjo do të thotë se për sa kohë njerëzit janë të sinqertë, funksioni më i rëndësishëm i kurbanit është afrimiteti i robit me Allahun.

Personi, duke prerë kurban, përjeton qetësinë shpirtërore të falënderimit të Allahut të Lartmadhëruar. Përjetimi i qetësisë së plotësimi të borxhit dhe falënderimit ndaj mirësive që i janë dhuruar është një lumturi e posaçme për njeriun.

Kurbani luan një rol të rëndësishëm në mposhtjen e prirjeve të egoizmit dhe kopracisë. Ai e pajis njeriun me cilësinë e bujarisë dhe bëhet shkak për përfitimin e vetëdijes së robërimit.



“Për çdo popull, Ne kemi caktuar një ritual, që ata të përmendin emrin e Allahut gjatë flijimit të kafshëve, të cilat Ai ua ka dhuruar për ushqim” (Haxh, 22/34).

Kurbani mban gjallë shpirtin e vëllazërisë, të solidaritetit dhe të ndihmesës në shoqëri. Jep kontribut në realizimin e drejtësisë sociale. Rolin e tij mund ta shohim më qartë sidomos në vende ku nuk ekziston mundësia për të blerë mish, ose aty ku gjenden të varfër me mundësi shumë të kufizuara. Kjo i ngulit të pasurit zakonin e ndarjes së pasurisë me nevojtarët në mënyrë të përshtatshme me pëlqimin e Allahut, por bëhet edhe një mjet që i varfri ta ndiejë veten si një anëtar aktiv i shoqërisë së cilës i përket.

Mund të flitet edhe për disa dobi të kurbanit në aspekt të jetës shoqërore ekonomike. Kurbani kontribuon edhe në zhvillimin e industrisë së ushqimit dhe industrisë së lekurës, të cilat janë të lidhura me blegtorinë në shoqëri.



“Devetë dhe gjedhët i kemi bërë për ju si një nga ritet e Allahut për flijim dhe ju keni dobi nga ato. Prandaj, përmendeni emrin e Allahut mbi to, ndërsa i merrni (për t’i therur). Kur ato të bien në tokë, hani prej (mishit të) tyre dhe ushqeni edhe atë që lyp, edhe atë që nuk lyp. Kështu pra, Ne i kemi vënë ato në shërbimin tuaj, që ju të jeni mirënjohës” (Haxh, 22/36).



Përmbledhja e kapitullit



Haxhi, si njëri prej adhurimeve themelore të Islamit, nënkupton vizitën e Qabesë dhe disa vendeve të shenjta rreth saj në një periudhë të caktuar kohe dhe sipas metodës së duhur, si dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme për këtë rast.

Haxhi kryhet vetëm në “muajt e haxhit”. Muajt e haxhit janë muajt sheuual dhe dhilkade nga muajt hënorë dhe dhjetëditëshi i parë i muajit dhilhixh-xhe.

Për çdo musliman që është i aftë, kryerja e haxhit një herë në vit është farz. Ai që plotëson adhurimin e haxhit quhet haxhi.

Umre do të thotë të bësh tavaf Qabenë dhe të bësh sa’j mes Safasë e Merues, sipas metodës së duhur dhe pa qenë i kushtëzuar nga një kohë e caktuar.

Haxhi mundëson që çdo vit të bashkohen miliona muslimanë me gjuhë, ngjyra, shtete, gjeografi dhe kultura të ndryshme, por me synim dhe qëllim të njëjtë; bën të mundur që të adhurojnë të gjithë së bashku, të orientohen drejt Allahut, të njihen dhe afrohen me njëri-tjetrin, të diskutojnë problemet e njerëzimit dhe të mendojnë mbi zgjidhjet e këtyre problemeve. Muslimanët, të cilët gjatë haxhit heqin veshjet e tyre të përditshme dhe hyjnë në ihram, përfetojnë dhe mësojnë personalisht të mos mburren me pozitën, postet dhe pasurinë e tyre, të mos harrojnë barazinë ndër njerëzit, ringjalljen dhe mbledhjen bashkërisht.



Haxhi ka tri farze: ihrami, kryerja e vakfes (qëndrimet) në Arafat dhe tavafi në Qabe. Haxhi ka edhe vaxhibe bashkë me sunnete.

Haxhi kryhet në tri mënyra: në ifrad, temettu dhe kiran.

Haxhi ifrad është haxhi që kryhet pa umre. Brenda muajve të haxhit të të njëjtit vit, personi hyn në ihram me nijetin e haxhit pa kryer umre dhe nëse kryen vetëm haxh atëherë konsiderohet se ka kryer haxh ifrad.

Haxhi temettu është haxhi që kryhet brenda muajve të haxhit të të njëjtit vit dhe që bëhet pas kryerjes së umresë, daljes nga ihrami dhe hyrjes sërish në ihram për të kryer haxh.

Haxhi kiran do të thotë që me të njëjtin ihram të bësh nijet me umre dhe haxh.

Kurban quhet kafsha që pritët për hir të Allahut dhe që bart cilësi të caktuara. Në Bajramin e Kurbanit, prerja e kurbanit nga muslimanët, të cilët janë të pasur fetarisht, të lirë dhe vendës (që nuk janë udhëtarë) është vaxhib.

Pasuria fetare që kërkohet në të qenët vaxhib të kurbanit është pasuria që kërkohet në sadakanë e fitrit. Kurban bëhet nga delja, dhia, deveja dhe gjedhët. Delja dhe dhia bëhen kurban në emër të vetëm një personi, ndërsa deveja bëhet kurban në emër të më e shumta shtatë personave.

Është kusht që delja dhe dhia të jenë të moshës një vit e lart, gjedhët dy vjeç, ndërsa deveja të ketë mbushur plot pesë vjeç. Por, edhe një mëshqerrë shtatë-tetëmuajshe, e cila është e bëshme dhe duket sa një mëshqerrë njëvjeçare, mund të bëhet kurban. Kur pritët kurban kafsha shtrihet drejt kibles dhe pritët duke thënë "Bismil-lahi Allahu ekber".

Kurban mban gjallë shpirtin e vëllazërisë, të solidaritetit dhe të ndihmesës në shoqëri. Ai kontribuon në realizimin e drejtësisë sociale. Kurban ngulit tek i pasuri traditën e ndarjes së pasurisë me nevojtarët në përputhje me pëlqimin e Allahut. Ai bëhet shkak që edhe i varfri, nëpërmjet kësaj ndihmese, ta ndiejë veten si një anëtar aktiv i shoqërisë ku jeton.



Të rishikojmë kapitullin



1. Për kë është farz haxhi?
2. A ka një kohë të caktuar për kryerjen e haxhit? A mund të kryhet haxh në të gjithë muajt e vitit?
3. Ç'dallim ka mes umresë dhe haxhit?
4. Në ç'kuptim vjen tavafi, sa'ji dhe vakfe? A kanë kuptime simbolike?
5. A ka përfitime haxhi në aspekt individual dhe shoqëror?
6. Kush është përgjegjës me adhurimin e kurbanit?
7. Cili është funksioni i kurbanit në ndihmesën dhe afrimitetin shoqëror?



Pyetje vlerësuese



1. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është një ndër kushtet e të qenit farz të haxhit?

- A) Të jesh musliman
- B) Të kesh martuar fëmijët
- C) Të jesh i aftë për të vajtur në haxh
- D) Të zotërosh pasuri aq sa niveli i nisabit

2) Cila nga alternativat e mëposhtme është njëra prej shtyllave të ihramit

- A) Të kryesh pastrim të përgjithshëm të trupit
- B) Të marrësh abdes në rast se nuk është e mundur marrja e guslit
- C) Telbija
- D) Veshja e ihramit

3. Ku gjendet Muzdelife?

- A) Në Arafat
- B) Brenda el-Mekketu'l-Mukerreme
- C) Brenda el-Medinetu'l-Muneuere
- D) Mes Arafatit dhe Minasë

4. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është një ndër llojet e haxhit në aspekt të kryerjes?

- A) Umreja
- B) Ifrad
- C) Kiran
- D) Temettu

5. Cila nga pikat e mëposhtmet është e nevojshme për të qenë përgjegjës me prerjen e kurbanit?

- A) Duhet të jesh i pasur fetarisht
- B) Edhe personat që nuk janë të pasur fetarisht janë përgjegjës për prerjen e kurbanit
- C) Është kusht të jesh mashkull
- D) Është kusht të banosh në qytet

adhurimi im

KAPITULLI

7



Duaja dhe pendimi

1. Koncepti i duasë dhe brendia e tij
2. Përkufizimi i duasë dhe rëndësia e saj
3. Duaja si mjet komunikimi
4. Çfarë përfiton njeriu nga duaja?
5. Shembuj duash nga Kur'ani dhe nga Hz. Pejgamberi
6. Koncepti i pendimit dhe brendia e tij
7. Vendi i pendimit në jetën e njeriut
8. Shembuj pendimesh nga Kur'ani Famëlartë



RRETH KAPITULLIT

Në këtë kapitull:

- Do të trajtohet duaja si thelb i adhurimit, tregohet brendia dhe rëndësia e duasë në fenë islame dhe do të ketë një vështrim edhe mbi atë çka përfiton njeriu prej duasë.
- Në vijim jepen shembuj duash që përmenden në Kur'an dhe në Sunnet, si dhe shpjegohet brendia dhe rëndësia e pendimit. Po ashtu, vihet theksi mbi vendin e pendimit në jetën e njeriut, por jepen edhe shembuj mbi pendimin në Kur'anin Famëlartë.

SYNIMET E KËTIJ KAPITULLI

Pasi të jetë trajtuar ky kapitull:

1. Do të mund të kuptohet brendia e duasë dhe e pendimit.
2. Do të mund të perceptohen disa pika të rëndësishme në lidhje me etikën e duasë.
3. Do të shihen shembuj duash të cituara nga Kur'ani dhe Sunneti.
4. Do të mund të krijoni një ide në lidhje me vendin dhe rëndësinë e duasë e të pendimit në jetën e personit.

NDËRSA MËSONI KËTË KAPITULL

1. Mundohuni të merrni informacione edhe mbi të dhëna që lidhen me etikën e duasë.
2. Studioni dhe mësoni kushtet që duhen plotësuar për pranimin e duasë.
3. Ç'dallim ka mes pendimit dhe kërkimit të faljes? Studioni.
4. Mësoni kuptimet e emrave 'Teuab' dhe 'Muxhib' nga Esmau'l-Husna (emrat e bukur) të Allahut. Mendoni mbi lidhjen e këtyre emrave me çështjen tonë.
5. Studioni ajetet e duasë në Kur'anin Famëlartë dhe hadithet që lidhen me duanë.

1**Koncepti dhe brendia e duasë**

- *Duaja është strehimi i njeriut te Zoti i tij, orientimi drejt Tij.*
- *Duaja është ngushëllimi dhe burimi më i madh i shpresës te njeriu.*
- *Duaja është orientimi i krijesës drejt Krijuesit.*
- *Duaja është shpirti dhe thelbi i adhurimit.*

Duaja është një fjalë arabe që ka kuptimin të thërrasësh, të përgjërohesh, të lutesh dhe të kërkosh ndihmë. Ajo nënkupton shprehjen e përgjërimit ndaj Allahut, shprehjen e dëshirës ndaj Tij, paraqitjen e dëshirave dhe kërkesave kundrejt Tij. Duaja nënkupton shprehjen e dëshirës dhe të kërkesës ndaj Allahut duke iu drejtuar me të gjithë qenien. Nëse njeriu i drejtohet Krijuesit në këtë mënyrë, as Krijuesi nuk e lë pa ia shpërblyer.

Duaja nënkupton strehimin e njeriut te Zoti, orientimin ndaj Tij dhe kërkesës që Ai të jetë ndihmës për të. Në të vërtetë, kjo situatë është një veçori që vjen prej kur krijohet njeriu. Njeriu, duke bërë dua gjen prehje si shpirtërisht, ashtu edhe fizikisht. Njeriu që frikësohet, që kaplohet në shqetësim, që ndihet i vetmuar, që e ndien veten të dobët dhe të paaftë, që ka probleme dhe dëshira, e përqafton duanë për të shpëtuar nga vështirësitë dhe për të pasur atë që dëshiron. Njeriu drejtohet drejt duasë sidomos në rastet kur ka probleme të pazgjidshme ose kur gjendet në vështirësi. Duaja është ngushëllimi më i madh dhe burimi i shpresës së njeriut.

Duaja është strehimi i krijesës te Krijuesi, paraqitja e përgjërimeve të fshehta, gabimeve të mbuluara, duke qenë në gjendje pendese.

Duaja është orientimi i krijesës ndaj Krijuesit. Është çasti kur zemra mbushet me kënaqësinë hyjnore, kur trupi i lehtësohet ashtu si një zog.

Duaja është një thirrje. Meqenëse asgjë nuk mund të mbetet e fshehtë ndaj Allahut, ajo që është e rëndësishme te kjo thirrje ka të bëjë me përshpirtshmërinë dhe sinqeritetin. Kjo thirrje, qoftë nëse bëhet me fjalë apo thjesht me mendje, nuk ka ndonjë ndryshim. E rëndësishme është të jetë e sinqertë dhe e përshpirtshme. Duke u nisur nga kjo, për sa kohë duatë nuk janë të tilla, pra nuk burojnë nga zemra, do të mbeten të pamjaftueshme në përçimin e të zotit në mirësi.

Duaja është shpirti dhe thelbi i adhurimit. Si rrjedhojë, në çdo rekat të namazit, si adhurimi më gjithëpërfshirës, këndohet surja Fatiha. Ashtu siç dihet, Allahu i Lartmadhëruar, thujse për të treguar si shembull se si duhet të këndohen duatë, ka vendosur fjalitë më të bukura të duasë në suren Fatiha. Në Kur'anin Famëlartë ka edhe shembuj të tjerë që tregojnë se si duhet të bëjmë dua.

Duaja nënkupton shprehjen e dobësisë nga robi kundrejt lartësisë së Allahut, nënkupton kërkimin e mirësisë dhe ndihmës ndaj Krijuesit. Qëllimi në dua është shprehja e duasë nga personi, duke i paraqitur gjendjen Allahut.



2

Përkufizimi i duasë dhe rëndësia e saj



Duaja si koncept fetar nënkupton shprehjen e dëshirës ndaj Krijuesit të Lartmadhëruar me të gjithë qenien dhe kërkimin e diçkaje prej Tij. E thënë ndryshe, robi, duke shprehur dobësinë e tij kundrejt lartësisë së Allahut, kërkon mirësinë dhe ndihmën e Tij nëpërmjet shprehjes së ndjenjave të dashurisë dhe lartësimi. Përveç kësaj, dua quhen edhe shprehjet në trajtë kërkesash që i paraqiten Allahut në përdorimin e përditshëm.

Duaja nuk nënkupton vetëm përgjërëm ndaj Allahut. Ajo është njëkohësisht shprehje e besimit dhe nënshtrimit ndaj Krijuesit. Nga kjo pikëpamje duaja është një demonstrim i besimit dhe vartësisë ndaj Allahut.



Allahu i Lartmadhëruar e vlerëson njeriun që bën dua. Sepse njeriu që bën dua me këtë veprim tregon vartësinë ndaj Allahut të Lartmadhëruar dhe orientimin drejt Tij. Edhe Allahu i Lartmadhëruar pa dyshim që do ta vlerësojë njeriun që orientohet drejt Tij dhe strehohet në lartësinë e Tij. Nga ana tjetër, dikush që gjendet në një situatë kur është e nevojshme duaja, por nuk bën dua, duke u hequr sikur nuk ka nevojë për duanë, me këtë veprim mban një qëndrim që nënkupton se ai nuk ka nevojë për Allahun. Mirëpo është vetëm Allahu i Lartmadhëruar ai që nuk do të ketë nevojë për asgjë. Prandaj edhe Allahu nuk i vlerëson njerëzit që veprojnë kështu. Kuptimi i një ajeti në lidhje me këtë çështje në Kur'anin Famëlartë është si në vijim: "Thuaj: 'Zoti im nuk do t'ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj...'" (*Furkan*, 25/77).

Edhe ajeti në trajtën: “Zoti juaj ka thënë: ‘Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të më adhurojnë, do të hyjnë në xhehennem të poshtëruar!’” (*Mu’min, 40/60*), edhe ky ajet pra tërheq vëmendjen në veçorinë e mospërputhjes së kryerjes së duasë me robërimin.



Në Kur’anin Famëlartë urdhërohet kështu: “Zoti juaj ka thënë: ‘Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem...’” (*Mu’min, 40/60*).

Allahu i Lartmadhëruar kënaqet kur robi strehohet, përgjërohet dhe kërkon ndihmë nga Ai. Sepse kjo situatë nënkupton faktin që robi e njëj fuqinë dhe forcën e pakufishme të Krijuesit, shpreh nevojën që ndien ndaj Tij, pohon se nuk mund ta vijojë ekzistencën pa ndihmesën dhe Mirësinë e Tij.

Nga ana tjetër, duaja formon një lehtësim shpirtëror dhe ndjesor, po ashtu edhe prehje dhe lumturi.

Në fund duaja kontribuon edhe në pastërtinë dhe lartësimin e personit, në të qenit zotërues i ndërgjegjes së ndjeshme dhe në të qenit i vetëdijshëm.

Shkurtimisht duaja është një çelës që hap thesaret e mëshirës së atij që e ka mëshirën të pafund; është një burim force i pashterur ndaj vështirësive dhe dhimbjeve me të cilat përballet personi.



Duaja si mjet komunikimi



Duaja nënkupton shprehjen e saj nëpërmjet paraqitjes së situatës së personit kundrejt Allahut. Nga kjo pikëpamje duaja është një mjet komunikimi pa ndërmjetës mes Allahut dhe personit që beson. Në themel të duasë gjendet besimi dhe nënshtrimi ndaj Allahut. Duaja luan thuajse rolin e një ure ndërmjet njeriut që është i dobët dhe Allahut që i mjafton forca për çdo gjë. Në këtë kuptim duaja është mënyra, nëpërmjet së cilës njeriu arrin tek Allahu në rrugën më të shkurtër.



“Atë e madhërojnë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ata. Ai, me të vërtetë, është i Butë dhe Falës” (*Isra, 17/44; Ra’d, 13/31; Hashr, 59/1; Saff, 61/1; Xhuma, 62/1; Tegabun, 64/1*).



Le të komentojmë

Ç’kuptoni nga hadithi “Duaja është thelbi i adhurimit” (*Tirmidhi, Deauat, 1*)? Komentojeni.



Përgjigjen e pyetjes që iu drejtua Hz. Pejgamberit mbi marrëdhënien ndërmjet Allahut dhe robrit, Kur'ani na e jep me këtë mënyrë:



“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thua ju se) Unë jam afër, u përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë” (Bakara, 2/186).

Nëse lutjet e kërkuara nëpërmjet duasë nuk realizohen menjëherë, kjo nuk do të thotë se dua juaj nuk është pranuar. Realizimi i duasë mund të jetë lënë edhe për në ahiret. Megjithatë, Allahu, edhe dëshirat e dobishme, të cilat i kërkon rob i bën dua në aspekt të jetës së kësaj bote, i fal si një mirësi hyjnore. Hz. Pejgamberi bën të ditur se kërkesa e atij që bën dua, do të realizohet ose menjëherë në këtë botë, ose do të ruhet për në ahiret, ose do të fshihen nga ai aq të këqija sa e mira që ka kërkuar.



“Allahu i shpërblen të gjithë ata që i bëjnë dua atij. Ky shpërblim ose vjen menjëherë në botë, ose ruhet për në ahiret, ose realizohet në përputhje me duanë e shprehur, në formën e lehtësimit të gjynaheve nga ai, mjafton që të mos kërkojë diçka që është gjynah, ose të shkëpusë lidhjet me të afërmit dhe të mos nxitojë” (Tirmidhi, Dea'uat, 133, nr. 3604, V, 582).

Kjo do të thotë se një besimtar nuk duhet të nxitojë kur është fjala për kohën e realizimit të duasë së shprehur. Pejgamberi ynë (s.a.s.) urdhëron kështu:



“Allahu i pranon duatë tuaja. Mirëpo mos nxitoni në pranimin e saj; (mos thoni) bëra dua, por nuk mu pranua” (Buhari, Dea'uat, 22, VII, 153; Muslim, Dhikr, 92, III, 2095).

Pejgamberi urdhëron: “Për sa kohë rob i nuk kërkon diçka që është gjynah, ose nuk dëshiron shpëputjen e marrëdhënies fisnore, dua vazhdon të pranohet” (Muslim, Dhikr, 25, III, 2096).



Le të kujtojmë

Dua është ura që krijon qenia e kufishme, e fundme dhe e dobët, me zotin e fuqisë së pakufishme dhe të pafund.



Të diskutojmë së bashku

Ndani me shokët e klasës përvojat që keni nga jeta juaj në lidhje me duanë!

4

Çfarë përfiton njeriu nga duaja?



Përfitimi më i rëndësishëm nga duaja është prehja e zemrës, e cila njeriut i mundësohet nga dëshira që tregohet ndaj zotit të forcës dhe fuqisë së pafund. Pasi të shprehësh dua, zemra e njeriut mbushet me paqe. Kjo situatë buron nga fakti se rob, orientimin e fundit e kthen drejt Allahut, të cilit i mjafton forca për çdo gjë. Në çdo vështirësi domethënëse, ose në rast të sëmundjeve të pashërueshme, njerëzit që bëjnë dua, në krahasim me ata që nuk bëjnë dua, janë më të qëndrueshëm, më rezistentë.

Çdo njeri që beson te Krijuesi i Lartë bën dua. Është fakt që në çastet e vështira, edhe mosbesimtarët i drejtohen duashë (Junus, 10/12; Lukman, 31/32). Kjo situatë tregon se nevoja e duashë ekziston që prej krijimit të njeriut.

Duaja është një mjet që e afron njeriun me Allahun. Njeriu që bën dua është më i sigurtë në të gjitha lëvizjet dhe sjelljet e tij. Sepse personi që bën dua është i vetëdijshëm që Allahu i Lartmadhëruar di çdo gjë, sheh çdo gjë dhe dëgjon çdo gjë, si rrjedhojë është i vetëdijshëm se nuk ka asgjë që Ai nuk e di.

Duaja bëhet vetëm ndaj Allahut. Nuk bëhet dua ndaj askujt tjetër pos Allahut. Njeriu që bën dua nuk mund të jetë rob ndaj dikujt tjetër veç Allahut.

Njeriu që bën dua miraton dhe pohon ekzistencën, njëjësinë dhe lartësinë e Allahut, falënderon Allahun për mirësitë që ka dhënë, strehohet tek Allahu, dëshiron falje dhe dhembshuri ndaj Allahut, shpreh dëshirë materiale ose shpirtërore ndaj Allahut. Të gjitha këto mundësojnë që njeriu që bën dua të arrijë në një vetëdijësim fetar.

Çasti më i rëndësishëm në jetën e njeriut është periudha kohore kur i orientohet Allahut të Lartmadhëruar dhe qëndrimi kokë më kokë me Të. Njëra prej mjeteve më të bukura të qëndrimit kokë më kokë me Allahun është duaja.



5

Shembuj duash nga Kur'ani dhe Hz. Pejgamberi



Shembuj duash nga Kur'ani dhe Hz. Pejgamberi

- “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, Sunduesit të Ditës së Gjykimit.
- (Allahu im!) Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.
- Udhëzona në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur!” (*Fatiha*, 1/1-7).
- “(Ata thonë:) ‘O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh!” (*Al-u Imran*, 3/8).
- “O Zoti ynë! Na bëj të përlur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përlur ndaj Teje! Tregona ritet e Haxhit dhe pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti!” (*Bakara*, 2/128).
- “Ata thanë: ‘O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit” (*A'raf*, 7/23).
- “Mes robërve të Mi, ishte një grup i cili thoshte: ‘O Zoti ynë, ne kemi besuar, andaj na fal dhe na mëshiro! Ti je më i miri i mëshiruesve!” (*Mu'minun*, 23/109).
- “O Zoti ynë, te Ti mbështetemi, Ty të drejtohem dhe te Ti do të kthehem!” (*Mumtehine*, 60/4)
- “(Musai) tha: ‘O Zoti im, zgjeroma kraharorin tim” (*Ta-Ha*, 20/25)
- “O Zoti im! Njëmend, Unë i kam bërë keq vetes, andaj më fal!” Dhe Ai e fali. Pa dyshim, Ai është Falësi e Mëshirëploti” (*Kasas*, 28/16).
- “S’ka zot tjetër përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!” (*Enbija*, 21/87).
- “Dhe thuaj (o Muhammed!): ‘O Zoti im, fal dhe mëshiro, se Ti je më i miri i mëshiruesve!” (*Mu'minun*, 23/118).
- “O Zoti im, më dhuro dituri dhe më radhit me të mirët!” (*Shuara*, 26/83).
- “O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prekje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!” (*Furkan*, 25/74).
- “Bëj që të vdes si musliman dhe më shoqëro me punëmirët (në botën tjetër!)” (*Jusuf*, 12/101).
- “O Zoti ynë, na jep durim të madh dhe bëna të vdesim muslimanë!” (*A'raf*, 7/126).
- “O Zoti im, më frymëzo të të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, më frymëzo të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!”

(Neml, 27/19).

- “Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit (të xhehennemit)” (Bakara, 2/201).
- “O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët, në ditën kur do të jepet llogari!” (Ibrahim, 14/41).
- “O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!” (Hashr, 59/10).
- “Zoti ynë! Na pajis me durim, na forco këmbët tona dhe na ndihmo kundër këtij populli jobesimtar!” (Bakara, 2/250).
- “Ti je Mbrotësi ynë, andaj falna dhe mëshirona! Ti je më i miri i mëshiruesve!” (A'raf, 7/155).



Të diskutojmë së bashku

Gjeni shembuj të tjerë ajetesh, të cilët përfshijnë dua nga Kur'ani dhe diskutoni mbi ta në klasë.

Shembuj duash nga Pejgamberi ynë i dashur

- “O Allahu im, zotërues i zemrave! Bëje të qëndrueshme zemrën time në fenë tënde” (Tirmidhi, Dea'uat, 124).
- “Allahu im! Kërkoj nga ti dashurinë tënde, dashurinë e atyre që të duan ty dhe më mundëso të dua çdo punë që do të më afrojë me ty” (Tirmidhi, Dea'uat, 73).
- “Allahu im! Bëj që ta duam besimin dhe na e trego të bukur atë. Na bëj që të urrejmë mohimin, kryerjen e gjynaheve dhe rebelimin. Na bëj nga ata që janë në rrugë të drejtë” (Hakim, Dea'uat, 1868).
- “Allahu im! Për jetën time fetare-botërore dhe familjen e pasurinë time kërkoj begati dhe shëndet nga Ti” (Hakim, Dea'uat, 1902).
- “Allahu im! Bashkoi zemrat tona. Rregullo marrëdhënien mes nesh dhe na përço drejt rrugëve të lumturisë. Na nxirr nga errësira në ndriçim dhe më largo si nga gjynahet e mëdha në të hapur, ashtu edhe nga ato në të fshehtë” (Ebu Dau'ud, Salat, 177, 178).
- “Allahu im! Kërkoj prej Teje udhëzim në të drejtë, devotshmëri, nder dhe pasuri (aq sa të më mjaftojë mua)” (Muslim, Dua, 72).
- “Allahu im! Kërkoj prej teje një zemër që të është dorëzuar ty dhe një gjuhë që flet drejt (Tirmidhi, Dea'uat, 23).
- “Allahu im! Mbështetem te ti nga dija e padobishme, nga zemra që nuk frikësohet, nga nefsi i pangopur dhe nga dua e papranuar” (Muslim, Dua, 73; Nesai, Istiadhe, 21).
- “Allahu im! Mbështetem te ti nga vështirësia, mërzia, dobësia, frikësimi, koprracia,

ngurtësimi i zemrës, befasia, poshtërimi dhe përçmimi" (Buhari, *Dea'uat*, 39).

- "Allahu im! Mbështetem te ti nga shprehja e mizorisë dhe pësimi i mizorisë" (Nesai, *Istiadhe*, 14).
- "Allahu im! Mbështetem te ti nga belatë e papërballuara, të rënit në rebelim, aksidentet e padukshme dhe fatkeqësitë që do të gëzojnë armiqtë e mi" (Nesai, *Istiadhe*, 16).
- "Allahu im! Mbështetem te ti nga përfundimi i mirësive që ke dhënë, nga largimi i shëndetit dhe mirësisë që ke dhënë, nga ardhja e dënimit të papritur dhe nga çdo lloj dënimi" (Ebu Dau'ud, *Vitr*, 32).
- "Allahu im! Më bëj mua ndër ata që kryejnë bukuri dhe përfitojnë sihariqin tënd, ndërsa kur kryejnë të këqija dëshirojnë falje!" (Ibn Maxhe, *Edeb*, 57).
- "Allahu im! Fale të bukur përfundimin e të gjitha punëve. Na mbro nga mjerimi i botës dhe dënimi i ahiretit" (Ibn Hibban, *Ed'ije*, 949).
- "Allahu im! Ti je falës, bujar, dëshiron të falësh, më fal edhe mua" (Tirmidhi, *Dea'uat*, 84).

6

Koncepti dhe brendia e pendimit

148

Kuptimi etimologjik i fjalës "teube" është të kthehesh pas. Ndërsa si koncept fetar, teube nënkupton kthimin e robit në rrugën që tregon Allahu, duke braktisur të këqijat dhe gjynahet që ka kryer; po ashtu, nënkupton edhe shprehjen e duave dhe të lutjeve në gjendje pendimi e më pas orientimin drejt Allahut.

Duhet shtuar edhe se është e nevojshme të shprehim teube për shkak të gjynaheve.

Disa kritere të caktuara të teubes nënkuptojnë perceptimin se kryerja e gjynaheve është gabim, se për këtë arsye nevojitet të bëhet pendim, prandaj duhet të vendosësh të shpëtosh nga kjo situatë dhe të ndryshosh drejtim, të vendosësh në mënyrë të prerë që të mos kthehesh më drejt gjynaheve, të kërlesh falje duke u kthyer në rrugën që tregon Ai.

Të ndiesh pendim, të braktisësh gjynahet dhe të vendosësh për të mos u kthyer në gjendjen e mëparshme, nëse ke të drejtë robi mbi vete ta paguash atë dhe të kërlesh falje nga personat ndaj të cilëve ke kryer padrejtësi, të hash ushqim të lejuar dhe të plotësosh farzet, të gjitha këto janë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e pendimit.

Pejgamberi ynë i dashur urdhëron: "Kushdo që ka kryer padrejtësi ndaj dikujt le të kërkojë falje nga ai para se të vijë dita kur të merren nga mirësitë e këtij personi e t'i jepen atij ndaj të cilit ka kryer padrejtësi" (Buhari, *Mezalim*, 10; Ahmed b. Hanbel, *Musned*, II, 506).

Pendimi që kryhet në mënyrë të sinqertë, në mënyrë serioze dhe për të mos u kthyer më drejt gjynahut, quhet "teube nasuh". Në Kur'anin Famëlartë urdhërohet që të shprehim teube me teube nasuh:

Teubeja nis bashkë me Hz. Ademin.



“O ju që keni besuar! Kthehuni tek Allahu me një pendim të sinqertë, që Zoti juaj t’ju shlyejë gabimet e t’ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, ditën kur Allahu nuk do ta turpërojë Profetin dhe ata që besuan bashkë me atë. Drita e tyre do të shkëlqejë para tyre dhe në të djathtë të tyre. Ata do të thonë: ‘O Zoti ynë, përsose dritën tonë dhe falna ne! Vërtet Ti je i Fuqishëm për çdo gjë.’” (*Tahrim, 66/8*).

Edhe Hz. Pejgamberi, ashtu si në çdo çështje tjetër, edhe në çështjen e teubes është treguar shembull ndaj ummetit, por edhe i ka nxitur besimtarët që të shprehin teube (*Buhari, Dea’uat, 4; Muslim, Teube, 1, 78*).

Një emër i Allahut të Lartmadhëruar, si një atribut i tij në formën ‘Teuuab’, vjen në kuptimin e pranuesit të shumë pendimeve. Allahu i Lartmadhëruar thotë se do të pranojë pendimet e atyre që pendohen për gjynahet e tyre. Në të vërtetë, pendimi tregon kthimin nga gjynahet në emër të robit, si dhe kthimin pas të dënimit të tij nga Allahu, pra robi kthehet tek Allahu. Zoti e pranon këtë orientim të tij dhe heq dorë nga dënimi i tij. Ja, pra, në këtë kuptim, atributi ‘Teuuab’ do të thotë pranues i pendimeve të robërve.

Teubeja nënkupton kthimin nga ana e kundërt e bërjes së gjynaheve. Ajo vjen në kuptimin e faljes së gjynaheve dhe kthimin drejt Allahut, i cili di çdo gjë të hapur dhe të fshehtë; është kthimi nga atmosfera mbytëse e gjynaheve dhe bota e ndritshme e vartësisë ndaj Allahut; është kthim nga veset e këqija drejt veseve të mira.

Disa prej haditheve të Pejgamberit që nxisin pendimin janë si më poshtë:



“Uallahi unë kërkoj më shumë se shtatëdhjetë herë në ditë që Allahu të më falë, shpreh teube” (*Buhari, Dea’uat, 3. Në veçanti shihni Tirmidhi, Tefsiru sure (47), Ibn Maxhe, Edeb, 57*).

“Kënaqësia që ndien Allahu për shkak të shprehjes së pendimit nga robi është më shumë se gëzimi që ndien dikush kur gjen devenë e humbur në një shkretëtirë të vetmuar” (*Buhari, Dea’uat, 4; Muslim, Teube, 1, 7, 8*).

“Kushdo që pendohet para se dielli të lindë nga perëndimi, Allahu e pranon pendimin e tij” (*Muslim, Dhikr, 43*).

“Për sa kohë robi pendohet, edhe kur është në çastet e fundit të jetës, Allahu e pranon pendimin e tij” (*Tirmidhi, Dea’uat, 98. Përveç kësaj shihni Ibn Maxhe, Zuhd, 30*).

Ashtu si uji pastron papastërtinë, edhe pendimi i sinqertë pastron teuben. Mjafton që njeriu të ndiejë pendim ndaj gjynahut që ka kryer, ta ketë braktisur atë dhe të marrë vendim që të mos e bëjë më këtë.



7

Vendi i pendimit në jetën e njeriut



Sipas besimit islam, përveç peygamberëve, çdokush mund të kryejë gjynah. Njeriu mund të gabojë, por e rëndësishme është që pasi të ketë vënë re gabimin, të mos e vijoje atë. Në një hadith urdhërohet: “Të gjithë njerëzit bëjnë gabime, ndërsa më i hairit prej atyre që gabojnë është ai që shmanget nga gabimet e tij” (*Tirmidhi, Kiamet, 50 (2501); Ibn Maxhe, Zuhd, 30 (4251)*).

Teubeja është një rrugëdalje, të cilën Allahu i Lartmadhëruar ua njeh njerëzve që kryejnë gjynahe, për të shpëtuar nga gjynahet që kryejnë. Nga kjo pikëpamje, sado që njeriu kryen gjynah, nuk duhet të bjerë në pesimizëm, duhet të përdorë rrugëdaljen që i njeh Allahu i Lartmadhëruar, të ndryshojë rrugë dhe të orientohet drejt Allahut. Pa dyshim, ajo për të cilën bëhet fjalë këtu është situata në të cilën njeriu, pa menduar se ku do ta shpjerë rezultati i punës që kryen, kaplohet ndaj dëshirave dhe kërkesave të nefsit, duke kryer veprimet që ndalon Allahu. Përndryshe nuk bëhet fjalë për situatën e atyre që përpiqen të bëjnë gjynahe duke menduar se, gjithsesi, Allahu fal. Qëndrimi i këtyre personave është më se i rrezikshëm, ngaqë do të jetë një sjellje e ulët, e cila nënkupton faktin e keqpërdorimit të faljes së Allahut.

Njëri prej rreziqeve që e përçon më së shumti njeriun drejt qorrsoakut është mungesa e shpresës. Situata e individit që zhytet në gjynahe, që vë re gabimet, mirëpo që beson se nuk ka rrugëzgjidhje për të, është e lidhur me rregullimin e gjendjes së tij dhe vjen përsëri në situatën e një njeriu të mirë, që nuk e humb shpresën dhe që beson se ka një rrugëdalje për të. Ashtu siç shprehet në Kur’anin Famëlartë, nga mëshira e Allahut presin shpresë vetëm jobesimtarët.



“Mëshira e Allahut të Lartmadhëruar është e pafund. Ai i pranon pendimet e atyre që ndiejnë penesë për shkak të gjynaheve që kanë kryer dhe kërkojnë falje nga Allahu. Në Kur’anin Famëlartë urdhërohet: “Ai e pranon pendimin e robërve të Vet, i fal gjynahet dhe i di të gjitha çfarë punoni ju” (*Shura, 42/25*).

“Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, për atë që beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë!” (*Ta-Ha, 20/82*).

Besimtari që ka besim, mbështetet menjëherë te Zoti i Lartë për shkak të gjynahut që ka kryer dhe gabimit që ka bërë, duke ndier penesë dhe duke kërkuar falje nga Ai. Ky besimtar nuk ngul këmbë në gjynah dhe gabim për sa kohë është i vetëdijshëm (*Al-u Imran, 3/135*). E di se vetëm Allahu është ai që mund të pranojë pendimet dhe orientohet drejt Tij. Ai e di se nuk i kthen duarbosh ata që orientohen me sinqeritet drejt Tij. Në Kur’anin Famëlartë urdhërohet kështu:



“Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose kur i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre – e kush i fal gjynahet përveç Allahut? - dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë” (*Al-u Imran, 3/135*).

Gjynahet ndotin botën shpirtërore të njeriut, errësojnë zemrën e tij. Ndërsa teube bën të mundur që ai të krijojë sërish lidhje të fuqishme me Allahun. Pendimi riparon botën e zemrës që lëndohet nga gjynahu.

Ajetet dhe hadithet që lidhen me teuben, injektojnë shpresë te njerëzit e pashpresë, i shpëtojnë njerëzit nga pesimizmi, nga këmbëngulja në gjynah. Një person që beson në Allah dhe në Pejgamber, në ditën e ahiretit dhe në kushtet e tjera që urdhëron Islami, nuk duhet të kaplohet në pesimizëm dhe nuk duhet ta presë shpresën nga mëshira. Sepse në Kur'anin Famëlartë urdhërohet kështu:



“Thuaj: ‘O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti” (Zumer, 39/53).

“... Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen.” (Bakara, 2/222).

“Kërko ndjesë prej Allahut! Se Allahu është Falës e Mëshirëplotë” (Nisa, 4/106).

Fakti që Allahu i Lartmadhëruar u jep kohë për pendim njerëzve që bëjnë gjynahe, është një rezultat i mëshirës së pafund të Tij. Ai nuk i dënon menjëherë robërit për shkak të gjynaheve që kryejnë, por u jep atyre mundësinë që të pendohen. Ndaj atyre që pendohen duke e vlerësuar këtë mundësi, Allahu ua shpërblen këtë me falje. Kështu personit i jepet mundësia që ta rregullojë jetën shpirtërore.



Shembuj pendimi nga Kur'ani Famëlartë



Në Kur'anin Famëlartë, Allahu i Lartmadhëruar thotë se do t'i pranojë pendimet. Kuptimet e disa prej ajeteve që e tregojnë këtë janë si më poshtë:

“Atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve” (Nasr, 110/3).

“Ai e pranon pendimin e robërve të Vet, i fal gjynahet dhe di gjithë çfarë punoni ju” (Shura, 42/25). “... Allahu ia pranon pendimin kujt të dojë” (Teube, 9/15).

“Allahu dëshiron që t’jua pranojë pendimet tuaja...” (Nisa, 4/27).

“Ndërsa atij që pendohet pas të këqijave të tij dhe përmirësohet, Allahu ia pranon pendimin, sepse Ai është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë” (Maide, 5/39).

“Mirëpo atyre që pendohen, përmirësohen dhe tregojnë atë që kishin fshehur, Unë ua pranoj pendimin, sepse Unë jam Pranuesi i pendimeve dhe Mëshirëploti” (Bakara, 2/160).



Në këto ajete Kur'anore dhe në ajete të ngjashme, Allahu i Lartmadhëruar shprehet se do të pranojë pendesat. Kushti i vetëm që kërkohet këtu është fakti që pendesa në të vërtetë të jetë e sinqertë edhe nga brenda. Po ashtu, pendesa nuk duhet të lihet deri në çastin kur nuk do të ketë më shpresë, si për shembull kur përballemi me vdekjen. Në Kur'anin Famëlartë gjenden shembujt e kësaj.

Së pari le të diskutojmë mbi dy shembuj që lidhen me pendesën e sinqertë. Shembulli më i bukur i këtij lloji dhe që jepet në Kur'anin Famëlartë, është pendesa e njeriut të parë dhe pejgamberit të parë, Hz. Ademit (a.s.). Hz. Ademi dhe Havaja, pasi kishin ngrënë nga frutat e pemës së ndaluar, duke u mashtruar nga shejtani, kërkojnë falje që të dy nga Allahu dhe shprehin pendim. Allahu (xh.sh.) i fali ata dhe ua pranoi pendimet. Në Kur'anin Famëlartë kjo ngjarje dhe pranimi i pendimit të tyre nga Allahu i Lartmadhëruar përmendet vazhdimisht, duke u aluduar mbi pranimin e pendimit të tyre, ndërsa herë të tjera edhe në emër të Hz. Ademit. Kuptimi i njërës prej ajeteve që tregojnë këtë pendesë është si më poshtë:



“Ademi mësoi disa fjalë (se si të kërkonte falje) nga Zoti i tij, kështu që Ai ia pranoi pendimin. Sigurisht, Ai i pranon shumë pendimet, Ai është Mëshirëploti” (*Bakara, 2/37*).

Ndërsa në Kur'anin Famëlartë, si shembull i pendesës që tregon për shprehjen e saj në çastin e fundit, tregohet rasti i Faraonit.



Le të diskutojmë

Gjeni shembuj ajetesh nga Kur'ani Famëlartë, që lidhen përpjekjen e Faraonit për t'u penduar dhe diskutojini në klasë!

Pendesa që do të bëjë personi kur e kupton se do të vdesë nuk ka kuptim, pasi afati i saj konsiderohet i kaluar. Në lidhje me këtë, në Kur'anin Famëlartë urdhërohet kështu:



“Allahu është pranues i pendimit vetëm për ata që bëjnë ndonjë të keqe nga padituria dhe pendohen shpejt. Pra, këtyre Allahu ua pranon pendimin. Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë. Nuk pranohet pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë të keqja e, kur u afrohet vdekja, atëherë thonë: ‘Unë tani me të vërtetë po pendohem.’ As për ata që vdesin duke qenë jobesimtarë. Për këta, Ne kemi përgatitur dënim të dhembshëm” (*Nisa, 4/17-18*).

Pejgamberi ynë urdhëron: “Personi që pendohet nga gjynahet është sikur nuk ka kryer aspak gjynah” (*Ibn Maxhe, Zuhd, 30*).



Të studiojmë – Të mësojmë

Gjeni shembuj të teubes në Kur'anin Famëlartë!



“Kur robi kryen një gabim, në zemër i formohet një gjurmë e zezë. Nëse personi e largon nefsën nga ai gabim, nëse kërkon falje dhe pendohet, ajo që ka në zemër fshihet. Mirëpo nëse vazhdon të kryejë të njëjtin gjynah, njollat që ka në zemër i shtohen edhe më tej, gjersa e njollosin të gjithë zemrën. Kjo është një ndër ato situata që ndryshkin zemrat, siç edhe bën të ditur Allahu në ajetin: ‘Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat.’ (*Mutaffifin*, 83/14) (*Muslim, Iman*, 231; *Tirmidhi, Tefsir, Mutaffifin* (3331); *Ibn Maxhe, Zuhd*, 29, 4244).



Përmbledhja e kapitullit

Duaja është shprehja e dëshirave dhe e kërkesave të robit duke u orientuar me të gjithë qenien drejt Allahut.

Synimi i duasë është shprehja e lutjeve dhe paraqitja e situatës personale tek Allahu. Nga kjo pikëpamje duaja është një mjet komunikimi pa ndërmjetës mes Allahut dhe personit besimtar.

Nëse lutjet e kërkuara nëpërmjet duasë nuk realizohen menjëherë, kjo nuk do të thotë se duaja juaj nuk është pranuar. Realizimi i duasë mund të jetë lënë edhe për në ahiret. Megjithëkëtë, Allahu, edhe dëshirat e dobishme, të cilat i kërkon robi që bën dua në aspekt të jetës së botës, i fal si një mirësi hyjnore. Hz. Pejgamberi bën të ditur se kërkesa e atij që bën dua, ose do t’i jepet menjëherë në botë, ose do të ruhet për në ahiret, ose do të fshihen nga ai aq të këqija sa edhe mirësia që ka kërkuar.

Te duaja gjendet prehja e zemrës. Robi që përmend Allahun, që mbështetet tek Ai, që kërkon ndihmë nga Ai, ashtu siç fiton pëlqimin e Tij, përfiton edhe ndihmën, por edhe purifikohet nga disa papastërti që burojnë për shkak të dobësive.

Duaja është një mjet që e afron njeriun me Allahun. Njeriu që bën dua është më i singhtë në të gjitha lëvizjet dhe sjelljet e tij. Sepse personi që bën dua është i vetëdijshëm që Allahu i Lartmadhëruar di çdo gjë, sheh çdo gjë dhe dëgjon çdo gjë. Si rrjedhojë, ai është i vetëdijshëm se asgjë nuk është jashtë dijes së Tij. Duaja është thelbi i adhurimit.

Pendimi nënkupton kthimin në rrugën e drejtë që ka treguar Allahu, duke braktisur të këqijat apo gjynahet e kryera; pendim do të thotë të dëshirohet falje nga Zoti nëpërm-

jet duave dhe të shprehet orientim drejt Tij.

Pendesa që bëhet në mënyrë të sinqertë, në mënyrë serioze dhe me nijetin për të mos u kthyer sërish te gjynahu i mëparshëm, quhet “teube nasuh”. Në Kur’anin Famëlartë besimtarët urdhërohen të pendohen pikërisht sipas kësaj lloj pendese.

Pendesa është një kthim në anën e kundërt të gjynaheve. Është kthim drejt Allahut, i cili është falës i gjynaheve dhe di çdo gjë të hapur e të fshehtë. Pendesë do të thotë të shkëputesh nga atmosfera mbërthyesë e gjynaheve dhe të kthehesh në botën e ndriçuar të vartësisë ndaj Allahut.

Sipas besimit islam, çdokush tjetër përveç pejgamberëve mund të kryejë gjynah. Njeriu mund të gabojë dhe mund të bëjë disa gabime. E rëndësishme është që personi të mos vazhdojë të bëjë gabime pasi e ka kuptuar se po gabon.

Pendesa, e cila e lidh sërish njeriun me jetën, i fal atij shpresë dhe dëshirë për jetesë, e orienton atë drejt Allahut, i forcon besimin, bëhet shkak që të shndërrohet në një person të drejtë. Për këtë arsye, pendesa zë një vend të rëndësishëm në jetën e njeriut.



Të rishikojmë kapitullin



1. Përse duaja është cilësuar si thelbi i adhurimit?
2. Në Kur’anin Famëlartë bëhet e ditur se njerëzit që gjenden në pozitë të vështirë, edhe nëse nuk janë besimtarë, strehohen te duaja. Përse?
3. Sipas jush cili është kriteri më i rëndësishëm i duasë?
4. A është e drejtë që të thuash se bëra dua, por duaja nuk m’u pranua? Përse?
5. Çfarë kërkohet më shumë në shembujt e duave në Kur’an dhe Sunnet?
6. Cili është kuptimi i termit teube?
7. Cili është kuptimi i termit Teuub?
8. Çfarë kushtesh nevojiten për pranimin e teubes?



Pyetje vlerësuese



1. Cili nga vlerësimet e mëposhtme nuk është i përshtatshëm për pendesën e pejgamberëve?

- A) Pejgamberët kanë shprehur pendesë për t'u mësuar ummeteve të tyre kryerjen e pendesës.
- B) Nuk ka kufi lartësimi deri tek Allahu. Pejgamberët, duke qenë se janë më të afërt me Allahun e Lartmadhëruar, pendohen për shkak të pozitave paraprake të tyre.
- C) Kanë shprehur pendesë ngaqë nuk kanë bërë një zgjedhje më të mirë, atëherë kur e kanë patur këtë mundësi.
- D) Kanë shprehur pendesë për shkak se kanë kryer gjynahe të mëdha.

2. Cili nga veprimet e mëposhtme nuk është kusht për pranimin e pendesës?

- A) Falja e dy rekateve namaz.
- B) Shlyerja e cenimit të së drejtës së rob-it nëse ka, ose kërkimi i faljes për këtë arsye.
- C) Të marrësh vendim të prerë për të mos u kthyer më te gjynahet.
- D) Plotësimi i farzeve të paplotësuara.

3. Cila nga alternativat e mëposhtme është kriteri më i rëndësishëm i duasë?

- A) Të orientohesh drejt kibles gjatë këndimit të duave dhe të jesh me abdest.
- B) Të nisësh duanë me bismil-lah, të bësh dua duke shprehur falënderim ndaj Allahut dhe duke kënduar salat e selam për Rasulullahun.
- C) Të këndosh dua bashkë me duatë që citohen në Kur'an dhe Sunnet.
- D) Përzemërsia, sinqeriteti dhe përshpirtshmëria.

4. Ç'kuptim kanë duatë që përfshihen në Kur'an dhe në Sunnet?

- A) Janë cituar me qëllim që të jenë shembuj se si do të këndohet dua dhe për të treguar se çfarë është më mirë të kërkojmë kur bëjmë dua.
- B) Janë dua, këndimi i të cilave është i detyrueshëm.
- C) Këndimi i këtyre duave me fjalët në arabisht është e detyrueshme. Nuk këndohet dua me përkthimet e tyre.
- D) Nuk këndohet asnjë dua tjetër përveç këtyre.

5. Cili nga vlerësimet e mëposhtme është i drejtë në lidhje me duatë?

- A) Meqenëse është thelbi i adhurimit, personi që bën dua nuk ka nevojë për të kryer adhurim tjetër.
- B) Hiqet përgjegjësia për kryerjen e adhurimeve.
- C) Ai që nuk kryen adhurimet, nuk mund të bëjë dua.
- D) Edhe se mund të vijë në këmbim të adhurimeve fizike, të tilla si namazi, nuk kalon në vend të adhurimeve financiare ashtu si zekati.



156



Çelësi i përgjigjeve



KAPITULLI 1

1. B, 2. C, 3. D, 4. B, 5. B

KAPITULLI 2

1. C, 2. D, 3. C, 4. A, 5. D

KAPITULLI 3

1. B, 2. A, 3. D, 4. C, 5. B

KAPITULLI 4

1. C, 2. A, 3. B, 4. D, 5. B

KAPITULLI 5

1. A, 2. B, 3. C, 4. B, 5. C

KAPITULLI 6

1. B, 2. C, 3. D, 4. A, 5. A

KAPITULLI 7

1. D, 2. A, 3. D, 4. A, 5. B



157

Bibliografi

- Abdurrahman Adh-dham, Rasulu Ekrem'in Örnek Ahlakı (Morali shembullor i Rasulullahut), Përkth. Hayrettin Karaman, Yağmur Yayınevi, Stamboll 1975.
- Afdalurrahman, Siret Ansiklopedisi (Enciklopedia mbi jetën e Pejgamberit), İnkılab Yayınları, Stamboll 1996.
- Akseki, Ahmet Hamdi, İslam Dini (Feja islame), Diyanet Reisliği Yayını, Ankara 1960.
- Bilmen, Ömer Nasuhi (v. 1971), Hukuki İslamiyye ve Istılahatı Fıkhiyye Kamusu (Legjislativi islam dhe fjalori i termave të jurisprudencës), Bilmen Yayınevi, Stamboll 1975, I-VIII.
- Bilmen, Ömer Nasuhi, Büyük İslam İlmihali (İlmihali i madh islam), Bilmen Yayınevi, Stamboll 1970.
- Büyükkörükçü, Tahir, Mübarek Ramazan ve Oruç (Ramazani i shenjtë dhe agjërimi), Şelale Yayınları, Stamboll.
- Canan İbrahim, Kütüb-i Sitte Muhtasarı Tercüme ve Şerhi (Përkthimi dhe komentimi i përmbledhjes së Kutubus'-Sitte), Akçağ Yayınları, Ankara 1992, IV/432 etj.
- Ceziri, Abdurrahman, Kitabul-Fikh Ala'l-Medhahibi'l-Erbaa, Ihjau't-Turathi'l-Arabi, Bejrut, pa datë.
- Davudoğlu, Ahmed, Sahih-i Müslim Tercemesi ve Şerhi (Përkthimi dhe komentimi i Sahihu'l-Muslim), Sönmez Neşriyat, Stamboll 1977.
- DİA (Enciklopedia islame e Fondacionit të Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë), Paragrafi Dua.
- DİA (Enciklopedia islame e Fondacionit të Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë), Paragrafi Haxh.
- Ebu Zehra, Muhammed, Usulu'l-Fikh, Tebliğ Yayınları, Eren Ofset, Stamboll, pa datë.
- Elmalılı, Muhammed Hamdi Yazır (v. 1942), Hak Dini Kur'an Dili (Feja e vërtetë, gjuha e Kur'anit), Eser Neşriyat, Stamboll 1979, v. I-IX.
- Eraslan, Sadık; Keleş Ekrem, En Güzel Örnek Hz. Muhammed (Hz. Muhammedi si shembulli më i bukur), Türkiye Diyanet Vakfı Yayını, Ankara 2003.
- Erdem, Hasan Hüsnü, Abdes Almanın Göz ve Diş Sağlığı Açısından Önemi (Rëndësia e marrjes së abdesit në aspekt të shëndetit optik dhe oral), Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, 1963.
- Erul, Bünyamin; Keleş, Ekrem, Kutsal İklimde Dua (Duaja në klimën e shenjtë), Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 2004.
- Erul, Bünyamin; Keleş, Ekrem, Haccı Anlamak (Të kuptosh haxhin), Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 2004.
- Ezherli, İsmail, Zekat, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 2004.
- Faruki İsmail Raci ve Luis Lamia, İslam Kültür Atlası (Atlasi kulturor islam), përkth. Mustafa Okan Kibaroglu ve Zerrin Kibaroglu, İnkılap Yayınları, Stamboll 1999.
- Hallaf, Abduluehhab (v. 1956), Ilmu Usuli'l-Fikh, el-Mektebetu'l-Islami, Stamboll 1984.
- Komision (Halil Altuntaş, İsmail Karagöz, Mehmet Keskin), Hac İlmihali (İlmihali i haxhit), Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 2004.
- Komision, Dini Kavramlar Sözlüğü (Fjalor i termave fetarë), Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 2005.
- Heyet, Diyanet Hac Duaları (Duatë e haxhit nga Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë), Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 2001.
- Komision, İlmihal I-II, Türkiye Diyanet İslam Araştırmaları Merkez (İSAM) Yayını, Stamboll 1999.
- Ibn Abidin, Muhammed Emin b. Omer, Raddu'l-Muhtar 'Ala'd-Durri'l-Muhtar, Matbaai Amire, Stamboll 1999.
- Kasani, Alauddin Ebu Bekr b. Mes'ud el-Kasani (v. 587), Bedaiu's-Sanai fi Tertibi'sh-Sherai', Matbaatu Sheriketu'l-İlmijje, Egjipt 1327.

- Ibn Humam, Fet'hu'l-Kadr, Matbaatu Mustafa'l-Babi el-Halebi, Egjipt 1970.
- Ibn Kudame, Ebu Muhammed Abdullah b. Ahmed (v. 620), el-Mugni, Daru'l-Fikr, Bejrut 1984, I/424.
- Ibn Rushd, Ebu'l-Uelid Muhammed b. Ahmed b. Muhammed Ibn Rushd el-Hafid, Bidajetu'l-Muxhtehid ue Nihajetu'l-Muktesit, Matbaatu Ahmet Kamil, Stamboll 1333 H.
- Kamil Miras ve Ahmed Naim, Sahih-i Buhari Muhtasari Texhrid-i Sarih Tercemesi ve Şerhi, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 1973.
- Keleş, Ekrem, Umre Rehberi (Udhërrëfyes i umresë), Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 2007.
- Keskioğlu, Osman, Kur'an-ı Kerim Bilgileri (Informacionet e Kur'anit Famëlartë), Türkiye Diyanet Vakfı Yayını.
- Mehmet Zihni Efendi, Nimet-i Islam, Stamboll, pa datë.
- Meraki'l-Felah bi Imdadi'l-Fettah, Sherhu Nuri'l-Izah ue Nexhati'l-Eruah, Matbaatu Ahmet Kamil, Stamboll 1327.
- Merginani, Ebu'l-Hasen Ali b. Ebu Bekr, el-Hidaje Sherhu Bidajeti'l-Mubtedi, el-Mektebetu'l-Islamijje, pa datë.
- Meusili, Abdullah b. Mahmud b. Meudud, el-Ihtijar li Ta'lili'l-Muhtar, Matbaatu Mustafa'l-Babi el-Halebi, Egjipt 1936.
- Neueui, Ebu Zekerijja Muhjiddin b. Sheref (v. 767), el-Mexhmu Sherhu'l-Muhedh-dheb, Idaretu'l-Tiba'ati'l-Munirijje, Egjipt III/29.
- Neueui, Ebu Zekerijja Muhjiddin b. Sheref (v. 676), el-Edhkar.
- Neueui, Ebu Zekerijja Jahja b. Sheref (v. 676/1277), Përkthimi dhe komentimi i er-Rijadhu's-Salihin: er-Rijadhu's-Salihin, Peygamber Efendimizden Hayat Ölçüleri (Kritere jetësore nga jeta e Pejgamberit), përgatiti: Prof. Dr. M. Yaşar Kandemir, Prof. Dr. İsmail Lütfi Çakan, Doç. Dr. Raşit Küçük, Erkam Yayınları, Stamboll 1997 (pjesa më e madhe e kuptimeve të ajeteve dhe burimet e haditheve që citohen në kapitull janë marrë nga kjo vepër).
- Özyazıcı, Alparslan, Din ve Bilimin Işığında Oruç ve Sağlık (Agjërimi dhe shëndeti në dritën e fesë dhe shkencës), Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 2004.
- Sofuoğlu, Cemal, Açıklamalı Büyük Dua Kitabı (Libri i madh i duave me sqarime), Türkiye Diyanet Vakfı Yayınları, Ankara 1992.
- Şahin, Muzaffer; Keleş, Ekrem, Ailenin Din Kılavuzu (Udhërrëfyesi fetar i familjes), Seha Yayınları, Stamboll 1994.
- Şamil İslam Ansiklopedisi, Şamil Yayınevi, Stamboll 2000.
- Şentürk, Lütfi ve Yazıcı Seyfettin, Diyanet İslam İlmihali, Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 2004.
- Shirbini, Muhammed b. Muhamed el-Hatib, Mugni'l-Muhtaxh ila Ma'rifeti Meani el-fadl- Minhaxh, Daru'l-Kutubi'l-Ilmijje, Bejrut 1994.
- Yazıcı, Seyfettin, Ramazan ve Oruç (Ramazani dhe agjërimi), Diyanet İşleri Başkanlığı Yayınları, Ankara 1997.
- Yücel, İrfan, Hac Rehberi (Udhërrëfyesi i haxhit), Türkiye Diyanet Vakfı Yayını, Ankara 1997.
- Yücel, İrfan, Hacı Adaylarına Özet Bilgi ve Dualar (Informacione dhe dua të përmbledhura për kandidatët e haxhiut), Türkiye Diyanet İşleri Vakfı Yayını, Ankara 1999.
- Zekijjud'din Sha'an, Usulu'l-Fikh, përkth. İbrahim Kafi Dönmez, Emel Matbaası, Ankara 1990, Türkiye Diyanet Vakfı Yayını).
- Zejdani, Abdulkarim, el-Uexhiz fi Usuli'l-Fikh, el-Mektebetu'l-Islami, Stamboll 1979.



